

Në moshën 97-vjeçare, profesor Sami Repishti vjen me këtë rrëfim për jetën e tij, pikat ku ajo lidhet me vendlindjen, mënyrën sesi vendlindja jeton brenda tij prej dekadash qysh kur emigroi pasi u arratis nga burgu gjatë komunizmit si dhe pritshmëritë për të ardhmen e kombit, brenda idesë të të cilit e sheh të shkrirë tërësisht shpirtin e vet.

SAMI REPISHTI: Për 45 vjet në Kosovë u pengue zhvillimi i lirë artistik-letrar, ndërsa në Shqipëri u vra fare

Bisedoi Andreas Dushi



MONUMENTET E
TRADITËS NË SHKODËR
Nga Willy Kamsi
(fq. 4)

SHËNIME MBI LIBRAT
MUZA E BEKUAR,
VËSHTRIME KRITIKE TË
POEZISË SË SALI BASHOTËS
nga Virion Graçi
(fq. 8)

Roman i Stefan Çapalikut, Botimet "Fishta", 2022
"NJË ENGJËLL VESHË
ME FRAK"
Prof. Dr. Tefë Topalli
(fq. 6)
Një lexim ndryshe i librit "Tri këngë
zie për Kosovën"

ANTITEZA KADAREANE E
MITEVE BALLKANIKE
Nga Arben Veselaj
(fq. 5)
SEMANTIKA DHE
METAFIZIKA E VDEKJES NË
ROMANIN E ADIL OLLURIT
Nga Driton Fejzullahu
(fq. 12)

nga Botime Mediaprint
Bardhë e zi në albumin
ALBANIA të Maurizio Bosio
Nga Prof. Asc. Albes Fusha
(fq. 18)



MIDIS ARBËRESHËVE TË KALABRISË

Prof. Diana Kastrati

Që nga momenti i themelimit të QSPA-së në janar të 2020, në agjendën prioritare të punës qëndronte vizita te komunitetet arbëreshe të Kalabrisë, e më pas tek ato të Sicilisë, të Puljas, të Abrucos e me radhë. Rrethanat nuk u treguan të mëshirshme: fillimi i funksionimit të institucionit përkoj me pandeminë, me izolimin. Vizita u arrit të realizohej vetëm në datat 16-20 qershor 2022. Nuk do të doja të ndalesha te të gjithë takimet, të cilat gjithsesi do t'i përmend shkurtimisht, por te çfarë doli nga këto takime, te diskutimet më thelbësore, te përfundimet, te vendimet e projektet e afërme e të ardhshme... (fq. 10)

MBI TRI TREGIME
TË BORGES-IT
Nga Ballsor Hoxha
(fq. 19)

Dallime në vargëzim midis
dy përkthimeve në shqip të
rubairave, prej Fan S. Nolit
dhe Hafiz Ali Korçës

Prof. As. Dr. Jonela Spaho



BIBLIOTEKË
Zija Çela
Gropa Thithëse
Arben Çejku
Pik'jetë
Shqiptar Oseku
Guernica
Niels Hav
Është vështirë të jesh
i shenjtë në qytet
Ajne Iberhysaj
Anja
(fq. 16)
(fq. 17)
(fq. 13)
(fq. 14)
(fq. 7)

"ZEMRA TË EGRA" - Nëpër
labirintet e një Panairi që
merr frymë
nga Eris Rusi
(fq. 9)

Furrat e qeramikës
dhe objektet e kultit në
vendbanimin prehistorik
të Kamnikut në Kolonjë
Prof. emeritus Skënder Aliu
(fq. 20)

Në moshën 97-vjeçare, profesor Sami Repishti vjen me këtë rrëfim për jetën e tij, pikat ku ajo lidhet me vendlindjen, mënyrën sesi vendlindja jeton brenda tij prej dekadash qysh kur emigroi pasi u arratis nga burgu gjatë komunizmit si dhe pritshmëritë për të ardhmen e kombit, brenda idesë të të cilit e sheh të shkrië tërësisht shpirtin e vet.

SAMI REPISHTI:

Për 45 vjet në Kosovë u pengue zhvillimi i lirë artistik-letrar, ndërsa në Shqipëri u vra fare

Bisedoi Andreas Dushi



i realitetit. Por, edhe në fund, gjendja e raporteve njerëzore nuk u zbatue krejtësisht. Koncepti "qyteti i Shkodrës" ka mbijetue frymën kolektive të "diktaturës së proletarietit".

A.D.: Studimet tuaja janë një histori më vete, tepër e veçantë dhe interesante. Fillimisht, në rini, ndoqët historinë moderne në Firence, pastaj vuajtët vite të tëra burg e persekutim, deri kur mundët të largoheshit për të vijuar sërish studimet, tanimë në New York e Paris. Për vite me radhë keni dhënë edhe mësim në universitetin *Adelphi* të New Yorkut. Pas daljes nga ferri komunist, njerëzit janë të prirur drejt një lloj shijimi hedonist të jetës, ndërsa ju bëtë tjetërgjigj, e shijuat në një formë tjetër, apoloniane... Pse?

S.R.: Që nga vendosja ime me emigrue në Amerikë kam qenë i bindun se nuk do të jem unë ai që do të baj ndryshime në shoqinë amerikane. Ishte kjo shoqni që do të më formonte. Me këtë bindje, zbrita në New York, rashë në gjuj dhe putha tokën që do të ishte së shpejti edhe atdheu im i dytë.

Që në fillim u preka shumë nga "jeta e pajetë" e mjaft emigrantëve. Natyrisht formova bindjen se për një punë të suksesshme në SHBA, njeriu duhet të ketë një "diplomë" studimesh superiore, ose një profesion. Përndryshe, je i dënuem me punue si punëtor krahu të gjithë jetën. U regjistrua në "college" për një diplomë me dhanë mësim në frengjisht, gjuhë që kishe studjue në gjimnaz. Anglishten fillestare e mësova në burg në kondita mjaft të vështira. Njikohësisht që nga ora 16:00 deri në orën 24:00 punova në një bankë në Wall Street(!), me sigurie bukën e përditshme. Mbrenda dy viteve mora diplomën e gjeta punësim në shkollat e mesme. Në Universitetin e Parisit (Sorbonne) shkova me bursë studimi nga qeveria franceze në 1970-1971.

A.D.: Kur u njohët me lirinë si koncept dhe si konkretësi dhe, a mendoni se ndonjëherë Shqipëria ka qenë përnjimend e lirë? Nëse po, kur?

S.R.: Etja për liri ishte konkretizue që në vitin 1939, viti i okupacionit fashist. Prania e forcave të hueja në vendin tand ashtë e padurueshme. Mbetej zgjedhja e dytë: rezistenca që përmbushte një nevojë të fortë shpirtnore. Por liria duhet ushqye dhe ky ashtë një proces që kërkon sakrifica. Për fat të keq, unë humba babën 61 vjeçar, viktimë e terrorit fashist dhe kushërinin 17 vjeçar, Zyhdi Repishti, viktimë e terrorit të Gestapos naziste. Por "liria" e fitueme ishte çlirimi nga i hueji

Me të ndertin profesor Sami Repishti më ndajnë mëse shtatëdhjetë e pesë vjet. Prandaj, kur ai tregon për Shkodrën e tij, me toponime e përshkrime vendesh, unë mundohem t'i shoh ashtu sikurse janë sot, në kërkim të pikës ku shtresëzimi i së shkuarës që i nderti prof. Repishti tregon, puthet me të tashmen që unë përjetoj.

Përsiatja mbi këtë çështje më ka ngacmuar qysh kur zuri fill kjo intervistë, ndoshta edhe më herët dhe, nuk them ndonjë të pavërtetë nëse rrëfej se një shtysë për t'i shkruar prof. Repishti ka qenë pikërisht nevoja për t'i kthyer vetes një përgjigje. Mesa kam arritur të kuptoj, ky takim ndodh pikërisht në ata monumente të cilët i japin karakterin historik dhe urbanistik qytetit, prej shekujsh, akoma të pashkatërruar.

Prandaj, në fund, pas bisedës krejt të veçantë për mua, ku tregohet edhe aftësia e pareshtur, ndonëse në moshë të shtyrë, e prof. Repishti për të shkruar, kujtuar, përgjigjur e diskutuar, pra pas kësaj bisede, mund të lexoni një kumtesë të Willy Kamsit me titull "Monumentet e traditës në Shkodër", mbajtur në Seminarin e Parë Ndërkombëtar "Shkodra ndër shekuj", organizuar nga Muzeu Historik i Shkodrës më 22 - 23 qershor, 1993, edhe si një homazh për këtë figurë të shquar, tejet të rëndësishme të kulturës shkodrane dhe bibliofilisë, bibliografisë e bibliotekomisë shqiptare.

A.D.: I nderti profesor Repishti! Për mua, 22 vjeç nga Shkodra, kjo bisedë do të shkruhet ndër kujtimet më të bukura, pasi gjithnjë nuk epem për të mësuar se si e kanë përjetuar brezat e ndryshëm hijen e Rozafës. Pikërisht, këtë titull mban edhe libri juaj me kujtime, *Nën hijen e Rozafës*, prandaj natyrshëm, nuk e shmang dot pyetjen: Si mund ta përshkruani jetën tuaj të atyre viteve që kaluat nën atë hije?

S.R.: Në përgjithësi, jeta ime gjatë viteve të rinisë dhe e edukimit në Shkodër ka qenë relativisht e qetë, me përjashtim të viteve të tri diktaturave.

Kam lind në një familje tradicionale shkodrane që merrej me tregti, por baba im ka qenë imam, klerik mysliman, i devotshëm, i qetë për natyrë, por i interesuem për mbarëvajtjen e jetës publike të qytetit të Rozafës. Nji person i edukuem në Universitetin e Istanbul-it për pesë vjet, ai u angazhue në politikë menjherë mbas kthimit nga shkolla; u regjistrua "vullnetar" gjatë luftës së Rrethimit të Shkodrës nga forcat serbo-malazeze (nandor 1912-prill 1913) dhe ma vonë me detyra jozyrtare, por në mbrojtjen e qytetit. Në vitet e turbullta 1920-1924, u bashkue me forcat "fanoliste". Në dhjetor 1924 u zgjodh në Asamblenë Kushtetuese dhe ma vonë deputet i qytetit të Shkodrës. Nga veprimtaria e babës, une çmoj veçanërisht bashkëpunimin e tij me klerin katolik shqiptar, parlamentarë si At Gjergj Fishta, At Ambroz Marlaskaj etj.. Ky koalicion i njohun si "Ora e Maleve" u krijue me pengue fitoren e Ahmet Zogut, i njohun si "ateist". I dënuem me vdekje -in absentia - në 1925 u amnistue dhe nuk mori pjesë në veprimtari publike.

Nana, Hava Bushati, vjen nga familja e njohun e "Bushatlinjve" shkodranë. Në një ambient të ketillë, unë jam formue me dashtuni për vendin dhe me sensin e përgjegjësisë për fatin e tij.

Kështjella e Rozafatit ka qenë dhe mbetet për mue "ylli polar" i mendimit dhe veprimtimit tim: patriotizëm, jetë në

liri me dinjitet, besë, nder e burri në shërbim....!

A.D.: Sikurse thatë edhe vetë, ju jetuat në tre diktatura. Pas kaq e kaq dekadash, kur po arrini një shekull jetë, e tregoni dot ndryshimin e atmosferës së përgjithshme që mbizotëronte ndërmjet tyre në Shkodër e Shqipëri?

S.R.: Pyetje "e ngarkueme" me ngjarje e përvoja personale!

Nuk e mallkoj fatin tim të keq gjatë tri diktaturave! Përshkrime të hollësishme të jetës sime janë dhanë në librin tim

"Nën hijen e Rozafës". Por gjatë viteve të okupacionit, Shkodra ka pasë një frymë afrimi mes njerëzve. Egërsia e ushqyeme nga propaganda fashiste, naziste e komuniste nuk kanë "transformue" atmosferën e fqinjësisë së mirë në qytet dhe në fshat. Me ardhjen e komunizmit, në 1944, ndryshimet në Shkodër u shumëzuen dhe u intensifikuen. Qyteti u mbush me një administratë joshkodrane që nuk njihite fare atmosferën e fqinjësisë së mirë të qytetit dhe që zbatoi me fanatizëm parullën "kush nuk ashtë me ne, ashtë kundër nesh", një qëndrim parimisht joshokuier dhe konfrontues



që përfundoi me skllavërinë komuniste 45 vjeçare izolimi hermetik dhe shtypje e vorfni për shumicën dërrmuese të popullsisë. Akoma sot, Shqipëria nuk është e lirë; është e pavarun, por nuk është demokratike; është e vetëqeverisun, por jo "europiane", sepse nuk e meritojmë derisa të plotësojmë konditat e një qeverisjeje demokratike....!

Nuk duhet humbë shpresa sepse jetojmë në zemër të Europës!

A.D.: Duke lexuar *Nën hijen e Rozafës* dhe tregimet e *Pika loti*, vihet re se përballë çdo të reje, ju jeni dyshues. Ky dyshim, ku mbruhej, nga vinte?

S.R.: Nga eksperiencia në jetë u ba "Shqipëria e mosvarme", por iu nënshtrua vorfnisë së regjimit monarkist e sundimit nga një njeri, e jo nga ligji. Erdhi fashizmi, nazizmi, komunizmi. Çdo ndryshim ma i keq se i pari. Nji plak dukagjinat në burg thoshte: "Na ka ardhë dreqi me na sundue!" Kishte të drejtë në thjeshtësinë tij.

A.D.: Drejt Amerikës, ia ka dalë të arratisë edhe një tjetër personalitet shkodran, Arshi Pipa. Si e kujtoni atë dhe kohën që bashkëndatë?

S.R.: Arshi Pipa ka qenë shoku im ma i ngushtë në Amerikë. Fatmirësisht, ai gjeti mundësinë me dhanë mësim që në fillim dhe kaloi të gjithë jetën me shkrime letrare, nganjherë edhe politike. Natyrë e qetë, paqësore, intelektual i mirëfillt... bindës në bashkëbisedime. Madhështia e tij do të rritet me kohën dhe njohjen ma të gjanë në Shqipëri dhe jashtë. Pipa është shqiptari që ndoshta ka shkruar ma shumë se kushdo kundër diktaturës komuniste e problemit komunist në Shqipëri.

A.D.: Diaspora disidente shqiptare gjatë viteve të komunizmit i kushtoi shumë rëndësi pikërisht kulturës. Kujtoj këtu Koliqin, për shembull me *Bllokun Kombëtar Independent* në Romë. Si ishte bashkëpunimi mes jush, gjithnjë në fushën e kulturës në dobi të gjithçkaje atdheu, i parë nga larg, përfaqësonte?


S.R.: I ndjeri Ernest Koliqi është figura e intelektualit që ka lanë një pasuni të mendimit intelektual me randësi. Për fat të keq, Koliqi shpenzoi shumë kohë me grupe politike gjatë okupacionit fashist. Me këtë, ai ka ba shumë kundërshtarë. Bashkëpunëtorë të tij kanë tregue se ai e ka pohue këte "gabim" dhe e ka njohë si "fenomen negativ", fatkeqësisht edhe për shumë intelektualë shqiptarë.

Me Bllokun.... dhe grupet e tjera politike shqiptare në emigracion, nuk kam pasë komunikim, megjithëse shumë partizanë të këtyne formacioneve kanë qenë shokë të mi.

A.D.: Kultura shqiptare, për shumë kohë njërën këmbë, atë shpeshherë më të qëndrueshmen, e ka pasur në Amerikë. Noli, Konica... Duket sikur kjo traditë mbyllet me personalitetin Tuaj të shumanshëm. Ndoshta e kam gabim, nuk e di... Ju si e gjykoni?

S.R.: Gjykimi juej është i matun dhe spjegon një aspekt pozitiv të bashkësisë sonë në SHBA. Ka pasë edhe të tjerë kontribues, por jo në naltësinë e Nolit dhe Konicës. Rrethanat e atëherëshme kanë qenë të atilla sa që të lejojnë vetëm figurat me peshë me u marrë me çështje politike shqiptare. Noli e Konica janë pa dyshim dy viganë.

Sot, për arsye se Shqipëria është shtet, anëtar i OKB-së, me qeveri dhe përfaqësi



në botën e jashtme për mbrojtjen e interesave të saj, çështja kombëtare nuk ka peshën dhe urgjencën e së kaluemes. Shembull: veprimtaria jonë për Kosovën. Sot kemi nevojë për shkollarë me përgatitje superiore që e paraqesin me studime serioze në revistat e botës perëndimore, ose edhe pranë autoriteteve federale të vendit tonë me paraqitje korrekte të kërkesave të bashkësisë sonë që po i afrohet numrit gjysëm miljoni.

Këto shërbime kemi ba edhe gjatë krizës së Kosovës (1965-1999), nji veprimtari ku jam përfshi edhe unë, me pasion. Kosova u ba lajmotivi i jetës sime.

Kontributi letrar është në fazën "fillestare", por premtuese. Me qindra të rij e re reja vazhdojnë studimet e tyne në



Amerikë dhe vitet e ardhme do të shohim rezultate.

A.D.: Kontributi juaj për çështjen e Kosovës, i vlerësuar edhe nga ish presidenti i Kosovës, Rugova dhe i cituar nga ish presidenti i SHBA-së, Clinton mbetet i një rëndësie të veçantë. Tanimë ka kaluar më tepër se një dekadë nga Pavarësia që Kosova fitoi... Si e shihni kontributin e kësaj pjese të shqiptarisë në lamien e kulturës sonë kombëtare?

S.R.: Zhvillimi i kulturës sonë kombëtare në Kosovë duhet trajtue në kontekstin e historisë bashkëkohore kosovare. Botimi i parë shqip në Kosovë u ba në muejin shkurt 1945 me botimin

e gazetës Rilindja. Nga nji pikëpamje ka qenë nji "kompromis" politik. Në shkurt 1945, Miladin Popoviqi dhe Fadil Hoxha kërkuen nji audiencë me Marshallin Tito dhe paraqitën kërkesën e tyne të parë: nji republikë federative për Kosovën. Tito u përgjegj se nji zgjidhje e këtellë është "e pamundur" sepse do të zgjonte nacionalizmin serb. Si "kompromis" ai premtoi krijimin e nji "krahine autonome" mbrenda kufijve të Republikës serbe.

Për mendimin tim, ky gjest i Titos dha mundësinë e krijimit të "Krahies Autonome të Kosovë - Metohisë - KAKM". Me gjithë këtë, sundimi serb në Kosovë ishte absolut. Në këto ditë, u vra misteriozisht Miladin Popoviq. Serbët akuzuen nji shqiptar që vrau veten, dëshmorin Haki Tahaj. Dyshimet janë të shumta se është vra nga serbët. Kështu mendonte edhe nana e Miladinit e cila nuk lejoi udhëheqësit serbë të Kosovës me marrë pjesë në funeralin e djalit.

Botimi i gazetës RILINDJA filloi pikërisht në këto ditë me qëllim që të qetësohej shumica shqiptare. Në realitet, RILINDJA nxiti flakën e nacionalizmit shqiptar, megjithëse e kufizue. Kjo frymë ka mbretue deri në vitin 1974, ramja e Rankoviqit dhe shqiptarët filluen të revoltohen deri në çlirim - qershor 1999.

Kontributi i Kosovës në lamin e kulturës shqiptare ka qenë "i prangosur", por konstant dhe me kalimin e viteve letërsia kosovare u ba nji faktor me randësi për të gjithë shqiptarët, por brutalisht i padëshirueshëm - liberal - për mendjet e mbylluna të fanatikëve komunistë në Shqipëri.

A.D.: Liria e ardhur në Shqipëri pas komunizmit dhe ajo e ardhur në Kosovë pas luftës, mendoni se u projektuan si duhet në kulturat respektive, veçanërisht në letërsi?

S.R.: Ka pasë për shumë vite (deri në vitin 1990) ma shumë letërsi të lirë - megjithëse ma të pakët në Kosovë se në Shqipëri. Në Kosovë u pengue zhvillimi i lirë artistik letrar; në Shqipëri u vra fare!

A.D.: Në pikëvështrimin tuaj, të ngrohtë shpirtnisht për hir të atdhedashunisë, por të ftohtë racionalisht për hir të largësisë, cila është ngjarja më fatlume që ka ndodhur brenda territorit të Shqipërisë pas rënies së komunizmit?

S.R.: Pa dyshim, ngjarja ma fatlume që ka tronditë Shqipërinë mbas ramjes së komunizmit ka qenë demonstrata e 8 dhjetorit 1990, kryevepër e studentëve të Universitetit të Tiranës dhe universiteteve të tjera që u bashkuen. Aty ka lindë dhe është ndez zjarri i revoltës antikomuniste dhe nji mrekulli e vërtetë! - u përcaktue edhe riorientimi politik i Shqipërisë për dekada me radhë. Vetë udhëheqësi komunist Ramiz Alia deklaroi se... me demonstratat e studentëve kuptova se sistemi jonë socialist ka dështue!

"Edhe ne si e gjithë Europa". Kjo shkëputje e preme nga kampi komunist mund të vinte vetëm nga nji vend si Shqipëria, ku shtypja e vorfnia ishin të përgjithshme dhe thellësisht antinjerëzore.

Për të parën herë në historinë moderne, Shqipëria gjeti vehten në shoqni të botës perëndimore dhe e ekspozue idealeve të lirisë e demokracisë, Shqipëria fitoi nji mundësi me u zhvillue në çdo pikëpamje. Me sukses? Fatkeqsisht, jo të plotë!

Megjithatë, unë kam besim se do të kemi nji ringjallje "të dytë", kur influenca negative komuniste do të jetë nji smundje e tejkalueme!

SAMI REPISHTI

Nën hijen e Rozafës

Narrativë e jetueme

Onufri
30 TIME

MONUMENTET E TRADITËS NË SHKODËR

Nga Willy Kamsi



Po të vështrojmë qytetin e Shkodrës në planin urbanistik historik, do të shohim se evolucioni i tij zhvillohet në dy faza. E para, kur Shkodra, si qytet mesjetar sillej rreth kodrës së kështjellës, nën mbrojtjen e kësaj të fundit dhe e dyta kur, për shkaqe të ndryshme të zhvillimit ekonomik, kulturor për arsye shëndetësore, por me ju shmangë përmbajtjeve të herëmbashërshme të Drinit dhe kënetëzimit ndjekës etj., shkëputet prej hijes së kështjellës, së pari tue u shtri në fushen nga kalonte rruga mesjetare drejt Drishtit e krahinave malore mbas tij, aty ku sot kemi lagjen Tophanë (lëvizje që fillon kah fundi i shek. XVI ose fillimi shek. XVII) dhe ma vonë hap mbas hapi merr drejtim kah Lindja e JL tue krijue lagje të reja të cilat erdhën tue kapërdi katunde to shkëputuna nga qyteti, por që me kohë u bënë logje të tij, si qenë Gjuha doli (i përmendun qysh më 1371) apo Rrëmaji. Tophana nuk qe kurrë fshat jashtë qyteti, por si e thotë emri i saj, së pari qe fusha ku u përgaditën nga turqit topat për me gjuajtë Shkodrën gjatë rrethimeve të fundit të shekullit XV.

Zhvillimin ma të madh qyteti e mori në shek. XVIII e sidomos në shek. XIX. Deri vonë kanë qenë në kambë ndërtesa që mbajshin të skalitun në gur të portave të tyne vjetin e ndërtimit. P. sh. ndërtesa e Bep Muzhanit, sot e shembun për me ndërtue pallatet në Bulevardin -Marin Barleci-, mbante vjetin 1796 (ruhej në muze, sot nuk gjindet ma).

Një veçori që e dallon Shkodrën asht ndamja e saj në dy mënyra të vecanta ndërtimi e banimi. Në një anë kemi qytetin me ndërtesa të ngjituna njena me tjetrën, sikur dojshin të mproheshin, me dyer me frengji me mure të nalta rrethuese, në mënyrë që syni i anmikut të mos depëronte në mbrendinë e tyne, me rrugica të ngushta, të përdredhuna shpeshherë rrugica qorre të ndërtueme në mënyrë të tillë sikur dojshin banuesit e kësaj pjese të ruheshin nga sulme të befashme, të paprituna. Kjo anë banohej dendësisht, kishte kopshtije të vogla, të cilat mjaftoheshin me një kullë sanë për lopën, që kishte çdo shtëpi, për me përballue nevojat e jetesës. Në këtë ekonomi hynte edhe rritja e krimbit të mëndafshit, që kultivohej dhe ishte një burim i randësishëm të ardhunash për familjen qytetare dhe që dëshmohej prej blivje të shumtë që ka pasë deri vonë. Për kohën e sundimit osman, kjo anë përbante një lloj getoje për popullsinë katolike, e cila tue qenë se nuk lejohej të banonte në qytet shtyhej vazhdimisht në periferi të tij dhe vendi i saj i maparshëm banohej nga popullsia myslimane në ekspansionin e vet drejt qendrës së qytetit. Ndërsa, në anën tjetër,

kemi qytetin me bahçe të mëdhaja, të punueme mirë, me pemë frutore e me shtëpia të veçueme, me karakter në thelb bujqësor. Bahçevanët e Shkodrës, kryesisht myslimanë, janë dallue në këtë, tue marrë emën jo vetëm mbrenda kufijve të qytetit të lindjes, por edhe përtej tyne deri në Ballkan e Stamboll. Shtëpiat e ndërtueme me çardak të hapun janë vërejtë si në anën myslimane, ashtu edhe katolike të Shkodrës. Tipike me çardak të hapur, ka qenë shtëpia e B. Muzhanit, që kemi përmendë ma sipri, e vjetit 1795 dhe e studiueme prej gjeologut etnograf Franc Nopça. Fazë tjetër ndërtimi kanë shtëpiat gjithnjë me çardak, por këtë herë të mbylluna me vetratë (prej këtyne kemi pasë dy shtëpia të familjes Shiroka, në rrugën Skanderbeg).

Në fund, për shtëpiat me çardak, kemi ato në të cilat çardaku, jo ma me zgjatje në fasadë, paraqet anën e ngushtë nga ballina e shtëpisë dhe thellohet në mes dy rradhësh dhomash. Në këto shtëpia shkallat kishin vendosje të ndryshme, qoftë në ballë, qoftë në mes të gjatësisë së çardakut (të shihen për këto ato të St. Biankut (ish Konvikti -Malet tona-), të Gasper Shirokës, të Kolë Berdicës, të Pjetër Daragjatit, të Pjetër Çobës, të Gjon Çobës etj.).

Nga fundi i shek. XIX dhe fillimi i shek. XX nisin të ndërtohen shtëpia të një tipi, apo tipesh të reja, pa çardak (simbas traditës), por që barin të prume nga jashtë dhe që, në shumë rase, të gërshetueme me elemente tradicionale, i japin qytetit pamjen e një qyteti modern të tipit perëndimor e jo ma oriental.

Prej një pamjeje të pjesshme dhe të shpejtë të zhvillimit të Shkodrës, lind nevoja e ruajtjes së disa pjesëve karakteristike që të mos humbin disa vlera të çmueshme të traditës sonë për me ruejtë identitetin, sepse një popull që nuk njeh të kaluemen e vet dhe nuk e mpron e nuk e ruan, nuk ka identitet. Si e pamë në vija të përgjithshme, këto ishin tiparet dalluese të Shkodrës si qytet. Tashti del një pyetje. Sa janë pasë parasysh kërkesat për me i ruejtë këto tipare dalluese? Që një qytet duhet të zhvillohet, ashtë e pamohueshme. Ky nuk mund të kristalizohet në një gjendje në kundërshtim me kërkesat e natyrshme të zhvillimit ekonomik e kulturor të një populli. Por njëheri na nuk duhet të mohojmë gjithçka nga e kaluemja, nga traditat e lavdishme, traditë që e bani të njohun Shkodrën në botë, të këpusim me një fjalë të gjitha urat me këtë të kalueme.

Një shkodrane që u kthye në Shkodër më 1953, mbas katërdhjetë vjetësh që ishte largue, kur e pau qytetin tha: "Për egoizmin tim po më pëlqen me e gjetë

si e kam lanë, sepse më zgjon shumë kujtime, por si shkodrane më vjen keq që nuk ka ndryshue. Deri më 1953 Shkodra ende nuk kishte pësue atë goditjen e madhe që do ta damtonte në mënyrë të pandreqshme në vlerat e saja ma të spikatuna." Deri në atë kohë, regjimi komunist kishte dhanë shejat e para të asaj që do të bahej në të ardhmen, tue ulë muret e nalta karakteristike dhe tue prishë vorrezat myslimane, për me nxjerrë gurë për shkallaret e stadiumit që po ndërtohej. Aty përfunduen me qindra e qindra mbishkrime në gjuhën turke, me një humbje të madhe të kulturës e të historisë së vendit tonë.

Thohet se një vend që nuk ka kujtesë nuk ekziston. Për ne kujtesë ishin monumentet të çfarëdo natyre, që u zhdukën me një tërbim kambëngulës e të papërmbajtun, tue pasë si synim prishjen e lidhjeve të Shkodrës e të shkodraneve me të kaluemen, për me himnizue një person: një regjim dhe një ideologji, që paraqiteshin si fillestarët e çdo gjaje në një Shqipni, së cilës i mohohet çfardo tradite e përparimi.

Kemi thanë ma sipri se Shkodra mesjetare shtrihej rreth kështjellës. Kjo pjesë e qytetit në një kohë jo shumë të largët, simbas zonifikimit të tij, gjindej jashtë vijës së verdhë. Të ishte jashtë vijës së verdhë, donte me thanë mos me u njehë qytet. Këto janë mospajtimet e një mentaliteti dinak e shkatrimtar. Simbas këtij, Shkodra nuk ishte Shkodër. Prej kësaj kemi në vazhdimësi zhdukjen e një vargu monumentesh.

Vetëm në zonën e Pazarit dhe rreth kështjellës, kemi pasë aq material studimor sa për me shkruue një numër të madh studimesh e librash. Krahas degradimit të ngadalshëm, të padukshëm e të vazhdueshëm, një ndër faktorët kryesorë që i dha dorë shembjes përfundimtare të Pazarit, një ndër ma të randësishmit e Ballkanit, qe zhdukja e tregut privat dhe e veprimtarive private karakteristike e tradicionale të tij. Me Pazarin u zhduk edhe Bexhisteni, një ndër të paktit që kanë pasë mbetë në Ballkan e i vetmi në Shqipni.

Qysh ma parë u veprue tue hedhë me dinamit Hamanin turk, hamani i rrjedhun prej transformimit të kishës mesjetare të Shën Vlashit, monument i përmendun në Katastin e Venedikut të vjetit 1416-17. Krahas me të u prish pranë Qafës, ose ma mirë u la të prishej, një ndër monastiret mesjetare të mbetun në kambë, si dhe xhamia e Selvisë edhe kjo e ndërtueme mbi një ndërtesë kulturi, prej atyne të përmenduna prej Marin Barleci të Rrethimi i Shkodrës, dhe që në kohën

e prishjes paraqitte tri faza të ndryshme ndërtimi. Përtej Bunës u rrafshua kisha e Shën Mërisë Tebuna ose e Shën Mërisë Magdalenë mbrenda së cilës gjindej varri i Imzot Benigno Albertini me një mbishkrim në gjuhën shqipe, të cilit nuk i gjinden as mbeturinat e që ishte një ndër dokumentet e pakta në gjuhën shqipe për atë periudhë të fillimit të shek. XIX, në mos i vetmi.

Dam i madh iu shkaktue dokumentacionit epigrafik si në vorrezën pranë xhamisë së Ajasmës, po ashtu edhe në objektet e ndryshme që gjindeshin në Pazar të vjetër. Këtu ashtë me vend me kujtue punën e çmueshme të z. Hamdi Bushatit, që këto mbishkrime i përshkroi, i përktheu dhe i ruejti.

Gjithnjë aty pranë, me rasen e Revolucionit kulturor u shkatërrua minarja e xhamisë së Plumbit, ndërsa zyrtarisht thuhej, se i kishte ra rrufeja, gja jo e vërtetë, për me mbulue mizorinë e bame. Po ashtu në të njëjtën kohë rrafshohej një tjetër ndërtesë kulturi, Kisha e Zojës së Shkodrës, afër urës së Bahçallekut dhe Kisha e rëndësishme e Vaut të Dejës e shek. XIII e stilit romanik, e vetmja e plotë që kishte teprue në këtë stil mbas asaj së Shirqit.

Në qytetin e ri kemi prishjen e xhamisë së Tophanës të shek. XVI, xhaminë në Xhabijej bashkë me vorrin e Hamz Kazazit. Po ashtu kemi shkatërrimin e bibliotekave e të muzeve të Etënve françeskanë e jezuitë bashkë me arkivat e pasuna, si dhe stacionin e parë meteorologjik në Shqipni, i cili funksiononte qysh në vjetet 80 të shekullit të kaluem pranë Kolegjit Saverian. Prishja e ndërtesës së bibliotekës françeskane ka qenë një veprim kundër kulturës si dhe kundër veprës krijuese si arkitekt At Gjergj Fishtës. Kush na siguron se e gjithë kjo të mos ishte zbatim i një plani për me ia humbë tiparet shqiptare qytetit tonë? Jam i vetëdijshëm se kam lanë jashtë shumë e shumë objekte të tjera ndërtimore me vlerë për historinë e kulturën qytetare shkodrane. Kjo duhet të jetë detyrë e institucioneve që janë të caktueme për mbikqyrjen e kësaj pasunie, por që fatkeqësisht do të punojnë për monumente që nuk ekzistojnë ma.

Ruajtja e traditës sonë, e cila në qytetin e Shkodrës ka pësue damtime të pallogaritshme në planin kulturor e historik, kërkon që të bashkojmë përpjekjet tona me qëllim, që ai pak që na ka mbetë të ruhet e të mbrohet e çka ashtë zhdukë të rivlerësohet nëpërmjet një studimi të bazuem në dokumentacionin që kemi, në mënyrë që të ringjallet në kujtesën tonë si kulturë e kaluemja e lavdishme e një Shkodre simbol i gjallnisë së përhershme të popullit shqiptar.

Tema e Kosovës në letërsinë e shkrimtarit tonë të madh, Ismail Kadare, ka zënë vend qysh në librat e hershëm të tij. Kosova është trajtuar sa në prozën letrare, po aq dhe në poezi, por më së shumti në librat eseistike e publicistikë të këtij autori. Vlen të përmendet këtu novela “Krushqit janë të ngrirë”, botuar pas demonstratave të studentëve kosovarë në vitin 1981, pastaj tregimi “Baladë për vdekjen e J. G”, i cili flet për vrasjen e shkrimtarit dhe gazetarit kosovar në Gjermani, Jusuf Gërvalla, në vitin 1982, poezitë shumë të njohura si: “Mundja e ballkanasve nga turqit në Fushë të Kosovës më 1389”, “Atje larg në veri”, “Kosova”, “Terrori në Kosovë” etj. Ndërkaq nga librat eseistike e publicistikë që trajtojnë çështjen e Kosovës (historinë dhe mitin, politikën dhe luftën etj.), veçohen: ditari për Kosovën “Ra ky mort e u pamë” (1999), “Bisedë përmes hekurash”, (1999) - seria e letrave të shkëmbyera mes Kadaresë dhe Ukshin Hotit, në vitet kur ky i fundit mbahej në burg nga shteti serb, pastaj eseja “Shqiptarët në mijëvjeçarin e tretë”, si dhe shumë shkrime, letra dhe intervista të ndryshme etj.

Por, një libër i vogël për nga faqet, por i madh për nga vlerat (i cili nuk është se është trajtuar aq shumë nga ana e studiuesve dhe e shtypit), “Tri këngë zie për Kosovën”, shpalos më së miri prozedun kadarean të çmitizimit të miteve përmes letërsisë.

Siç dihet, letërsia e Kadaresë, në pjesën dërmuese të saj, rrek tema të mëdha letrare, në mesin edhe tyre çmitizimin e historisë. Temat historike për të cilat shkruan Kadareja, në disa raste dalin krejtësisht të zhveshura nga të gjitha paragjykimet nacionale, ideologjike dhe të tjera.

Kështu ndodh edhe me librin “Tri këngë zie për Kosovën”. Ky libër nuk “himmizon” vlera historike të asnjë kombi, bile as ato të kombit shqiptar. Pas leximit të librit titulli “Tri këngë zie për Kosovën”, na del një lloj “mashttrim optik”. Këtu nuk vajtohet Kosova e pushtuar dhe e persekutuar, por përshkruhet saktësisht koha kur lindi miti për Kosovën. Këtu Kadareja nuk na jep as baladën e as elegjinë për Kosovën. Përkundrazi, na jep të kuptojmë se popujt ballkanas u detyrohen fatkeqësive dhe luftërave të vazhdueshme pikërisht për shkak se janë peng të hipotekave historike. Ballkanasit kanë më shumë se 6 shekuj që kur vazhdojnë të jenë viktimë e miteve të rreme, apo siç i koncepton Kadareja në këtë vepër: i këngëve që ndjellin zinë dhe kobin.

Në këtë kontekst do të mund të konkludonim se ky libër i Kadaresë është saga më e bukur letrare e humbjes së fisnikërisë evropiane të popujve ballkanas.

Ashtu si dhe një numër i konsiderueshëm i librave të Kadaresë edhe “Tri këngë zie për Kosovën” nuk mund të klasifikohet me saktësi në një gjini të caktuar letrare. Dikush e ka quajtur roman i vogël trepjesësh, dikush libër novelash, dikush tregim parabolik, dikush tjetër përmbledhje me tregime etj. Vet autori, duke rrëmuar thellë në misteret dhe honet e historisë dhe të miteve, këto tregime i ka quajtur këngë - këngë zie.

Sidoqoftë, tregimet që e përbëjnë këtë libër: “Lufta e vjetër”, “Zonja e madhe” dhe “Lutje mbretërore”, na japin “antitezat” letrare të Kadaresë mbi luftën e zhvilluar

Një lexim ndryshe i librit “Tri këngë zie për Kosovën”

ANTITEZA KADAREANE E MITEVE BALLKANIKE

Arben Veselaj, Prishtinë

në Fushë të Kosovës më 1389, mes të ballkanasve të krishterë dhe ushtresë së Perandorisë Otomane, që kishte nisur pushtimin e Evropës.

Tregimi i parë “Lufta e vjetër” bënë fjalë për përgatitjet që dy palët - në njërin anë otomanët pushtues dhe, në anën tjetër, mbrojtësit ballkanas, i bëjnë para se të ndeshen në një betejë të përgjakshme në ditën e 28 qershorit të vitit 1389. Tregimi sjell ankthin e një lufte të pashmangshme, ndjenjën për humbjen e pashmangshme në betejë, si dhe vdekjen e pashmangshme që vjen në fund (duke përfshirë këtu, siç thotë autori “dy vdekjet e mëdha” - të princit serb, Llazarit dhe sulltanit osman, Muratit). Këtu ndihet ankthi mesjetar i parabetejës, frika të cilën mezi e fshehin princërit ballkanas dhe, natyrisht, e

pashmangshmja “kapardisja ballkanase”.

Tregimi i dytë “Zonja e madhe”, i cili mund të konsiderohet më i realizuari brenda këtij libri, flet për krejt atë që (mund të) ndodhë pas një beteje ku kanë lënë kokat dy mbretër, pas përgjakjes dhe pas humbjes së madhe. “Zonja e madhe”, që ka kuptimin metaforik për Europën, është, po ashtu, sinonim i vendit të ikjes nga lufta, i mërgimit, i arratisjes etj. Rrëfimi për rapsodët, që zë vendin pothuajse qendror të këtij tregimi, na jep një pasqyrë reale të mendësisë së ballkanasve: fiksimit të tyre për ta kthyer për vete historinë (për ta krijuar për vete eposin dhe mitin), edhe nëse ajo sajohet mbi fakte krejtësisht të paqena. Përshkrimi se si tërhiqen rapsodët (lahutarët shqiptarë dhe gusllarët serbë

e vllahë etj.) mbi një kodër, prej nga ku e vështronjë plojë e përgjakshme të Fushës së Kosovës, na jep njërin nga tablotë më të goditura letrare, mbi luftën që më të madhe e ka hijen e mitit se sa fuqinë e argumentit historik. Kadareja, si asnjë autor tjetër, këtu na jep tablonë e saktë mbi zanafillën e mitit për Kosovën - atë çastin fillestar kur lahutarët shqiptarë dhe gusllarët serbë stisin historina trimërie dhe heroizmi për luftën e Kosovës ashtu siç u shkon për shtati zotëve (padronëve) të tyre.

Tregim i tretë (i fundit) i këtij libri “Lutje mbretërore”, që është një monolog i sulltanit turk, Muratit, është një nga tekstet më të fuqishme që ka shkruar ndonjëherë Ismail Kadare. Ky monolog mbase e përshkruan përmasën më reale dhe më të saktë të fatkeqësive ballkanike. Sulltan Murati, nga varri i tij i madh (shih ironinë: ai varr i madh është krejtësisht bosh!) në Fushë të Kosovës, paralajmëron luftëra të reja, fatkeqësi të reja mbi Ballkan.

“Allah, u lodha gjashtëqind e ca vjet, mbret i vetëm midis gjithëkahnajës së krishterë. Nganjëherë, në orët më të rënda më sillet dyshimi se mos gjaku im është zanafillë e këtij tmerrri. Zot, bëj që ta heqin gjakun tim nga kjo fushë e ftoftë. Bëje o Zot, shkule krejt baltën përreth sepse mjaftojnë vetëm ca pika gjaku për ta ndryrë brenda gjithë kujtesën e botës”.

Libri “Tri këngë zie për Kosovën” është shkruar pikërisht në kohën e luftës së fundit në Kosovë, më 1998-1999, e, ndërkaq, pikërisht në këtë kohë Kadareja e kishte shkruar dhe një tjetër libër me temë Kosovën - ditarin “Ra ky mort e u pamë”, përmes të cilit ai, natyrisht, merrte anën e shqiptarëve duke iu kundërvënë ashpër agresionit serb. Pra, në rastin e parë kemi një prozë letrare (“Tri këngë zie për Kosovën”) ku autori nuk mban anë të asnjërës palë, kurse në rastin e dytë - në veprën publicistike “Ra ky mor e u pamë”, ai hapur del kundër serbëve.

I vetëdijshëm se shkrimtarët me veprat e tyre fikzionale shpeshherë mund të bien në kurthet e moskuptimit dhe të keqinterpretimit, ashtu si edhe në disa vepra të tjera, edhe tek “Tri këngë zie për Kosovën”, Kadareja, si një mjeshtër i madh, na i jep të dekoduar figurat historike; na i jep të zhveshura kumtet e errëta të miteve që nxorën historitë nacionale të popujve ballkanas, dhe, në fund, na i parqet lakuriq prapaskenat nacionaliste e politike që vazhdojnë të rrojnë nga mitet ballkanike.



Romani “Një engjëll veshë me frak” i dramaturgut dhe roancierit Stefan Çapaliku, pedagog i estetikës në AA dhe ndër anëtarët më të rinj të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, na vjen ndryshe nga lloji i narrativës së gjatë që ka lëvruar ai këta vitet e fundit; që nga ana formale prej shënimeve-klishe që vënë regjisorët kineastë e mjaft autorë të letërsisë, në ekspozitë e veprave të tyre, “për t’u shfaqësuar” nga çdo përngjasim me persona apo ngjarje reale, nënvizuar këtu se *përngjasimi* “nuk është i rastësishëm”. Megjithatë, ai nuk ka hartuar biografi a regjistruar ngjarje, si kronikë qytetëse, por gjetja e tematikës dhe thurja janë shumë origjinale dhe romaneske, janë prurje në kohë (a të vonuara), që Shkodra i priste dhe pret të tjera, të dalin në dritë. Sepse, në një qytet arti, letërsie dhe arsimit të hershëm e në ballë të zhvillimit të kulturës së një vendi: me gjimnaze reale e klasike, me kolegje të njohura në mbarë Europen – me mësim në gjuhë të huaj e në gjuhë amtare, sidomos – karakterizuar nga koha e vrullshme drejt oksidentit, krijohen kushte ku lindin drama e tragjedi, poema dhe epope, tregime e romane, pasi figurat e shquara në këta lëmenj i krijonin ato me jetën e veprimtarinë e tyre, në mënyrë të veçantë përgjatë shndërimeve të thella politike e shoqërore.

Paslufta e gjeti Shkodrën me poetë e prozatorë, mjekë, profesorë dhe juristë të shkolluar në Europë, sportistë të shumë llojeve sporti që kishin lindur në këtë qytet para gjysmë shekulli e, mbi të gjithë, përkthyes të veprave e kryeveprave botërore, nga “Iliada”, “Komedia Hyjnore” e “Fausti”, “Manzoni” e “Molieri” etj., ashtu siç ishte në prag e gjatë Luftës II Botërore. Nuk kishte munguar as arti muzikor në këtë qytet, që nga shoqëritë e vjetra në dhjetëvjetëshat e parë të shek.XX, si Shoqëria “Bogdani”. Kjo, edhe për faktin se në atë kohë po zhvillohej teatri, që i dha hov jo vetëm skenës, por edhe muzikës teatrorë – melodramës, një lloj muziko-letrar që zë fill me Fishtën e “Judës Makabe”, me shumë të tjera, ku shkëlqente “Jerina ase Mbretnesha e luleve”, pa lënë jashtë kësaj gjinie melodramatistin më prodhimtar, poetin Ndre Zadeja, pushkatuar së bashku me simbolin e Atdhetarisë së Malësisë, Prekë Calin.... Ishte zhvilluar muzika në traditën e krijuar prej vëllezërve Kurti, deri tek *Akademia Muzikore* e Atë Martin Gjokës, që kishte sjellë në udhë të artit Mjeshtrat e Mëdhenj të ardhshëm: Tonin Harapi, Tish Daija, Çesk Zadeja e më të riun – ndoshta më të talentuarin- së paku, guximtarin e pashoq, Prekë Jakovën, që mori përsipër dhe ia doli të kompozojë Operën e parë shqiptare e, me baketin në dorë, të bënte edhe dirigjimin e saj, me forcat e talentuara të muzikës orkestrale qytetare shkodrane. Tre të parët kishin pasur fatin të shkonin për studime universitare në Moskë dhe, me t’u kthyer, të qëndronin në kryeqytet....I vetëm në qytetin verior kishte mbetur veç Pol Gjakova, në emrin e të cilit sikur peshonte gjithë barra e veprimtarisë muzikore të Shkodrës. Bash këtu nisin ngjarjet e romanit të Çapalikut, në gjysmën e parë të viteve 1960-1965, kur dhe ka lindur vetë autori i kësaj vepre.

Gjëja e parë që na bie në sy, kur hartojmë apo dhe lexojmë një fabul romaneske, është struktura e saj, një tregues që shkrimtarët nuk e fitojnë lehtë, por tashmë S. Çapaliku, ka shkruar mjaft larg në këtë mjeshtëri. Ai e ka organizuar intrigën e veprës në katër libra dhe në katër intervale – një mënyrë rrëfimi progresiv a linear, ku krijohen mundësi digresioni në përshkrimin e ngjarjeve apo veprimeve të personazheve. Gjithashtu, krijon mundësinë e ndërrimit të vetave të kallëzimit, veçanërisht, tek intervalet, ku protagonistit zë e tregon në vetën e parë. Me një lexim të vëmendshëm, hetohet qartë se intriga e kallëzimit artistik të autorit është ajo që e mban ngjitur tekstin narrativ, me

Roman i Stefan Çapalikut, Botimet “Fishta”, 2022

“NJË ENGJËLL VESHË ME FRAK”

Prof. Dr.Tefë Topalli

në fjalë, pasimin e fazave të ndryshme të historisë, të treguara në atë mënyrë që marrësi (receptuesi destinator) të mund të kuptojë zhvillimin e ngjarjeve, duke i vargëzuar në mes tyre – një paraqitje që autori ynë, këtu e shpreh dhe e kufizon, në libra e në intervalet meditative, nëpërmjet numrave, që, simbolikisht, nuk e kalojnë dhjetën. Duke iu përmbajtur këtij rendi, themi se bashkësia e ngjarjeve që përbëjnë fabulën e tekstit të këtij romani, vjen e vendoset në një bosht logjik-kohor-shkakësor, për t’i lënë autorit dorë të lirë në *gërshetimin* e elementeve të historisë, siç ka pëlqyer ai që epilogu i veprës të zërë vendin e prologut.

Klara Deda, heroina kryesore e kësaj vepre, që na shfaqet në Librin e parë, tjetërsohet papritur *kokë e këmbë brenda një burke sterrë të zezë* dhe, si nëpër arkapijat e dikurshme migjeniane, të shtëpive të ulëta të mëhallës së vet, niset për takim *incognita*, me njeriun më të dashur të jetës së saj: jo buzë liqenit, as në një skaj lulishteje, jo jashtë qytetit....por në morgun e spitalit; pra nisej për një takim me një *kufomë*, një *kadaver*, para së cilës do të përlojej e do ta përqafonte, si të ishte i gjallë, si në të gjallë

të tij....! Një takim makabër i një kurtizaneje, që kishte dashuruar, ashtu si dinte ajo, i ishte dhënë atij, që, mbi dashurinë për të, ushqente dhe sundohej prej një *dashnie* tjetër: *dashnisë* për artin, për muzikën, për këngët dhe operën që do t’ia falte Shkodrës dhe gjithë vendit, ashtu të plotë dhe me jehonë të përjetshme, ndonëse ia rrudhën e shkurtuan, deri edhe duke i hequr një akt të tërë! (*Do të kalonte gjysmë shekulli që historia e muzikës shqiptare, vetëm këto ditë, ta mësonte se vepra e tij kishte pasur 4 akte!*). Nuk ishte vetëm kjo: S. Çapaliku na sjell me dhimbje edhe *ngjarjen jo të rastësishme*, se qyteti i lindjes së tij, kishte për një kohë të gjatë 13 burgje (!) dhe më e habitshmeja, se kompozitori Pol Gjakova mbahej gjithë natën në burg e, mëngjeseve, i lidhur durash – shtrënguar deri plagë - shoqërohej me ushtarë (fyer e keqtrajtuar prej tyre) për në Shtëpinë e Kulturës, në punë me orkestrën që do të luante në Operën “Diella”...një muzikant i burgosur, një kompozitor duarlidhur, që ngushëllohet në dëshpërimin e vet: *“Të jetë për kështu, ma mirë të mos dalësh hiç prej burgu. Në burg njeriu mundet me qenë edhe ma i lirë, të*



paktën, në pikëpamje muzikore. Muzikalisht i lirë. Sa më pëlqen kjo gjendje: muzikalisht i lirë...!” Në çaste si ky, lexuesit i vjen në ndihmë *informacioni i mbuluar*, info jashtë atyre që jep teksti me paraqitjen gjuhësore semantike, konkretisht, për Shkodrën, në kohën kur kishte më tepër burgje se shkolla, në vitet e para të Pasluftës, kur partizanët arrestonin njerëz të pafajshëm dhe digjnin biblioteka, nxirnin jashtë familje “reaktionare” dhe i çonin në internime me gjithë gra e fëmijë; ishte koha kur nën zë këndoheshin nëpër qytet dy vargjet “e famshme”:

Nga na ardhën këta partizanë,
që na prunë këtë faqe t’bardhë !”

Ndryshe nga trilogjia e suksesshme “Secili çmendet sipas mënyrës së vet”, ku autori përshkruan fazat e jetës së qytetit të lindjes, në mënyrë paralele me fazat e jetës së tij, nga fëmijëria, nxënës shkolle, student, mësues dhe pedagog universiteti, në këtë roman ka përjetime të tjera: është kujtesa e pashlyeshme e një qyteti të vjetër si Shkodra për njerëz e ngjarje, që bëhen leitmotivi për të shkruar, jo kronika të mbledhura nga subjekte që ka njohur e njehe, por ato mbresa që vijnë e transmetohen ashtu valë-valë ndër brezat e një shoqërie. Këtë prurje të kujtesës qytetare nëpërmjet të tjerëve, Çapaliku e ka romanizuar edhe me atë që del si informacion i mbuluar, tip mesazhi që quhet *presupozicion*. Autori nuk e pohon, por situata e përshkruar, e çon lexuesin tek mendimi se njerëzit me popullaritet e të adhuruar, nuk mund të bashkëjetojnë me diktaturat, prandaj dhe Gjakova është përherë nën vëzhgim, sepse gëzon simpatinë e mbarë një qyteti si Shkodra.

Dikur, shkruan autori, edhe atij mun t’i thoshin *“Mjaft duke marrë pas vetes të gjithë qytetin!”* A nuk ishin zhdukur ato vite drejtues administrate të lartë të shtetit dhe udhëheqës partie, të afruar aq shumë me popullin, si: Z. Islami e Nd.Marashi, apo generali çam Seiti, që në këtë periudhë ishte në krye të Degës së Brendshme të Shkodrës, ku kishin drejtuar oficerë të lartë, që do të bëheshin edhe z/vendës edhe ministra të brendshëm të Republikës! Aludohet se jo pa qëllim, për anë kompozitorit kishin afruar Poetin e njohur të Realizmit Socialist, i cili, pas 5 vitesh do të shkatërronte bashkëqytetarin e vet, F.Paçramin, me artikullin demaskues *“dramfabrikuesi!”* Prandaj dhe autori i ka kushtuar një linjë më vete hetuesit Dhimitër Dine, që nuk i kursen vëzhgimet as ndaj Gjakovës, as ndaj vetë Poetit, i cili dëshmon haptas se ka marrë pjesë në funeralin e kompozitorit dhe, këtë e bënte, mu në Lidhjen e Shkrimtarëve, Tiranë! *“Ndoshta, ishte një kërkesë për vetëndeshkim?! Mazokizëm?! Një kërkesë që i vinte nga fundi i ndërgjegjës së tij të plagosur si s’ka më keq!”* - shkruan autori, sepse kjo nuk ishte e vërtetë. *“Ç’ishte ky mazokizëm?”* Dine i ka duart e lira të ndjekë, tëurvejojë e të thërrasë në Degë, këdo që dyshon; ai pret t’i raportojë shefit përkatës në qendër, ndërkohë që instinkti i tij arrin deri në përdhinimin e Dianës, vajzës së profesorit të nderuar të frëngjishtes....! Kjo situatë e nderë dhe e frikshme bënte që në disa faqe të romanit, një nga personat më të dashur të Shkodrës, anekdotisti Bep Tanushi, si



një krijesë e sjellë në jetë për të shfaqur shëmtinë e diktaturës, të na paraqitet pothuajse përherë i heshtur (kur nuk dinte të heshte asnjëherë) dhe, për habi, “*Të ngjante si më tragjik se kurrë ndonjëherë më parë !...Ishte hera e parë në jetën e tij, që nuk mund të prodhonte një fije humori...Ishte hera e parë që Bep Tanushi gjendej pa batutë, pa fjalë*” Një krijesë humori të gjenerojë tragjizëm – asgjë më pak se oksimoroni psikik brenda një qenieje....!

Është një meritë e autorit shumë origjinale, mënyra si na shfaqen personazhet e veprës, ashtu siç ka bërë përzgjedhjen Çapaliku, në një numër realativisht të vogël, nga: Klara, Poli (Maestro Gjakova), Aktori, Poeti, Diana, kapterr Kadriu, ushtar Jorgaqi, hetues Dhimitri, Bepi Tanushi, Taxhedin Grimci, Nëna e Polit, Nëna e Klarës, Prindërit e Dianës,

Zotëri Ethem (profesori i frëngjishtes), Timpanisti, Xhevati, Spala, Mihal Tardeli rrobaqepësi), e ndonjë krejt kalimtar, si Ilda Melgushi, pranë Kishës së Jezuitëve, pianoja e së cilës ndihej nga rruga pranë, kur u bënte mësim muzike të rinjve shkoldranë. Ata jepen e vepronë në masën e duhur, rriten para lexuesit: diskutojnë, aprovojnë a mohojnë; dashurojnë dhe urrejnë apo shfaqen indeferentë ndaj dikujt; për shembull, me Dh.Dinen nuk afrohet asnjëri, nuk duan të bashkëpunojnë, janë të frikësuar ndaj tij dhe e ndiejnë se ai përfaqëson të keqen, anën mohuese të lirisë së fjalës, me konsekuenca të rënda...! Klara, sopranoja e operas, megjithëse është e damkiosur nga ana politike, përpigjet të bëjë jetën e saj, ta gëzojë atë dhe asnjëherë nuk guxon të shprehë urrejtje për çfarë i kishte përse familja: “*Ajo duhej të përmbahej dhe të shihte punën e saj...Nuk kishte asgjë që ta lidhte atë, as me Pol Gjakoven, as me Aktorin...Me Pol Gjakovën?! Me Polin ndoshta, po. Vetëm me të. Me askënd tjetër në botë. Por Pol Gjakova, ky engjëll, që aq i lidhur me punën e vet, me muzikën, sa shpesh, për dreq, e harronte....Sa më shumë ta shtynte ai vendimin, aq më shumë do të zgjaste gjendja e saj ambigue: as kështu dhe as ashtu...*” Kur i kthehej dashurisë, Gjokova kompozonte këngë për të. Këngë dëshire për ta pasur pranë e ajo i këndonte, pa çka se fjalët e tekstit e kishin në burg autorin, *kushedi si i katandisur i gjori!*

Ndryshe është ravijëzuar kompozitori, si në marrëdhënie me të tjerë, ashtu edhe në botën e tij të brendshme si artist; mbi të gjitha, ai e kupton vendin që zë në shoqërinë e asaj kohe, zgjedh shokë e miq të mirë e besnikë, si Aktorin e Harpagonit, Tanushin, por asnjëherë Poetin, me të cilin mbetet gjithnjë në marrëdhënie formale profesionale: merr prej tij dhe i jep aq sa i takon libretistit të veprës! Pa qenë muzikant, Çapaliku ka mundur të përshkruajë formimin artistik të nivelit të lartë të Gjakovës, përdor terma specialë të artit të tij, veglave muzikore të orkestrantëve, nxjerr në pah mjeshhtërinë e dirigjimit dhe tregon se ai është çdo herë e çdo ditë në kërkim të përsosmërisë artistike, edhe pse bënte hapat e parë në udhën e vështirë të kompozimit të një veprë madhore, siç është një epera.

Si personazh i vënë në qendër të romanit, kompozitori Gjakova na vjen i dyzuar: me protretin fizik dhe psikologjik, si qenie e elitës shoqërore, ashtu edhe me interesat e gjera si muzikant e si artist, në arritjen e asaj që nuk ka mbërritur ende, për të shkuar përtej vetes, siç thoshte Niçeja. Fundi tragjik i tij, ngado që t'i ketë ardhur, është fundi i një njeriu me pasione të mëdha, i njeriut që dallon e ngrihet lart si intelektual e artist, sa del nga përmasat e së zakonshmes dhe, për rrafshin social të atyre viteve, vjen e bëhet i huaj, i pakrahasueshëm dhe i paarritshëm....!

Është mjeshtri e autorit të këtij romani që, pasi ka “deklaruar” se përngjasimet e personave e ngjarjeve, nuk janë të

rastësishme me realitetin, i vë në skenën e sekuenave narrative gjithë këta vehtje vepruese, duke na i zbuluar shkallë-shkallë, deri sa na i shfaq në disa apo vetëm në një tregues: dikë në planin fonetik të emrit (Tanushi-Palushi; Gjakova-Jakova), dikë me anë të mbiemrit (Grimci-Abdullah), e të tjerë. Pa u mjaftuar me këto të dhëna, heronjtë e veprës vijne e shfaqen edhe në rrafshin e karakterit, siç ngjet me Polin, i cili, para orkestrës apo këngëtarëve, nuk njihej më kur fliste për harmoninë, ritmin, pauzat, tonalitetin, ngarkesën e një note muzikore, por shndërrohej në gjithë qenien e tij. Kujtoj një çast të shkurtër, kur ai erdhi të takonte shokun e mikun e tij, profesorin tonë Leonard Deda (autorin e këngës së famshme “*Mbeta gjithë ditën hijeve...*”) – mësuesin e muzikës të shkollës pedagogjike, gjatë një senace prove me ansambilin tonë, ku unë bëja pjesë në korin prej rreth 100 vetësh! Ai mori drejtimin e orkestrës dhe bënte lëvizje të çuditshme, dinamike dhe aq të pakuptueshme për ne, sa kolegu i tij kompozitor, vetëm buzëqeshte me kënaqësi e përpigjet të hynte në botën e artistit të madh....! Edhe linja e njohjes e marrëdhënies të oficerit hetues Dine me vajzën e thjeshtë të Trikotazhit, Dianën e varfër, por të bukur, jepet sipas logjikës së një inkuizitori të diktaturës: gjithçka me imponim e dhunë, që nga njohja, së cilës vajza e frikësuar mundohet t'i ikë me fjalët e pacaktuara “*Një herë tjetër*”, kur ai kërkon ta ftojë në një lokal, deri tek paraqitja e detyrueshme në zyrë dhe përdhunimi shtazarak! Skena tipike nënshtrimi që, në të shumtën, janë mbyllur, por edhe janë shfaqur e dënuar nga partia-shtet e kohës.

Pa u zgjatur, autori nuk lë pa vënë në skenën e romanit edhe *heroizmin fals*, si propagandë të njeriut të ri, për të cilin sakrifica me jetën, nuk ishte asgjë: “*Katër burra rrinin përpara derës së hyrjes duke mbajtur mbi supë një arkivol...të vogël prej kompensate dhe i veshur me një cohë të kuqe....- Vijnë nga Rrogzhina. Kemi sjellë arkivolin e një vajze pesëmbëdhjetë vjeçe nga Dukagjini, që e ka zënë dheu i trasesë së hekurudhës...!...Shkon vajza e mitur në aksion? Pesëmbëdhjetëvjeçare të punojë?! Ikën shëndosh prej shtëpie dhe vjen e vdekur” Ky është kulmi – tha me zë të lartë Pol Gjakova....!” A nuk ngjasin si dy pika uji nëpërkëmbja e një fëmije aksionist me dhunimin e Dianës prej një zyrtari shtetëror??*

Tregimtaria e shkrimtarit S. Çapaliku dallon për një gjuhë të thjeshtë, të afërt me lexuesin; proza e tij nuk përmban struktura të rënda, të ngarkuara me vargje atributive të gjata, as me rende predikative të ndërmtuara e të ndërvaruara në largësi nga qendrat e organizimit sintaksor, por frazat, thëniet, paragrafi e teskti i tij në tërësi, brenda këtij romani, bie në sy për prurje dhe bashkërendim të njëjësive emërore, përdorim të elipsës dhe segmentimit të periudhave, si në shembullin e mëposhtëm, ku na shfaqen përdorime me vend a mungesa si duhet të subjekteve, sipas natyrës së shqipes: “*Tani nuk e çante më kryet për askënd. Ai do e vishte dhe do të dilte në rrugë i veshur kësisoj. Fundja po shkonte në opera. Opera që bekim për këtë qytet. Ai do e vishte frakun dhe do të vraponte fluturim e për te opera. Fluturim. Si një engjëll i veshur me frak....*”

Unë që e kam ndjekur jo pak krijimtarinë e romancierit tonë të ri, që nga poezitë e para, përgjatë tre dhjetëvjeçarëve, kam njohur logosin e tij të shkathtë në gjuhën dialogjike të shumë dramave, prej të cilave edhe kam parë ngjitjen e tij në skenë, e kam cituar këtë autor në libra ushtrimesh dhe në procesin mësimor me studentë në lëndën e *Gjuhësisë së tekstit*, në *Stlistikë* e në *Sintaksë*, shprehem me bindje se kjo vepër në prozë e S.Çapalikut, shënon një ngritje artistike dhe gjuhësore. Ngjyrimi i rrallë, aty-këtu, me leksikun gegë dhe shprehësinë e paskajores, vetëm se i japin dorë karakterizimit më të thellë të personazheve.



ANJA

Cikël poetik nga Ajne Iberhysaj

ANJA!

Anja, kërkojmë veten tonë
Nën luhatjet e egos së besimit
Çapitjet e hapave tuaja i preku syri
Kurrë nuk i ndieu shpirti.

Anja, në rininë tënde shumë herë e uritur.
Trupat përqafohen, ftohen, lekura që
puthitet, shkërmoqet...
Asgjë e re si vetë Cikli i Krebsit.

Frymënxjerrja e rënduar
sytë flasin më shumë se duhet dhe fjalët
heshtin
një dite si vetë frymëmarrja jonë.

Përqaqimet tona valviten me erën
përdridhen, trembin qerpikun
fryma jote shpirtit i jep frymë
qiellin e ngushton...
lotët sikur i bien me grusht tokës.

Muskujt tendosen, rinia ikën
Eshtrat lëshojnë zë krisme
Eh... bota sa herët paska fjetur.
Në kabare, Anja qëndron
Me vellon e reve të bardha vallëzon
Shpirti mban aromë limoni, vetminë
tënde
Buzët ndizen, të gjitha digjen zjarr!
Eh... bota sa herët kishte rënë për t'fjetur
Tinguj fjalësh, krim dhe ndërshkim.
Anja, në qiellin blu vetëm lutje
përpëliten.

Të guximshmit janë fitues të puthjeve
hajdute
vetëm frikacakët bëjnë luftë.
Të gjithë në qiell t'zhveshur jemi
Në sytë e tu, Anja, çdo gjë është art.

Anja, Itaka rënkon përherë.
Dashuritë bien me natën e errët
Nesër me të tjera ëndrra ato zgjohen
Në kabare muzika dëgjohej...

Shpirtin e zjarrtë vetëm unë ta njoha
Në sytë e tu, çdo gjë është art.
Të gjithë në qiell t'zhveshur jemi
Anja, në qiellin blu vetëm lutje përpëliten.

NË SYTË E ETJES

Do ta ruaj aromën e hijes tënde
Derisa, andrra jote lundron bri meje
Derisa ti të kthehesh, i lodhur e i
mërzitur

Në sytë e mendjes më shfaqesh
Gjerdan shpirti dhe margaritar n'buzen
e etur.

Përtej perdes t'mistertë
Enigmë e madhe shpirti i njeriut
Kjo sagë e zjarrte e zhurmshme brenda
nesh

Si kandil drite na e mban frymën.
“Një dashuri me puthje ere”
M'i trazon pareshtur dallgët, shpupurit
fjalët

Më sytë e etjes të kërkoj, në natën e
errët, lundroj bri teje
Në fund të fundit ti mbete feniks
I një dashurie me një puthje ere...

Një ditë, ndoshta ndonjëherë
Andrra jote do lundroj bri meje
Ndoshta, në atë ditë
Përqafohemi në sytë e etjes...!

BOHEME

T'i mbledh shikimet si rreze mëngjesi
T'i bëj kurorë fjalësh
Fjalët metastazë dhimbjesh
Puqen në qiellin e trishtë si vetë vdekja.
Ikin larg me erën...

Zogitë e struktur
Përqafojnë muret e shpirtit
Sytë marrin një copë Itakë
Fluturojnë larg me valët
Për inat shpirti bëhet rreze delirë
Retë mblidhen në nyjen e fytit
Trishtimi, boheme në dy sytë e ballit
Itaka vetëm mua më përket...
Nuk vdes nga trishtimi, asnjëherë nuk
vdes.

Mbetesh gjallë në sytë e Itakës!
Boheme në dy sytë e ballit.

LIND...

Dielli lind përsëri
Lind
Lind
Lind
Për mua
Për ty
Për secilin.

Ka kohë dielli
Ka vdekë në sytë e zi
Dielli lind
Unë vdes
çdo ditë
Në sytë e zi...

I

Sali Bashota, me një krijimtari cilësore për më shumë se tre dekada është emër në poezinë bashkëkohore shqipe. Krijimtaria e tij është e njohur kudo ku flitet shqip dhe në vende ballkanike e europiane, nëpërmjet përkthimeve dhe veprimtarive kulturore-letrare ku poeti ka marrë pjesë. Njëherësh, poezia e S. Bashotës është bërë e njohur edhe nëpërmjet shkrimeve kritike, studimeve, recensioneve dhe analizave shkencore, të gjitha këto nga dy drejtime, nga autorë shqiptarë dhe studiues të huaj, të cilët nxjerrin në pah cilësi të individualitetit të tij poetik.

Disa vlerësime:

Ali Podrimja: Venerohet se në të katër librat, shkallëshkallë riciklohen e tensionohen fenomenet dhe situatat ekzistenciale. E pranishme është sintagma *albumi i grisur*. Kjo rishfaqet gati në tërë tekstin poetik të këtij autori. Lë të kuptohet se në hapësirën tonë, ndodh ose ka ndodhur një tragjedi. Lexohet edhe si metaforë e kohëve mortore.

Bavjola Shatro fokusohet te *imazhi* dhe *koha* në poezinë e Bashotës, nën ndikimin dhe modelin krahasues të shkollave bashkëkohore amerikane.

Luan Topçiu: Poezia e Sali Bashotës ndodhet mes dy shqetësimeve që brejnë vetëdijen e një artisti që nuk mund të jetë indiferent për atë që ndodh rreth tij: ide fisnike, fenomeni i ndërgjegjes morale, shorti i komunitetit, fati i kombit si një shqetësim i rëndë historik, përjetime intime.

Gëzim Aliu: Vepra poetike e Sali Bashotës është artikulum përmes figuracionit, ideve dhe anës formale, i vetëdijes poetike të një shkrimtari që tashmë e ka krijuar të qëndrueshëm stilin e tij, shprehjen e tij dhe botën e tij artistike. Duke kapërcyer nëpër aktin sistemor të krijimit, poezitë e kësaj vepre dalin si perla të përpunuara të metaforave fine.

Redon Moerau: Emblema kombëtare kërkoi dhe gjeti më shumë se "pak dritë, pak dritë" bodleriane...Sintagmat burimore të shqipes së kulluar, gjenetikisht konservative, mbushullojnë në poezitë e tij, duke ushqyer shpirtin dhe ngacmuar mendjen e lexuesit dhe përjetuesit... Në të pasqyrohet individualiteti krijues origjinal dhe origjinal i ushqyer nga ngjyrat dhe ndjenjat e jetës sa vetjake aq edhe altruiste për përjetimin e sekuencave të fatit historik kombëtar, fatit fizik shpirtëror të njeriut tonë.

Rusana Bejleri: Uragani i ndodhive dhe fakteve përthyer në pasqyrën e dyfishtë - përmes perceptimeve individuale të një bashkëkohësi të tyre dhe më pas në një përpunim të rafinuar të simbolikës me figura të njohura të vetëdijes kolektive. Gërshetimi i simboleve dhe gama e ngjyrave do të lënë të lexuesi një gjurmë sensore të papërsëritshme, siç janë gjurmët e gishtave.

Marius Chelaru: Sali Bashota mjaft lehtë mund t'i "përngjitet" peizazhit poetik të aureolës në të cilën jeton nga disa pikëshikime, të cilat i kemi theksuar (lufta, mërgimi, vdekja e të afërmeve të tij në konflikte) por, në të njëjtën kohë, është edhe një zë disi i "distanuar", ndoshta edhe nëpërmjet faktit se dëshiron ta gërshetojë në poezinë e tij, metaforën me imagjinatën, si një lojë skene në të cilën dekori është një element fort i rëndësishëm.

Studiues të tjerë si Adil Olluri, Ag Apolloni, Berat Armagedoni, Flamur Maloku, Milazim Krasniqi, Ibrahim Berisha, Osman Gashi, Gëzim Arifi, Xhemal Ali Peci kanë mundur të identifikojnë prurjet, jo vetëm tiparet që tashmë e karakterizojnë dhe e përveçojnë autorin në radhën e poezisë së zgjedhur shqipe, por dhe risitë, të rendit stitistikor, të lëndës poetike si vlerë e rigjeneruar artistike e çdo krijimi të ri.

Poezinë e Bashotës - studiuar në njësitë bazike ligjërimore/figurative saj mund ta shohim tani në makrostrukturë, si grupohet,

MUZA E BEKUAR, VËSHTRIME KRITIKE TË POEZISË SË SALI BASHOTËS

nga Virion Graçi

funksionalizohet, risemantizohet në disa libra të cilët, për nga kompozimi, për nga parimi organizues i lëndës së përfshirë janë unikalë. Me të drejtë poeti dhe studiuesi Milazim Krasniqi, afrohet me idenë se, në fund të fundit, vepra poetike e një autori si Bashota, mund të perceptohet si një libër i vetëm.

Po i shohim sa për një ide të përafërt, më poshtë.

II

Libri "Përshpëritja e agonisë" (Libri i karantinës, 2020) është kronologji poetike e ankthit, vuajtjes, izolimit fizik, por dhe ditar poetik i rikuptimësimit të jetës, njeriut, qenies, marrdhënie ndërnyerëzore gjatë periudhës së kyçjes planetare nga covid-19. Jeta, kufiri i hollë mes vdekjes dhe mbijetesës, përditshmëria si frymim e lëngatë prozaikë, si ekuilibër i brishtë biologjik-shpirtëror-ekzistencial vendoset në qendër të çdo përjetimi, pavarësisht veshjes material/ilustruese, pavarësisht gjetjeve figurative të ligjërimit poetik. Te "Psherëtima e agonisë" kemi një (si) poemë të gjatë, të fragmentuar në njësi më të vogla të shprehjes - është ditari poetik i përsiatjeve në ditët e muajt e pandemisë botërore, covid-19. Siç shprehet autori: "Pëshpëritja e agonisë mund të jetë një libër i shpalosjes së ankthit e situatave ekzistenciale, në të cilin dimensionin psikologjik e rikuptimësimit frymën njerëzore, përbrenda një realiteti të ri dhe të panjohur në rrethana të tilla për njerëzimin që ka të bëjë me frikën nga e keqja e padukshme."

Bota e zakonshme materiale, sendet e përdorimit vetjak, objektet e jetës urbane, lëvizjet e shprehjet e zakonshme, veprimet me karakter të dikurshëm ritualistik -

jo domethënës tani, të para në optikën ndërgjegjësuere-ekzistencialiste, bëhen shenja të absurdit, etiketa të kotësisë e të përkohësisë. Ndihet se nën qiellin e fatqësisë së përbotëshme, çdo individ, e për rrjedhim edhe heroi lirik i Bashotës ia ka bërë vetes pyetjet e habitës filozofike: Përse? Çfarë? "Përshpëritja e agonisë" e "dokumenton" me imtësi gjendjen specifike të njeriut dhe njerëzimit në karantinë duke u kryer si poemë e agonisë.

Libri "Në fillim ishte drita", (99 poezi, 2017), shquhet për arkitekturë falë së cilës poezitë potencojnë njëra-tjetrën, secila rrezaton më vete dhe në strukturë. Janë tre grupe/cikle poezish ato që e përbëjnë librin.

Grupi i parë/cikli i parë titullohet SI, përmban 44 poezi, secila ka për titull një krahasim metonimik, sipas modelit: Si flaka e fantazisë; Si jeta në kozmos; Si urata; Si e bukura diellit; Si inulla e bukur, etj.

Cikli i dytë ka 32 poezi, të cilat, sipas emërit të ciklit - NËSE, fillojnë secila sipas gjedhës së titullit të përbashkët: Nëse çdo poezi fillon me ty; Nëse fanitet bukuri e praruar; Nëse zgjohen yjet; Nëse hesht nata, etj.

Cikli i tretë titullohet KUR dhe përbëhet nga 32 poezi, secila e emëruar sipas modelit: Kur mallin për ty diçka e tremb; Kur ndahet përgjysmë zemërimi; Kur ndryshket dryni i mërzisë; Kur vijnë çastet e bukura; Kur heshtin zogjtë, etj, etj.

"Në fillim ishte drita", është poemë e tri dimensioneve të një bote pa emër dhe pa koordinata, botë e mrekullueshme dhe e ndërë, e dliër dhe e tronditur, e shpërbërë dhe në kërkim të identitetit, në kaos dhe drejt rikuptimësimit duke pasur për shembëlltërë gjëra të njohura, idealisht të përkryera, të ndjera, të patjetërsueshme,

sikurse propozohet nëpërmjet titujve: SI ZJARRI I SHPIRTIT; SI QIELLI I NDRITUR; SI PËRQAFIMI I YJEVE, etj.

Nga dimensionin i shembulltërës së ciklit të parë me SI, cikli i dytë me NËSE parashtron dimensionin e rrethanës së domosdoshme: kushtet, mjedisin, cilësitë, pozicionimet etiko-morale e estetike ku bota e munguar bëhet e mbritëshme.

Dimensionin i tretë, përkatësisht, cikli me KUR është adresim i qartë kohor/shkakësor me tregues të dyfishtë, (1) për kohën/arsyen e ndodhjes së plojes/rrënimt, (2) koha/shkaku i shpëtimit/rilindjes.


Libri "Dhembje e bekuar" (333 poezi, 2013) është i strukturuar në 6 kapituj dhe përbën, në gjykimin tim, jo vetëm përfaqësimin me përfshirës dhe më kulmor deri sot të autorit, sa u përket vlerave estetiko-letrare, por dhe një nga librat më të arrirë poetikë të letërisë shqipe.

Cikli I (ALBUM I GRISUR), sikurse e ka nënvizuar Podrimja sintagmën e albumit të grisur, mund të ishte një libërth më vete me poezi. Mund ta perceptojmë si një poemë fragmentare, një ligjërim të vetëm poezi - pezizazhi njerëzor të ndarë në njësi më të vogla, me tituj respektivë si poezi të mëvetëshme për të ruajtur ritmin, densitetin kuptimor, befasinë, për të lënë jashtë lëndën e panevojshme, kontekstin e përbashkët, për të mos rënë në përsëritje të llojit përshkrues me të dhëna të panevojshme për hapësirën dhe kohën e ndodhisë, gjasës liriko-dramatike. Si poezi tip për këtë cikël kam përzgjedhur "Shtëpia e nëmur" - duket poezia më dekodifikuese sa I përket narrativës poetike të Bashotës. Së pari, më dukshëm se çdo poezi tjetër e këtij cikli, ajo bën bashkë element të njohur e të përdorur në traditën tonë poetike: sintagmën *shtëpia dhe njeriu*, për pasojë kemi: shtëpia, nëma, porta, shekujt, gjumi, fëmia, frika. Poezi shembull: SHTËPIA E NËMUR

Është diku një Shtëpi e Nëmur/Me shtatë porta/Secila portë/E ka nga një gur-therë në prag/Të përgjakur nga shekujt./S'del njeri ta hapë/As ta vërë në gjumë të thellë/Frikën e mbërthyer përbrenda/Në shtatë dritaret e saj/Vajton vetëm një kukuvajkë/Nata nuk bën të harrohet/As fëmijët të shohin ëndrra trishtuese/Nuk bën/Është diku një Shtëpi e Nëmur/Me shtatë porta/Që s'pret dorë njeriu.

Në ciklin II (ZOGUME PROFIL VJESHTE) kemi variacione autoportreti të poetit, të heroit lirik; është uni poetik në hapjet ndaj jetës dhe në mbresat, në tërheqjet në vetvete. Elementi piktural ndërthuret me meditim, sintezën filozofike. Shembull: DHEMBJE QYTETI *Kur ia vumë themelet qytetit/Një grua vrapoi pas fëmijëve/Këmbëzbathur/Në shëtitoren e dëshmorëve/Dashnorët i ndezin zemrat pa alarm./Gjenerata poetësh/Ecin të ballafaquar nën qiellin e kaltër/Buzëmbërmeve të Prishtinës/Një hermetik bënte luftë me vetveten/As vargjet nuk i mbante kjo mërzi/E rëndë/Ja të pafatët/Që ikin si zogjtë strehëve/Duke kërkuar mëngjëse plot diell/Nuk I dhuron as fjala që na përbuz/As më e sërta/Arkitekturë e netëve pa gjumë/Kur qyteti i bë më i madh sa heroi/Kush tha/Kush tha se gjaku i dëshmorëve/E rrit një trëndafil të kuq.*

Në ciklin III (PLAGOMË) mbizotëron toni epik. Ndjeshmëria provokohet dhe përcillet nëpërmjet fabulës/gjetjes poetike e cila, zgjedh të tregojë për kategori shoqërore e historike me densitet emocional, rivalizuese deri në zgrip ndaj njeriut të zakonshëm. Fjalë/figura të këtij cikli: atdhesi, robëria, qëndresë, përkulja, barbaria, ekzili, neveria, etj. Të shprehura me gjuhën e poezisë kategoritë e mësipërme historiko-shoqërore tingëllojnë si psalme të vetflijimit. Shembull: INTIMË *Po gdhinte/Shi i kuq mbi ty binte/Asfaltit të bardhë/Pritja shndërrohej në zjarr/Po gdhinte/Shi i zi mbi mua binte/Zgjatë me nervozizëm të derdhur/E vërteta e fshehur/Lulet na*



mbuluan me hije/Të këputura në fushë vetmie/Vetëm gjakosin kujtimin e harruar/Prehen ndër sy vyshken në duar/Po gdhinte/Shi kuqezi mbi ne/Binte.

Cikli IV (DALJE NGA TRISHTIMI) është kthimi i poetit te poezia si strehë e qenies, si realitet ontologjik dhe gjuhësor. Ose, me fjalë të tjera, kemi dy projeksione: (1) Poeti në poezinë e tij dhe (2) - Poeti në poezinë e gjetur, në traditë, jo vetëm në vargjet e autorëve të identifikuar, por dhe në situatë, në gjendjen poetike të pa artikuluar ende, shkaktuar nga rrethanat. Shembull: AH KJO VDEKJE Si ta përpij tmerrin në dyluftim me hijet/Copat e granatës në pjatë/Vrasësit duke i fshirë njollat e krimin nëpër mure/Fytyra e skuqur e atdheut në pasqyrë/Përpara vdekja pastaj gjaku/Fëmijët me bukë në fytyrë në gëlltisnin shpresat/Ëndrrat e bardha për lodrat që i tremben vdekjes/Që kërkon mëshirën e Zotit/Nëpër legjendat për dramën e krimin/Përpara vdekja pastaj gjaku.(Mars, 1998).

Cikli V (BUKURI E NËMUR) përmban poezi të toneve elegjiake për gjërat e humbura, të tjetërsuara, të zhdukura, të zvetënuara ose të asgjësura nga faktorë të mbinatyrshëm siç janë lufta, koha astronomike si rrjedhë e pandalshme, dehumanizimi kolektiv i epokës. As këtu nuk mungojnë relacionet intime shpirtërore-filozofike me të bukurën, me të mirën, me njeriun dashur dhe gjërat e dashura. Shembull: PASQYRA: Çdo ditë e zvogëloj dhembjen/Në pasqyrën e thyer/Dhe bëhem pluhur i harruar/Në plagën e nëntë të vetmisë/Çdo natë nga kafshimi i bukurisë/Shtohen thinjat në kokë/Si trëndafila të egër/Dhe bëhem plagomë e bardhë/Pasqyra ime/E zezë.

Cikli VI (DORËSHKRIMI I RINGJALLUR) është paraja e gjetur. Fjalët kyç/sintagmat poetike janë: ndjeza e zjarrin, zgjimi, lulja e bardhë, vallja e zogjve, buzagazi i ngjalljes, kujtimi, testamenti, shëtitja, vegimi i bardhë, gjumi i parë, udhëtimi, bekimi, këmisha e bardhë, etj. Shembull: LEGJENDA E MUROSJES: Vjeshta e shkund lotin tend/Mbi zjarrin e syrit tim/Ti nuk je më Ajo/Lulet e dhembjes protestojnë/Kur hija e vendlindjes buzëqesh në dritare/Ti nuk je më Ajo/Qielli e përkund tokën e gjallë/Si në legjendën e murosjes së gruas/Ti nuk je më Ajo.

Libri "Lutja e parë e shpirtit" është konceptuar/organizuar në spektrin e nëntë elementeve fundamentalë të shpirtit poetik, si nëntë rrrathë përfytyrimesh jo religjioze për jetën e amëshuar, ku fillimi e fundi janë në antinomi: Cikli I - LUTJA e parë SHPIRTI; (Lutja - është fjala kyç, nënvizimi/propozimi ideor-emocional i autorit). Cikli II - PËSHPËRITJA e dytë DASHURIA; (Pëshpëritja-fjala kyç...). Cikli III - RRUZULLIMI i tretë DRITA; (Rruzullimi...). Cikli IV - OFASHAMA e katër FJALA; (Ofshama...). V - IMAZHI i pestë DHIMBJA; (Imazhi...). VI - UDHËRRËFIMI i gjashtë ËNDËRRA; (Udhërrëfimi...). VII - SHKUNDULLIMA e shtatë FATI; (Shkundullima...). VIII - IDILA e tetë VETMIA; (Idila...). IX - PALIMPSESTI i nëntë JETA; (Palimpsesti është fjala kyç e autorit me të cilën dëshiron t'i hapë rrugë rileximit simbolik të tërësisë duke nënkuptuar dhe parimin e tij krijues të librit-poemë...), zgjidhje kompozicionale e kushtëzuar prej mënyrës si bota përjetohet e shndërrohet në materie poetike.

Si përfundim pajtohem me mendimin se Sali Bashota është ndër poetët e mëdhej të gjuhës shqipe dhe të modernitetit tonë letrar. Shqiptimi i tij poetik, nuk e përkul profilin e lartë të poezisë shqipe lëvruar në Kosovë nga Esad Mekuli, Martin Camaj, Azem Shkreli, Ali Podrimja, Rrahman Dedja, Beqir Musliu, Ramadan Musliu, Xhevdet Bajraj, Basri Çapriqi, Adem Gashi, Milazim Krasniqi e të tjerë, por e afirmon edhe më tej atë duke e çuar në horizonte të reja shprehjeje, komunikimi e rrezatimi estetik.



Mbresa nga Panairi Ndërkombëtar i Librit në Torino

“ZEMRA TË EGRA” Nëpër labirintet e një Panairi që merr frymë nga Eris Rusi

Fluturimi është si të zvogëlosh në sytë e botës. Në momentin që shkëputem nga toka, ndje një shtrëngim të vogël në kraharor, që ngadalë nis të lehtësohet, duke u ngjitur lart, për të parë përtej asaj që është bota e zërave, e njerëzve të dashur telasheve, e ngarkesave, e gjërave të lënë përgjysmë. Në këtë pezull ajri, më pëlqen të mos mendoj asgjë. Humb në një marramendje që më ulet në kapakët e syve. Po shkojmë në Torino, në Sallonin ndërkombëtar të librit. Një festë e gjallë lexuesish që nxitojnë drejt sallave të pafundme, në një labirint tekstesh, autorësh, botuesish, ku ngjan të jetë e mbyllur përkohësisht përfytyrimi dhe imagjinata e botës. Biseda e fundit që kam bërë para se të nisem ka qenë me Irena Tocin, drejtuesen e shtëpisë botuese "Toena", e cila më shpjegoi edhe njëherë detajet e projektit "Neighbors", - Fqinjët. Zëra dhe autorë, tekste letrare të vëna në fokus të një nisme e cila i jep jehonë letërsisë së mirë përtej kufirit gjuhësor.

Buzëqesh kur mendoj që drejtori i Sallonit ndërkombëtar të librit është Nikola Lagioia. Kam në duar romanin e tij "la Citta dei vivi", "Qyteti i të gjallëve". Një kronikë e errët krimi që ka ndodhur në Romë, në vitin 2016, kur dy djem vrasin pa asnjë arsye, në mënyrë brutale e barbare, një 23 vjeçar. Një mesazh që ishte ftesa e vdekjes, e që iu dërgua me të njëjtin tekst 23 të rinjve të tjerë, gjeti përgjigje vetëm prej tij. Shkoi në takimin ku e ftonin të nxitonte, dhe u masakrua pa mëshirë, sa dha shpirt.

Nis t'i tregoj detaje rreth subjektit shoqëruar sime, e në atë lartësi, e ndje si lëviz tensioni në sytë e Inës. Tmerret e tokës, edhe kur përmenden mbi re, arrijnë të plasarin shpirtin.

- Po ti ke e ke vizituar më parë Romën? - më ndërpret për të ndërnuar bisedë ajo.

Unë mbyll sytë. Jemi në pesë mijë metra lartësi, nuk duket asgjë nga bota poshtë, as toka vetë, por kujtimi i Romës mua më mbush të gjithin.

- Më shumë se kaq, - i them. - Kam jetuar shtatë vjet atje.

E krejt papritur, Roma e Lagioia-s, me ritmin e jetës që rrjedh ngadalë, në mënyrë ciklike, të përhershme, më përfshin të gjithin. Më dalin para syve stacioni Termini, ndalesa jonë e parë në Romë, kur bashkë me një grup të tjerë studentësh mbërritëm në këtë vend të huaj, që u kthye në vendin tonë të studimit dhe në shtëpinë tonë të re. Më pas Piazza Bologna, zona Eur, Piazza Fiume, Via Del Corso, Vila Borghese, Piazza del Popolo, Piazza di Spagna, Universiteti "La Sapienza", Fakulteti i Shkencave Humane. Më tej studentët, sallat e mbushura plot, mësimi në auditorët e katit të nëdheshëm, ku sallat e hapura ngjanin me ekspozita ku shfaqeshin shenja të antikitetit, buste, skulptura, shenja të periudhës latine që ushtronin një ndikim të çuditshëm e magjepsës te kushdo.

U desh një turbulencë ajri, që të vija në vete. Ina e ndjeu trazimin tim dhe buzëqeshi.

- Nuk janë me vend rrëfime të tilla të frikshme në ajër, - më thotë.

Dy orë më vonë i kemi kaluar të gjitha kontrollet e aeroportit dhe jemi në tren drejt hotelit.

- Ku do të zbrisim? - dëgjoj Inën të më pyesë.

- Në Sallonin e librit, - shqiptoj pa u menduar, e Ina nuk më kundërshtoi që të më thoshte se Sallonin çelëj të nesërmen.

Ishte pasdite vonë. Me biletat në dorë, ndërruam autobusin me një linjë metroje dhe zbritëm në stacionin "Lingotto Fiere". Pasdita po vishej me muzg të ngrohtë maji, e ndarëset metalike ku do të duhej të kalonin vizitorët e panairit nesër, ngjanin të padobishme.

Prej së largu, dalluan trajta njerëzish që punonin, vinin lart e poshtë, vazhdonin përgatitjet. Sallonin ndërkombëtar i librit, ajo Godinë e stërmadhe, me dhoma, salla, korridore pafund, të shtrirë në dy kate gjigandë, e që nga prapa vijonte me hapësira të mëdha, sheshe të hapur, të sajuar për t'u çlodhur e për të ngrënë diçka, përpëlitej nga një shkullm jete që elektrizonte.

- Shihemi nesër bashkë, - mëmërita, e m'u duke gjëja më me vend t'i flisja asaj ndërtese e cila shëmbëlente me gjithçka, përveçse me një godinë ku muret dhe korridoret, ishin thjesht të tillë, memecë e pa jetë.

2.

Dita tjetër. Ora 09.00 na gjen në një radhë të gjatë, që është e adhurueshme. Njerëz pa fund, me bileta në dorë, për t'u futur në sallonin ndërkombëtar të librit. Prindër me fëmijë, gra fisnike në moshë, të rinj, studentë, të gjithë të hareshëm, të duruar, me biletat e paguara për t'u futur në një atmosferë ku do të duhej të paguanin sërish, për të blerë libra.

Pasi kalojmë kontrollet, futemi menjëherë në atmosferën e panairit. Në një stendë që

ngjan të jetë ndalesa e parë për të gjithë vizitorët që do të futen në panair, gjejmë një hapësirë ku mund të kapim vend edhe ne. Nxjerrim me kujdes materialet e projektit "Neighbors" - "Fqinjët", e për pak kohë, përballemi me valën e dashur të njerëzve që njihen me autorët e prezantuar prej nesh. Duke lexuar emrat e përkthyesve mbi materialet e afishuara në stendë, mendja shkon menjëherë te "Qyteti i të Gjallëve". Lagioia! Me Inën shihemi në sy dhe e ndjejmë që na presin gjëra të tjera. Duhet të futemi brenda, të takojmë botues të tjerë, autorë, të njihemi me atë që na ofron nga brenda ky panair ndërkombëtar i librit.

Lëvizim brenda asaj vale të ngrohtë shpirttrash, e siç ndodh në çdo kredhje mes njerëzish pa fund, i zhdukemi nga sytë njëri-tjetrit. Humbasim dhe ritakohemi vazhdimisht. Ngado ka gjallëri, lëvizje, lexues që blejnë, fëmijë që bëjnë foto tek "Pema e Librit", prindër që i gëzohen asaj energjie të madhe që çlirojnë librat e hapur nëpër stenda.

- Duhet të takoj Nikola-n, - them me zë të lartë, me drojë mos është e pamundur që ta gjej në mesin e asaj turme të pandalshme vizituesish brenda panairit. Atëherë nxjerr telefonin dhe i shkruaj:

- I dashur Nikola, jemi brenda panairit dhe atmosfera është e mrekullueshme! Sido që të shkojë, nuk dal dot prej këtu pa u takuar me ty!

Nikola më përgjigjet me një mesazh zanor. Do të takohemi, por as vetë nuk e di se kur. *Ndoshta do të jetë rasti ai që do të na vendosë përballë njëri tjetrit sot.*

Rastësia! Sa e natyrshme është kjo fjalë për Nikolën, kur kujtoj faqet e romanit të tij, "Qyteti i të gjallëve". Rastësia që nxjerr në pah të keqen brenda njeriut, rastësia që i kthen në xhelatë të pamëshirshëm, dy të rinj, që vijnë nga familje të mira, me të ardhmen që kurrë nuk mund t'i kishte telashet e të rinjve të vendit tim. Më duket sikur vetë Nikola e ka lënë këtë takim me suspansën e romanit të tij. "Rastësia", shqiptoj, fati, e panjohura e madhe, që kush e di ç'ka rezervuar edhe për mua brenda këtij Sallonit të stërmadhi librit.

Pa i lënë kohë vetes të bëj hamendësime, ashtu, i hutuar e me telefonin në dorë, pranë stendës me botime nga CivitaVecchia, më duket sikur dikush më prek në sup.

"Po të pret pranë 'Zemrave të egra', - më ngjan se dëgjoj një zë të dobët, pa ngjyrë, si makth. Është si një pëshpërimë e ftohtë, por e kur kthej kokën, nuk ka njeri.

Mos më kanë bërë veshët? "Zemrat e egra" është tema e këtij Panairi. Është një titull i zgjedhur nga Lagoia. Sot jetojmë në një botë të trazuar, në një kohë tragjike, plot me të panjohura të mëdha, por edhe me një shpresë të pushuar për të ardhmen. Kështu mund t'iu zihet besë zemrave të egra, që të mposhtim egërsinë brenda zemrës sonë.

Nis të ec kuturu, tani me një lloj ankthi nga e panjohura, nga ajo që më pret. Rrëshqas nëpër stendat që ngrihen anash meje, më duket sikur jam brenda romanit të Lagioias, në rrugët me kalldrëm të Romës, ku gjithçka fillon një mëngjes të ngarkuar, me shi, në radhën e turistëve që presin të futen brenda Koloseut, ndërkohë që aty pranë ka ndodhur krimi makabër, për të cilin gjithë vendi do të flasë më vonë. Nis të mendoj që ironia e fatit është mizore, e ndodh ndonjëherë të futesh në kurthin e të panjohurës, krejt rastësisht, me një biletë falas për të vizituar Sallonin ndërkombëtar të librit.

Mbështetem në një cep, afër stendës së rajonit të Puljas, dhe sapo lexoj "Besa Muci Editore", rifitoj menjëherë gjallërinë. Është shtëpia botuese që boton edhe autorë shqiptarë në italisht. E Njoh botuesin, Livio Muci, e për mua çdo fytyrë e njohur do të ishte kameradare shpëtimi në këtë makth. Druaj që s'do ta gjej, kam frikë mos labirinti i së panjohurës do të më mbajë mbyllur

(Vijon në faqen 11)

(Në një të drejtë autorësie "familjare", titulli i mësipërm është risjellë i huajtur nga një artikull i 1982 i prof. Jup Kastratit në revistën "Nuova Albania", pas kthimit nga qëndrimi një mujor në komunat arbëreshe me qëllim kërkimi në arkivat e bibliotekat e Kalabrisë).

Që nga momenti i themelimit të QSPA-së në janar të 2020, në agjendën prioritare të punës qëndronte vizita tek komunitetet arbëreshe të Kalabrisë, e më pas tek ato të Sicilisë, të Puljas, të Abrucos e me radhë. Rrethanat nuk u treguan të mëshirshme: fillimi i funksionimit të institucionit përkoi me pandeminë, me izolimin. Pavarësisht mosndërprerjes së punës për asnjë çast, vizitat nuk u kryen asnjëherë në këto dy vite sepse izolimi nga pandemia zgjatej e nuk kishte fund, kësodore edhe vizitat mbesnin në agjendën e shkruar të muajve që rrokulliseshin pa ndryshuar situatën: kishte një tis kalendash greke në këtë plan.

Vizita u arrit të realizohej vetëm në datat 16-20 qershor 2022. Nuk do të doja të ndalesha tek të gjithë takimet, të cilat gjithsesi do t'i përmend shkurtimisht, por tek çfarë doli nga këto takime, tek diskutimet më thelbësore, tek përfundimet, tek vendimet e projektet e afërme e të ardhshme. Ndiej detyrimin moral të theksoj se kjo ishte hera e parë në historikun e vizitave të realizuara nga delegacione të ndryshme shqiptare në kohë, të nivelit politik apo akademik, kulturologjik apo edhe të trupave të ndryshme regjizoriale apo artistike të shekullit të kaluar e të këtij fillim shekulli, që realizohej nga ana jo vetëm e Qendrës së Studimeve të Arbëreshëve (QSPA), por me vullnetin e praninë e një përfaqësie të Komisionit të Jashtëm Parlamentar, kryesuar nga zj. Mimi Kodheli, me praninë edhe të zvkryetarit të Parlamentit të Shqipërisë, z. Agron Gjekmarkaj. Agjenda, e realizuar nga QSPA në bashkëpunim të ngushtë me Presidentin e Fedratës së Shoqatave Arbëreshe z. Damiano Guagliardi, ishte fort e ngjeshur. Në maratonën e agjendës, do të veçoj disa syresh, të cilët patën edhe rëndësinë e së ardhmes së afërt të çështjes arbëreshe.

Pas udhëtimit me traget me linjën Durrës - Bari, në mëngjesin e dt. 17 qershor 2022, në orën 08.30 nisemi për në Katanxaro të Kalabrisë. Agjenda parashikonte dy takime të nivelit të lartë, politik, por edhe akademik, përkatësisht me Presidentin e rajonit të Kalabrisë, z. Roberto Occhiuto-n në Katanxaro e, brenda së njëjtës ditë të kalohej në Kozenca në takim me Rektoren e Universitetit të Kalabrisë, prof. Nicola Leone-n. Takimi me Presidentin Occhiuto qe sa i përzmërt, por po aq edhe shpresëmirë. Në synimet e ambiciet e tij në raport me Shqipërinë, ai e shihnte krejt të afërt momentin kur Kalabria do të shndërrohej në urën lidhëse të Italisë së Jugut me Shqipërinë. Në këtë kuadër, edhe çështja arbëreshe, ajo e ruajtjes së gjuhës në veçanti, hynte në këto ambicie, duke u mbështetur edhe në vullnetin politik të Shqipërisë.

Në takimin me Rektoren e Universitetit të Kalabrisë, prof. Leone-n, i parashitrova domosdoshmërinë e bashkëpunimit me Departamentin e Gjuhës Shqipe pranë këtij Universiteti, kërkesë e cila nga ana e QSPA - së i është bërë që në ditët e para të krijimit të saj, por që ka ndeshur në refuzimin e vijueshëm nga ana e tyre. Rektori, u shpreh se nuk ishte në dijeni të këtij fakti dhe më ftoi t'i shkruaja më gjatë në lidhje me këtë çështje (gjë të cilën e bëra para pak ditësh).

Të shtunën më 18 qershor, vizitë në fshatin e Maqës (Makji në arbërisht) për të nderuar kujtimin e Jeronim De Radës në shtëpinë e lindjes së tij, ku pritemi nga kryetari i bashkisë z. Ernesto Madeo. Më pas vijohet në Strigàri (San Cosmo Albanese) ku, të prituri nga kryetari i bashkisë z. Damiano Baffa, vizitohen vendet

MIDIS ARBËRESHËVE TË KALABRISË

Prof. Diana Kastrati



serembiane, Fondacioni i De Radës si dhe dhoma e dedikuar Terenc Toçit. Në 12.30 të së njëjtës paradite transferohemi në Vakaric (Vaccarizzo Albanese) ku pritemi nga kryetari i bashkisë z. Antonio Pomillo; vizitohen Kisha, Ekspozita e përhershme e kostumeve arbëreshe femërore.

Pasditën e së njëjtës ditë, e shoqëruar nga z. Damiano Guagliardi, drejtohem më herët se pjesa tjetër e grupit, për në bashkinë e Shën Mitrit (San Demetrio Corone) për të diskutuar paraprakisht me dy kryetarët e bashkive Madeo e Baffa në lidhje me një nismë që është e një rëndësie parësore për ruajtjen përfundimtare të kulturës së shkruar arbëreshe: nënshkrimin e Deklaratës së synimeve të një Marrëveshjeje bashkëpunimi midis Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) dhe komunave të Shën Mitrit e Strigàrit për krijimin e një Arkivi informatik librar, dokumentar, fotografik e sonor të trashëgimisë Arbëreshe. Në ora 20.00 hapet mbledhja në Sallën e Këshillit bashkiak të

Shën Mitrit, nën drejtimin e kryetarit të saj z. Madeo dhe avokatit Emanuele D'Amico si dhe në praninë e 12 kryetarëve të tjerë të bashkive arbëreshe. Objektivi: diskutimi i hapur mbi problemet më shqetësuese dhe me përparësi zgjidhjeje nga të dyja palët, ku folën në mënyrë pasionale e me përgjegjësi të gjithë kryetarët e bashkive arbëreshe. Në fjalën e tij, Presidenti i FAA-së, z. Damiano Guagliardi, me kërkesën e vetë kryetarit Madeo, ilustroi me fakte, kufizimet normative të Ligjit 482 të 1999 si dhe L.R. 15/2003 duke kërkuar nga Komisioni i jashtëm Parlamentar shqiptar: a) Një dëgjese të kryetarëve të bashkive dhe shoqatave arbëreshe në një nga mbledhjet e këtij Komisioni, me qëllim që Parlamenti të informohet për gjendjen ekzistuese të Arbëreshëve të Kalabrisë; b) mbështetjen e QSPA-së nga ana e qeverisë shqiptare për rëndësinë e posaçme të punës së këtij institucioni (QSPA), si i pari i këtij lloji në historinë e shtetit shqiptar që nga krijimi i tij e deri më sot kushtuar tërësisht arbëreshëve,



dhe bashkëpunimit të saj me Fondacionin rajonal të Pakicave arbëreshe në Kalabri e në rajonet e tjera kudo ndodhen në Itali; c) që, duke u bazuar në ligjin e sipërpërmendur 482/99 (neni.12) të nënshkruhet midis Italisë dhe Shqipërisë një Memorandum që të rregullojë politikat didaktike të përdorimit të arbërishtes në shkolla; c) që, midis qeverisë shqiptare dhe Rajonit të Kalabrisë të nënshkruhet një dokument bashkëpunimi i shtrirë edhe për relacionet ekonomike e të voluntariatit, të inovacioneve teknologjike e të programimit evropian, me synimin e qartë të përshpejtimit të hyrjes së Shqipërisë në BE.

Zj. Mimi Kodheli, në cilësinë e Kryetares së Komisionit të Jashtëm Parlamentar, shprehu vullnetin e saj personal, po aq sa të këtij Komisioni në mbështetjen e kauzës arbëreshe. Ky vullnet u shpreh edhe në takimet e tjera të këtyre ditëve.

Në cilësinë e Drejtores Ekzekutive të QSPA-së e, në emër të këtij institucioni, ndër të tjera, bëra publike dy nisma të rëndësishme: 1) atë të organizimit në këtë vjeshtë të 2022, të të parit tubim të kësaj natyre të organizuar ndonjëherë në Shqipëri, të pagëzuar "Ditët e Librit Arbëresh", në bashkëpunim me FAA-në si dhe me cilëndo shoqatë apo individ studiues që dëshiron t'i bashkohet kësaj nisme. Në këtë ngjarje dyditore, do të realizohet ekspozimi i librave të autorëve bashkëkohorë arbëreshë të pas Luftës së Dytë Botërore deri në ditët e sotme, pas një përzgjedhjeje të tyre sipas vlerës dhe fushave përkatëse (krijime letrare, studime leksikologjike, studime historike, kulturologjike etj), dhe më pas do të zhvillohet një ditë e tërë studimore mbi këtë prodhimtari, duke u ndalur në disa syresh që paraqesin një kontribut të spikatur. Nisma do të transferohet në ditën e dytë edhe në një prej qyteteve të Shqipërisë (përzgjedhja do të bëhet në bashkëpunim me organizatorët arbëreshë); 2) fillimin e vënies në praktikë të projektit të "Shtëpisë së Arbëreshëve", një projekt që është skicuar që në fillim të krijimit të QSPA-së në kuadrin e strategjisë së saj të gjithëpërfshirjes së trashëgimisë arbëreshe në një vend. Qendra jonë, krahas studimit e botimeve të kulturës retrospektive e aktuale, i jep rëndësi parësore në vizionin e vet, arkivimit, ruajtjes, shfrytëzimit të kësaj trashëgimie dokumentare të dorëshkrimeve, librave, por edhe asaj fotografike, audiovizive e sonore digjitale brenda territorit të Shqipërisë. Pikërisht në këtë kontekst vjen edhe domosdoshmëria e ngritjes së një Arkivi të Arbëreshëve, në kuptimin e gjerë të fjalës, me seli në Tiranë e nën menaxhimin e Qendrës së Studimeve për Arbëreshët.

Me një rëndësi të dorës së parë në këtë takim, ishte edhe bërja publike nga ana ime në emër të QSPA-së, ky projekt parësor i punës sonë immediate e afatgjatë të "Shtëpisë së Arbëreshëve" me seli në Tiranë, me mbështetjen e bashkisë së Tiranës apo Ministrisë së Kulturës, projekt i cili parasheh krijimin e tri hapësirave: hapësira e parë do t'i kushtohet një biblioteke ekzskluzive të/për Arbëreshët, në shërbim të publikut studiues, por edhe të studentëve të Fakulteteve të Filologjisë e Letërsisë shqipe, të cilët mund të realizojnë temat e diplomave të tyre në këto lëmi të universit arbëresh; hapësira e dytë do të jetë ajo e Arkivit që përmendëm pak më lart, e furnizuar nga vetë arbëreshët, nga bibliotekat publike e private të tyre, nga shoqatat e nga studiues të ndryshëm të cilët synojnë t'i bashkëngjiten kësaj nisme duke ofruar material me natyrë edhe private. Dorëzimi i materialeve do të bëhet në mënyrë rigoroz sipas kriterëve të njohura botërisht në Arkivat e Shtetit, e sipas legjisllacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë; hapësira e tretë, do t'i kushtohet një muzeumi të përhershëm të Arbëreshëve, por njëkohësisht edhe ekspozitave të përkohshme të artistëve piktorë, skulptorë,

fotografë arbëreshë të së kaluarës, por mbi të gjitha të autorëve bashkëkohorë. Ky projekt i *Shtëpisë së Arbëreshëve* me vendosjen brenda të Arkivit për të cilin u firmos edhe *Deklarata* e mësipërme, do të bëjë të mundur lindjen në kohë edhe të një rrjeti muzeal e arkivistik qarkullues të të gjitha komunave të tjera arbëreshe që, me ndihmën e teknologjisë digjitale, do të ketë kompetencat ekskluzive për ruajtjen e valorizimin e trashëgimisë arbëreshe brenda truallit amë shqiptar, si një e *Mirë e Përbashkët Publike Kombëtare* e dokumentimit të një periudhe kyçe të historisë së Shqipërisë. Një dokumentim i tillë brenda territorit tonë, do të ishte pasaporta më e mirë për dinjitetin historik të faktuar të Shqipërisë, e cila, pa qenë pretenciozë më shumë se duhet, do të shërbente edhe për të ëndërruarën hyrje tonën në Bashkimin Europian.

Takimi përmblyllës i këtyre katër ditëve, mbase edhe më emocionuesi, sepse ishte nën shenjën e sinqeritetit pa "dorashka" politike, diplomatike apo rëndom etike të këtyre takimeve, ishte ai me Federatën e Shoqatave Arbëreshe (FAA), në selinë e Bashkisë së Civita-s (Qiftja në arbërisht), nën drejtimin e kryetarit të bashkisë, z. Alessandro Tocci-t.

Prof. Vincenzo Bruno, shkrimtar e njeri i kulturës, midis të tjerash, argumentoi edhe disa nga arësytet që sipas tij kanë mbajtur të gjallë identitetin arbëresh, ku ai renditi atë të një ndërgjegjeje kritike të arbëreshëve e të qenit *de jure* e *de facto* shtetas italianë, por të ndryshëm; i rrethanave historike që e kanë shoqëruar këtë rrugëtim mendor e shpirtëror të arbëreshëve, e të kësaj nevoje të pashuar asnjëherë të të mbajturit fort të identitetit të të parëve të tyre; e punës së pashoqe të bërë nga Shoqatat arbëreshe, si kulturore, po aq edhe të punës së drejtpërdrejtë në terren etj. Ndërsa Presidenti i FAA-së, Damiano Guagliardi, e përcaktoi veten si të "sëmurë nga Arbëreshiteti"; ai shpalli publikisht kontingjentin e pasur që ka në mend t'i dhurojë Shtëpisë së Arbëreshëve në Tiranë. Ndërsa Attilio Mazzei, ish kryetar i bashkisë së Caraffa-s, kishte bërë 146 km për të ardhur në këtë takim. Ai paraqiti një ide shumë të vlefshme të të krijuarit të një tipologjie "Erasmus" për kurset e ndjekura në Shqipëri nga ana e të rinjve shqiptarë, po aq sa të studentëve shqiptarë në komunat arbëreshe. Studiuesi i vyer Salvatore Bugliario, solli mesazhin e të bashkuarit e jo të përçarjes midis individëve, studiuesve apo protagonistëve të skenës arbëreshe në Itali, po aq sa të atyre në Shqipëri. Por, nga ana tjetër, me hidhërim u shpreh se kemi mbetur "jetimë" nga ata që ishte dashur të na ndihmonin në këtë rrugëtim. Studiuesi Franco Perri bëri një përmbledhje të thuktë e të saktë të shpërndarjes së shqiptarëve e arbëreshëve nëpër botë, të shpopullimit të egër që po u ndodh këtyre komunave në Itali nga ana e të rinjve arbëreshë, por po aq edhe nga braktisja e të nxënimit të arbërishtes. Kurse mësuesi Michele Greco, në një shqipe të saktë, mes emocioneve u shpreh se "sot na u hap zemra, shpirti, se ju jeni me ne, se ne jemi të fortë për sa kohë mbajmë të gjallë gjuhën tonë". Ndërsa Giovanni Mannuccio, ish kryetar bashkie i Acquaformosa-s, u shpreh ndër të tjera se lipset të çohet në qeverinë italiane propozimi i të paturit një përfaqësim në parlamentin evropian të të gjithë diasporës shqiptare, të vjetër e të re.

Në fund të këtyre ditëve pune, por edhe të një kënaqësie dhe emocionit të parrëfyer (personalisht kjo e fundit) duke mos krijuar asnjë eufori të pavend, uroj që në këtë rrugëtim të gjatë që tashmë e kemi marrë, të mbajmë parasysh frazën e mençur latine "*Festina lente*" (shqip: nxito me ngadalë, me maturi), sepse koha për të vepruar është sak kjo.

Tiranë, më 30 qershor 2022

(Vijon nga faqja 9)

NË SHQIP NGA BOTIME MINERVA DITARI I BAZUAR NË LIBRIN BESTSELLER "ARTI I BRISHTË I NOT GIVING A F*CK" I MARK MANSON

Nga autori bestseller i *New York Times*, Mark Manson, vjen një ditar bashkëveprues, bazuar në fenomenin ndërkombëtar, "Arti i brishtë i not giving a f*ck" dhe bestsellerin e *New York Times*, "Çdo gjë është f*cked", me pyetje dhe njohuri të qarta të paraqitura me zërin e tij të paimitueshëm.

Ky ditar, sipas stilit klasik të Mark Manson, nuk është diçka që përdoret "një herë në ditë" apo "një herë në javë". Mund ta përdorësh kurdoherë. Ose fare. Lëre dhe ktheju sërish. Ose jo.

Është i ndarë në pesë pjesë të cilat përputhen me tematikat e librit "Arti i brishtë i not giving a f*ck" dhe përfshijnë udhëzime që të ndihmojnë të mendosh për pyetjet më të thella në lidhje me emocionet, vlerat dhe qëllimin. Mençuria e Manson-it plotësohet me ushtrime të cilat të bëjnë të qeshësh, të mendosh dhe të rritesh, kurse e folura e tij troç krahasohet vetëm me sinqeritetin ku kërkon që ti të luftosh me veten dhe me gjërat që kanë rëndësi.

Kur vjen puna te tematikat me peshë – si për shembull lumturia, vlerat dhe përgjegjësia – në jetën tonë përballemi me pyetje të pafundme. Manson i trajton këto çështje me humorin e tij unik dhe ofron njohuri e vëzhgime në mënyrë që të gësh përgjigjet e tua. Ky ditar mundëson hapësirë të mjaftueshme për të menduar ulje-ngritjet e jetës, si dhe të udhëzon që të kuptosh se si momente kyçe në jetën tënde – qoftë tragjike, qoftë komike – janë mundësi për t'u rritur (dhe ndonjëherë thjesht për të qeshur).

Përkthyer nga Bledar Kurti

gjithmonë atje, por është frikë e kotë. Livio më shfaqet përpara dhe kur e takoj, me gjallëri të pazakontë e një lumë fjalësh që po i baja mbyllur brenda vetes, ai vë buzën në gaz e më thotë të qetësohem.

Përmbledhem, nuk jam personazh i librit të Lagioias, e asgjë e pazakontë nuk është paracaktuar për mua këtu. Rifitoh ngadalë qetësinë, e i flas Livios për pjesëmarrjen time në atë panair. I tregoj për projektin "Fqinjët", i përmend përkthimet e mia, e kur ndalem tek përkthimi i Lagioias, ai më frenon: - Eja më mua, - më thotë.

Me një dashamirësi të ngrohtë, më çon tek bashkëpunëtorët e tij pranë stendës. Më prezanton dhe u thotë që po përkthej Lagioian, "Qytetin e të gjallëve".

- Një histori makabre! Mjerë ai djalë! – shqipton dikush nga stafi, por unë atë zë më ngjan se e njoh. Më shëmbëllen me kumbimin e fjalëve "Cuori Selvaggi", si hija e panjohur që më tregoi ku më priste Lagioia. E shoh drejt në sy folësin, por nuk ngjan aspak me dikë dashakeq, që po bluan fundin tim tragjik. E megjithatë...

3.

"Cuori selvaggi" – "Zemra të Egra".

Nën reklamën e madhe, të mbështetur në dalje të panairit, dalloj Inën që po bisedon me dikë. Lagioia! – them me zë të lartë dhe nxitoj, vrapoj, si mundësia e vetme për t'u lidhur sërish pas realitetit. Ina ka duar një fletëpalosje të hapur ku shkruhet "Cuori Selvaggi" dhe zemra ime që rreh fort, fort.

- Të ngjan ndopak me një "Qytet të gjallë"? - më thotë me buzëqeshje Nikola dhe ngrihet të më takojë.

E prisnin që do t'i gjeja herët a vonë. Unë, që pak më parë e ndjeja veten personazh të librit të tij, ulem pa mundur të them dot një fjalë.

- E ndjeve edhe ti, apo jo? – më pyet Nikola.

E shoh drejt në sy. Ngjan sikur ta ketë lexuar ankthin tim. Ka diçka të çuditshme te ky shkrimtar, te ky njeri që ka ngritur më këmbë këtë panair gjigand, dhe unë pa kuptuar tund kokën si pohim.

- E gjithë kjo jeton, merr frymë, - thotë Nikola, e bën me shenjë rreth e qark nesh. Njerëzit, stendat, librat, sallat me shenjat përkatëse, fletëpalosjet, tabelat me reklama gjigande, çdo detaj, krejt atmosfera, duket si të jetë pohimi që atje brenda, koha rrjedh ndryshe, e jeta është e pazakontë.

- Po si, - them më në fund, - do të më besoje që deri pak çaste më parë, kujtoja që isha një nga personazhet e tu? Akoma kam ndjesinë sikur jam në rrugicat e Romës e jo në korridoret e Sallonit ndërkombëtar të librit në Torino.

Nikola buzëqesh dhe afron pranë vetes disa nga librat që qëndrojnë mbi tavolinë. Lexon me zë titujt, më pas emrat e autorëve dhe thotë:

- Nëse titulli i një libri lexohet nga buzë të panjohurish, pafund, ai libër ka të drejtë të ketë jetë. E ky sallon këtu, është një Sallon që jeton, për sa kohë lexuesit vijnë dhe ushqehen me librat e tij.

Unë shmang vështrimin këmbëngulës të Nikolas, dhe arrij të përvihem tej, në hapësirën brenda Sallonit. Më duket sikur vetiu, sipër njerëzve që lëvizin plot gjallëri e pasion nëpër korridore librash, pikërisht mbi kokat e tyre, fanepsen trajta personazhesh, gjurmë fjalësh të shkëputura nga libra që presin të lexohen. Ka një mistikë hyjnore në atë mes, shpirta që lidhen me zemrat e pabindura, në një klimë sureale, plot jetë. Mbyll sytë ngadalë, e kur më shfaqen sërish rrugët e Romës në mendje, për herë të parë, mendohej të buzëqesh. Por hijet e personazheve që lëvizin lirshëm midis nesh, më stepin të jem i çlirët, plotësisht.

Maj 2022

ARTI I BRISHTË I NOT GIVING A F*CK DITAR

NJË DITAR
I UDHËZUAR NGA
MARK
MANSON

Minerva

Tanatosi-Erosi

Vdekja është një nga temat e parapëlqyera të botëkuptimit njerëzor, atë e hasim si trajtesë të veçantë që nga mitologjia greke, ku ajo ishte përligjur në mënyrë simbolike dhe ishte emërtuar si perëndia Tanatos (vdekja), që ishte në një konflikt me perëndinë Eros (dashurinë), ku vdekja dhe dashuria përbënin balancën dhe disbalancën njerëzore. Dy kategoritë ekzistenciale jeta-vdekja, përbëjnë preokupimin më të madh primordial të individit në raport me botën dhe jetën. Ato sa janë të ndërlidhura mes njëra-tjetrës, po aq janë edhe të ndara. Një trajtim prehistorik mbi trikotominë jetë-vdekje-pavdekësi e gjejmë edhe te poema epike "Epi i Gilgameshit", ku heroi kryesor i kësaj poeme vihet në kërkim të pavdekësisë, pasi ai nuk kishte menduar për vdekjen deri kur vdiq miku i tij i ngushtë Enkidui.

Njeriu ishte i pari që mendoi për vdekjen, dhe rrjedhimisht vdekja del të jetë mendim. Në vazhdimësi vdekja ishte preokupimi i njeriut. Ballafaqimi i njeriut me vdekjen e ka bërë atë të krijojë mekanizma të shumtë të reagimit përmes medimeve të ndryshme; filozofike, letrare, artistike, historike etj. E thënë me gjuhë poetike, vetëm vdekja është e pavdekshme. Secila vdekje ka lënë gjurmë jo vetëm te individ, por edhe te kolektiviteti, dhe si e tillë ka pasur paradigma të ndryshme në epokë e periudha të ndryshme. Shpikja e përjetësisë ose jetës pas vdekjes, ka qenë shpikja më ngushëlluese për njeriun, kjo shpikje rrënoi kuptimin që kishte ndërtuar vdekja në diskutet antike greke. Mesjeta e ka zhveshur secilin diskurs antik, me eskatonin e saj, që rrëfente për fundin, pra fundin e vdekjes, dhe një "rilindje metafizike" të njeriut, dhe kështu përfundimisht vdekja u diskualifikua.

Semantika tekstuale

Që nga titulli i romanit "Vdekja e Omerit", autori na paralajmëron për vdekjen, si temë që rrëfen dhe na rrëfhet përmes romanit. Që në fillim të romanit, i jepen informacione lexuesit se ai duhet të përgatitet për këtë vdekje. Pra, autori e pajis me vdekje protagonistin dhe e tërë ngjarja rrëfhet në raport me këtë vdekje. Vdekja në këtë roman, vije si predestinim metafizik. Edhe pse i bartur në kohë, predestinimit nuk mund t'i ikë askush dhe asgjë. Linja e rrëfimit në këtë roman nuk është lineare. Kjo intencë është e qëllimshme nga ana e autorit dhe si e tillë rezulton si e suksesshme, sepse lexuesi mund ta lexojë veprën si tërësi, por edhe si tregime të veçanta, siç është rasti me "Gudulisja", si tregim i mëvetësishëm. Në këtë roman dominon rrëfimi që vjen prej disa perspektivave, nga tregimtari i gjithëdijshëm që është autori, pastaj me tregimtarin karakter që përbëhet nga Omeri-Muja, si dhe tregimtarin sekondar-dëshmitar, që janë dëshmitarët e shumtë të vrasjes së Omerit. Ky roman, flet për një ngjarje-vrasje, e cila edhe pse kishte dëshmitarë, nuk u zbardh asnjëherë për shkak të dështimit të organeve të drejtësisë, si dhe ndikimit të pushtetit të oligarkisë. Muja është simboli i një oligarku që posedon

Romani "Vdekja e Omerit", botuar nga "Onufri", është vepra e katërt artistike e shkrimtarit Adil Olluri, pas romanit "Bartësi i shpirtit të përzënë", dhe dy përmbledhjeve me tregime "Kthimi i profetit" dhe "Shumë rrugë dhe një rënie".


Semantika dhe metafizika e vdekjes në romanin e Adil Ollurit

Nga Driton Fejzullahu

shumë pushtet, që kishte arritur të korruptojë tërë spektrin politik, të joshë, të tundojë dhe të instrumentalizojë akterë të politikëbërjes. Si i tillë ishte në krye të hierarkisë së pushtetit, pushtet ky që derivonte nga paraja. Ngjarja është e dhënë në një topos urban, siç ndodh rëndom në realitetin tonë social, ku i forti dhe i pasuri kontrollon gjithçka që nga organet e rendit, të drejtësisë dhe të qeverisë. Vdekja e Omerit është manifestim dhe pësim për protagonistin, i cili përfaqëson secilën vrasje të pasluftës që nuk është zbardhur asnjëherë dhe si rëndom gjithmonë ekzistojnë thashetheme të ndryshme mbi dhe për këto vrasje.

Vdekja mitike-vdekja fizike

Vdekjes si tematikë dhe si trajtim nuk ka mundur t'i ikë as autori i romanit "Vdekja e Omerit". Autori me shumë finesë dhe rezonim letrar e historik e trajton vdekjen si kronologji historike, që buron nga "Këngët epike" ose "Cikli i Kreshnikëve" me subjekt Omerin, të birin e Mujës, si dhe modelin e ngjashëm arketipal të Omerit dhe të Mujës, të cilët janë të rikontekstualizuar dhe ritematizuar përmes romanit. Omeri si subjekt i "Këngëve Kreshnike" dhe Omeri i romanit "Vdekja e Omerit" kanë një predestimin të ngjashëm, janë të dënuar me vdekje.

**Omeri-fitnessi**

Autori i romanit është përkujdesur për lexuesin dhe në të njëjtën kohë për tipologjinë e tij. Ndoshta kjo kërkesë është krejt metaforike për ta cytur lexuesin ose për ta futur atë në grackën e të lexuarit. Padyshim se një lexues "naiv" i cili nuk posedon një bagazh leximi, do ta lexojë këtë roman vetëm si rrëfim për vdekjen e një të riu, i cili quhej Omer, por të cilit i mungojnë aludimet dhe njohja mbi "Ciklin e Kreshnikëve". Omeri i përshkruar nga autori, për lexuesin "naiv" është një individ që çdo ditë frekuenton qendrat e fitnesit, ku kushtimisht lexuesi i ri për nga moshë, ose përvoja, Omeri do t'i ngjasojë me ndonjë bodybuider. Cili është funksioni i qendrave të fitnesit, dhe si e përshkruan autori Omerin? Them se fitnesi duket si fabrikë kapitaliste e riciklimit të trupit, krijimin e omerëve bashkëkohorë, të përshkruar me saktësi nga autori i veprës, si tipa muskulozë, të dhënë shumë pas trupit, pas aparençës. Sot lexuesi lëngon nga humbja e fantazisë, krahasimet i gjen gjithmonë e më afër, në realitetin objektiv. Për t'i ikur arbitraritetit, mund të themi romanin se "Vdekja e Omerit" mund të lexohet dhe do të lexohet nga lexues empirikë, të cilët mund të gjejnë material të jashtëzakonshëm të rrëfimit, përshkrimit, si dhe rikontekstualizimit. Ky roman mund të lexohet nga perspektiva të ndryshme, siç do të jepet në vazhdimësi ai lexim.

Muja i legjendave dhe Muja si legjendë (Muja ky thithës metafizik)

Muja si personazh i legjendave që udhëhiqte agallarët e Jutbinës, ishte i pajisur me fuqi mbinatyrore, e cila e bënte atë të pamposhtur, sepse kishte pirë qumësht nga qenie mitike, siç ishin zanat. Kurse, Muja i romanit, që udhëhiqte dymbëdhjetë oligarkë ose mujsharë, kishte fuqi kapitaliste që ishte paraja, sepse kishte thithur shumë tenderë, që e bënte thithësin më të madh "metafizik" të vendit tonë. Po ta bëjmë një lexim dhe krahasim psiko-kritik të protagonistëve "dytësorë" mund të themi se te Muja i legjendave kemi një shenjim i cili hapë shtigje të reja të interpretimit, ku sipas përcaktimeve frojdiste, ai gjendej në stadin psikoseksual të zhvillimit oral, që na lë të kuptohet se "Këngët epike" ishin krijime që shprehnin domenin



libidinal të Mujës, në simbiozë me qenie tjera mitike (zanat). Pra, thithja e Mujës ishte një thithje me burim libidinal, që nuk plotësonte kërkesën bazike të urisë, por thithja ishte burim tashmë i kënaqësisë, që në të njëjtën kohë e pajiste me forcë të mbinatyrshme vet Mujën. Zana dhe qumështi ishin elemente fantastike që prodhonin halucinacione të ndryshme, siç ishte ai i hedhjes së gurit në një largësi tejet të madhe. Ky lexim na lë të kuptohet se “Këngët epike” ishin polisemike dhe si të tilla mund të prodhojnë shumësi të leximeve të cilat duan më shumë angazhim dhe përkushtim me anë të ndonjë studimi specifik. Ngjashëm autori në romanin “Vdekja e Omerit” na lë hapësirë interpretimi psiko-kritik të protagonistit “dytësor” të Mujës. Nëse do ta interpretonim Mujën e romanit, sipas stadeve frojdiste, mund të themi se ai kishte bërë avancim dhe kapërcim sa i përket stadeve psikoseksuale. Muja ishte thithës profesionist, anti-doti i tij vështirë se mund të gjendej, andaj profeksionizmi i tij edhe ana origjinare buronte nga trashëgimia mitike. Muja i romanit, s’kishte të ndalur në procesin e thithjeve, pra ishte thjeshtë tip i pangopur. Ai thithte në të majtë e nën të djathtë, çfarëdo që i dilte përpara. Ishte tejet i shkathët si nga ana orale dhe ajo anale. Dhe nga këto shkathtësi mund të konkludojmë se biri i tij Omeri vuante nga kompleksi edipian. Dhe në këtë kontekst, ai nga frika e kastrimit, nga pamundësia e luftimit të atit, i dha fund jetës së tij, jo si arketipi i tij mitik, por përmes mjeteve rrethanore, pra përmes over-dozës.

Pra, romani “Vdekja e Omerit” mund të lexohet nga shumë perspektiva, të cilat e sfidojnë secilin lexues-krijues-kritik. Nga leximi im krejt subjektiv, mund të them se kulminacioni i këtij romani qëndron tek pjesa e emërtuar “Gudulisja” që flet për të qeshurën, ku autori ballafaqon me shumë finesë vdekjen dhe të qeshurën, si dy pika kundërthënëse. “Gudulisja” për mua është pika më kulminante e romanit. Njeriu prej se filloi të mendonte për vdekjen ose prej që shpiku vdekjen, minoi komedinë dhe të qeshurën. Që nga antikiteti deri në postmodernitet u bë luftë permanente për ta minuar e minimizuar komedinë, komiken, të qeshurën dhe buzëqeshjen. E krahasuan, e emërtuan e definuan si të panevojshme, të dëmshme për njeriun, duke i dhënë konotim negativ. Përse njeriu sot, në shoqërinë tonë ka nevojë më së shumti për qeshje, apo buzëqeshje të sinqertë e jo qeshje ironike apo skizofrenike, sepse të tillat janë manifestime postraumatike. Qeshja në romanin “Vekja e Omerit” është shpallje lufte ndaj morbiditetit, ndaj falsitetit, si dhe seriozitetit të tepërt. Gudulisja është instrumenti më efikas për ta nxjerrë njeriun e shoqërisë nga gremina e vërtetësisë. Përmes qeshjes, njeriu do të arrijë të demistifikojë dhe të delegjetimojë struktura rigjide dhe represive që luftuan të qeshurën.

Konkluzionin mbi romanin “Vdekja e Omerit” do ta përmbyllja me shprehjen: vetëm vdekja është e pavdekshme.

GUERNICA

Nga Shqiptar Oseku

Të dy rrinë ulur si mbi gjemba. Ai me kryet kthyer nga dritarja, sikur numëron gjethet në lisin jashtë dritares. Është lis i bukur. Ajo kthyer përgjysëm në anën tjetër, me shikim të ngulitur tek afishja e Pikasos në mur. Guernica. Kur e pata blerë, vite më parë, hamendesha nëse skenat ngjethëse të një masakre spanjolle ishin vërtet skena të përshtatshme për mur të një dhome ku do të mbaheshin terapi çiftesh. Gojëkëqinjte do ta quanin zgjedhje groteske.

Por përvoja më ka mësuar se shumica e çifteve e çmojnë këtë pikturë. Burrat e vrazhdë, gratë frigjide, homot e fshehur, lezbiket në kërkim: klishtë janë të urreyeshme, natyrisht, natyrisht, por ka një arsye pse ekzistojnë. Të gjithë fiksohen pas pastorales brutaliste. Nuk është se ligjërojnë në hymne të vjershëruara për teknika të penelatës, a nuanca ngjyrash, a strukturë të ndërimit, a ku ta di se çka. Në fakt shumica s’e dinë se ç’është ajo pamje bizare në mur, e mbytur në zi, bardhë e blu. Por duket qartë se ua kap vëmendjen. Rrinë ulur si të hipnotizuar, ja kështu si ajo tashti, e vështrojnë ngultazi portretin gjenial të një masakre. Është thuase tabloja ua pasqyron në penelata truri masakrat e veta të ndërsjellta, luftërat e intensitetit të ulët në familje, banjot e gjakut midis shtëpisë e punës e marrjes së fëmijëve nga kopshti e tradhëtime të radhës, mizoritë që u shkrumbajnë përditë shenjtëritë e vjetra. Dhe nuk flasin. Mejtojnë. Guernica sikur u ndihmon të përpunojnë idetë.

Ajo është shumë seksi, në fakt. E ëmbël, e sofistikuar, e frustruar seksualisht. I shkon ngjyra e bardhë. I kontraston bukur me të zezën e flokëve, e me pigmentin mesdhetar të lëkurës. Athua si e ka kërthizën? Të zhytur? Të dalë jashtë? Një nga trillet e këtij profesioni është se të del kohë të fantazosh. Sidomos me çifte të heshtura, që të lënë kohë e hapësirë për të fantazuar në sesione të gjata pambarim. Ajo m’u duk e bukur që në krye të herës, kur hyri në ordinancë, si pelë e trembur. Unë i marr fillimisht çiftet në një a dy biseda individuale, pupu sa të palara që dalin aty. Sa Guernica të vocrra. Kur më dëftoi për abortin sekret që sa kish bërë, ishte gruaja me fëmijë të vdekur ndër krahë aty nën Minotaur, në skaj të majtë të pikturës. Diçka në mënyrën si fliste, në gjuhë të vëmendshme, të saktë e të ngadaltë, duke mbështjellur atë episod të dhimbshëm në shpërnej fjalësh të lidhura me kujdes, sikur po ecte mbi vezë, sikur po ecte mbi varre, më bëri ta shoh matanë maskash ashtu siç ishte atë ditë. Një grua që po ulërinte humbjet.

Duhet të flasim hapur, im shoq e unë, përsëriste here pas here, me një

tërbim të përmbajtur. Jo për abortin, gjithsesi jo, ai duhet të ngelë përherë sekret. Por duhet të flasim për marrëdhënien tonë. Ndryshe s’kemi të ardhme bashkë. Kështu nuk shkon më!

Më duket se ishte diku aty, midis duhet të flasim e kështu nuk shkon më, që unë rashë brendë. Njeriu s’ka mundësi ta shohë tjetrin, njëmend ta shohë, pa e dashuruar njëherit.

E shikoj tinëza orën, edhe pesëmbëdhjetë minuta sa pa mbaruar seanca. Pa të shohim, a do të flasim sot a jo. Bah. Janë të dy të shkolluar, të artikuluar në dy a tri gjuhë. Ajo ka gjuhë aq të bukur. Të vëmendshme, të saktë. Shprehëse. Por është bashkë me të shokin, e torturon veten, atë, e tjerët përreth, në heshtje të sikletshme. Burri zhvendos këmbët pa fjalë, ashtu si bën shpesh, duke ua këmbyer vendin një mbi një. Sytë vazhdon t’i mbajë tek lisi përjashta. Ai lis i masakruar prej sysh të nëmur kullon gjak të zi, si afishja në mur. Ajo replikon duke hequr një fije të padukshme flokësh nga fytyra.

Kanë edhe dy fëmijë bashkë, këta. Dy fëmijë të tjerë.

Ajo është sedërtare, e di. Janë sedërtarë, që të dy. Ajo ndihet e poshtëruar, pse ka nevojë të artikulojë ndjenjat, mendimet, pritshmëritë. Ai pompoz, si bibë e fryrë. Fyhen kaq lehtë, nga gjëra që bëri tjetri, gjëra që s’bëri tjetri, gjëra që do të ketë menduar tjetri, gjëra që do të ketë ndier tjetri. Bah. Klitoris im ka tetë mijë fije nervore, e prapë s’është më i ndieshëm se këta. Bah. Kjo e tyrja është vërtet një lidhje e shpikur në ferr, Venus im Pelz, Wanda von Dunajew e Severin von Kusiemski. Ajo do të ishte shumë më e lumtur po të ndahej nga ky derr burrë.

Por ncuk. Janë që të dy sklevër të një keqkuptimi. Ajo rrugëhumbur në reflektimet e afishes në mur. Ai me sytë e fiksuar te gjakderdhja e një lisi

në vjeshtë. Kjo fiks-ideja e epokës sonë, se njeriu mundka e u dashka ta ndalë entropinë. Thuase çdo rrëgjim mund të parandalohet, a të riparohet, a së paku të frenohet disi. Sa për të mbajtur ujë edhe ca, martesa, fejesa, lidhja e përzgatur. Familja. Institucioni. Shoqëria. Kjo i fiku këta dy, kjo shpresë. Kjo fantazi e marrë, absolutisht, absolutisht, se mos ndoshta do të mund ta rindezin disi bashkë atë zjarrin e fikur. Se mos do të gjejnë disi prapë njëri-tjetrin. Se mos do të ngrehen disi bashkë, lart mbi shkumbin e hirin e rrënojave, si feniksë magjikë.

Se mos do ta adhurojë ai sërish, si atëhere kur sa ishin takuar.

Kjo fiks-ideja e kompensimit, e ndëshlyerjes. Kjo ëndërra e saj boshe, që vërehet nga si e heq fijen e padukshme të flokëve nga fytyra, se tjetri do të ngrehet një ditë në krah të mbarë. E do të thotë, zemër më fal. Tash kuptoj se ç’sakrificë që paske bërë gjithë këtë kohë për hir timin. Tash e tutje, do ta bëj detyrë timen në jetë që të ta shlyej këtë sakrificë.

Do të ishte për të qeshur, po të mos ishte për të qarë.

Ajo mendon se mund ta ndihmojë. Në Guernicën e saj, unë jam Harlekin me lot prej diamanti, simboli mitik me fuqinë mbi jetën e vdekjen. Ajo pret nga unë që ta shpëtoj disi mrekullisht atë, marrëdhënien e saj, jetën e saj. Por Guernica u bë me porosi nga Spanja për një bienal arti në Paris, e Picasso s’lejoi kurrë që të shfaqej në atdheun nazist. Nganjëherë ndarja është terapia më e mirë.

Ajo mendon për fëmijën e vdekur, nuk mendon për dy fëmijët e tjerë. Ata po i rriten ndërsa ajo mban në krahë fëmijë të vdekur. Një ditë do t’ia plasim këtë në fytyrë. Kur nazistët pushtuan Francën dhe bastisën atelienë e piktorit, i gjetën pikturën Guernica. Ju e keni bërë këtë, e pyetën. Jo, u përgjegj Picasso, atë e bëtë ju. Të gjitha të vërtetat na plasën në fytyrë herdokur.

E shikoj tinëza orën, iku dhe kjo seancë. Të dy presin si mbi gjemba që t’u them se u mbaroi koha. Ai me kryet kthyer nga dritarja, sikur numëron gjethet në lisin jashtë dritares. Është lis i bukur. Ajo kthyer përgjysëm në anën tjetër, me shikim të ngulitur tek një afishe e varur në mur.



Kur ajo u shpërngul së pari në Kopenhagë, Kbanoi në një lagje në jug të qendrës, në Tåstrup. Për çdo ditë, në stacionin e trenit, e shihte një burrë që qëndronte i mbuluar në një stol dhe pinte birra. E, ndodhte zakonisht që përreth tij të ishin disa njerëz, por ishte ai, të cilin ajo e kishte vërejtur, sepse shpeshherë e përshëndeste.

- Mirëmëngjesi zonjushë e re - i thoshte.

Dhe ajo buzëqeshej e gëzuar që e njihnte. Përndryshe, ishte e panjohur për të tjerët.

Mbrëmjeve, gjatë rrugës kur kthehej në shtëpi, ajo ndalej dhe bisedonte pak me të. Dhe kështu, ajo e bëri ata që të fliste për veten. E quanin Lejlek dhe ishte i pastrehë. Me një lloj krenarie, ai i tregoi asaj kartën e sigurimit shëndetësor, ku shkruante Sven Holm dhe "Adresa e Panjohur." Atë formulim kurrë më parë s'e kishte parë. Ishte e vetëdijshme se s'ishte e zakonshme të qëndronte e të fliste me njerëz të tillë, ngaqë, zakonisht njerëzit u shmangeshin njerëzve endacakë. Por, ajo kishte nevojë për atë bisedë, sepse ishte private; një trajtim tjetër nga skaji i komunikimit normal. Dhe, ajo ishte edukuar që të ishte plotësisht e përkorë, sipas bindjes se të gjithë njerëzit ishin krijesa të Zotit.

Ishte një periudhë shumë intensive në jetën e saj, çdo ditë e mbushur me përvoja të reja - edhe në punë. Çfarëdo që bënte ishte e re, dhe kjo ishte puna e parë e vërtetë e saj. Çdo detyrë që i jepej i dukej e veçantë, dhe gati çdo ditë i duhej të kërkonte këshilla nga kolegë me përvojë. Kryesisht, shkonte lart te Danielsën; i cili punonte aty shumë vite dhe ishte udhëheqësi jozyrtar i saj. Dhe, atij i pëlqenin dukshëm pyetjet e saj. Zyra e tij ishte në nën kulm dhe çdo herë e pranonte me mikpritje të ngrohtë.

Gjatë javëve të fundit, ajo telefoni shpesh në shtëpi. Prindërit e saj e kishin ndihmuar të gjente apartamentin dhe të vendoste gjërat e saj në të. Por tani asaj i dukej se ata po e lënin vetëm, për të vazhduar jetët e tyre. S'ndihej e afërt me ta në telefon.

Babai i saj ishte i zënë me temën për Luther-in gjatë mbrëmjeve të lira; kishte punuar me të qysh nga koha e studimeve. Gjatë viteve herë pas here ishte munduar ta nxiste atë të interesohej rreth diskutimeve të tij për teologë të vdekur e të gjallë. Kurse nëna e saj, çdo herë e më shumë angazhohej në politikë, tani ishte në këshillin e qytetit e preokupuar me çështje të rëndësishme, si drejtuese e Komitetit të Asistencës Sociale. Kryesisht e telefononte motrën. Pasi që u shpërngul nga shtëpia, të dyja u afruan shumë më shumë me njëra - tjetrën. Motra kishte besim në të, ishte e vetme në adoleshencën e saj, dhe sa herë kishin mundësi, flisnin në telefon për orë të tëra.

Në një mëngjes, pak me vonesë dhe duke vrapuar gjatë shtegut për në stacion, ajo humbi portofolin. Me sa duket portofoli kishte qenë në maje të çantës dhe i kishte rënë tek nxitohej. S'e vuri re deri kur erdhi çasti që në stacionin e trenit të shfaqej kontrollori i biletave. Ajo s'mund ta gjente biletën mujore: s'mund të gjente as portofolin e saj. Konduktori e trajtoi me mirësi; e shihte sa e turpëruar dhe e hutuar që mbeti. Ajo ishte dashtë t'i jepte numrin e saj personal, emrin dhe adresën, por s'mundi t'i vërtetonte asnjërin; karta e sigurimit dhe të gjitha të dhënat e tjera ishin në portofol. Ajo mendoi që të kthehej prapa menjëherë dhe të kërkonte, por u frikësua se do të merrte një gjobë në tren dhe do të vonohej për punë. Në çdo rrethanë, portofoli ishte humbur, ajo s'llogariti ta shihte më. Pas pak zbriti në Norreport dhe shkoi në punë me shpresë se dita do të shkonte në një mënyrë normale. Kur arriti te dhomëza e vet e punës, kishte mundësi të telefononte. Së pari telefoni në stacion, ku i thanë se s'kishin gjetur asnjë portofol, pastaj ne polici, që e referuan te zyra e sendeve të humbura. Në fund, me përlësi telefoni

ËSHTË VËSHTIRË TË JESHI SHENJTË NË QYTET

Tregim nga Niels Hav

Përktheu nga danishtja Edita Kuçi Ukaj

regjistrin kombëtar që të anulonte kartelën e sigurimit. Telefonata, në një mënyrë ishte jo e suksesshme; karta s'ishte e vjedhur, ajo e kishte humbur atë! - Çfarë dëshiron që ne të bëjmë për atë? - e pyeti gruaja me sarkazëm - ta mbylli zyrën dhe të shkoj ta kërkoj?

- A mund vetëm ta regjistrosësh që e kam humbur kartelën? - e pyeti ajo.

- Ne mund ta raportojmë të humbur, tha gruaja, është e vetmja gjë që mund të bëjmë.

Kështu, e gjithë dita i shkoi me një ndjenjë shqetësimi. Ajo ishte lejuar të telefononte edhe në Jutland, por askush s'u përgjigj. Tek pasdite erdhi Danielsën me një çështje që e kishte përpiluar një javë më herët. Një gabim ishte gjetur - e kishte neglizhuar një pikë të rregullores. Në të kishte elemente që s'i kishte kuptuar. Dhe, për një moment kishte frikë se mos po ia plaste vajit, ishte sikur një ujëmbledhës që papritur rritej, duke kërcënuar të përmbysset. Në përfundim të ditës së punës, huazoi njëqind krona nga një koleg, mjaftueshëm për tren dhe pak ushqim.

Kurse në ora gjashtë e gjysmë doli duke u çapitur nga stacioni. S'mendonte gjë tjetër, pos të të shkonte në shtëpi, të mbyllte derën dhe të rrinte e vetme. Por, papritmas dikush iu shfaq në shteg përpara saj. Ashtu, në hutim, në fillim u tremb dhe u ndaloi hovin. Ishte ai, Lejleku, i cili në dorë e mbante portofolin e saj.

-Këtu, tha ai, e pashë që e humbe. Ai buzëqeshi me dhembet e tij të prishur dhe u duk i gëzuar. Të gjitha komplikimet dhe shqetësimet erdhën si goditje rrufeje mbi të, ajo e shikoi ngultas. - Pse s'the asgjë? Pse s'më ndjeke mua, ose të më thërrisje mua? - S'mund t'iu nxija, tha ai, nxitoje. - Budalla! tha ajo. Idiot! Dhe e kapi portofolin nga dora e tij, e futi në xhepin e xhakës dhe iku.

Në shtëpi, në divan i kontrolloi të gjitha gjërat, një nga një. Aty ishte patentshoferi, sigurimi i shëndetësorë, kartela e trenit, një biletë e shfrytëzuar e kinemasë. Edhe parat ishin aty, kartela bankare. Asgjë s'mungonte. Në fotografi buzëqeshte motra e saj me mirëbesim. Ajo ishte e lumtur. Dukej sikur të kishte shpëtuar nga një aksidenti madh. Por, menjëherë, ajo u turpërua për sjelljen e saj. Si kishte mundur ta trajtonte Lejlekun aq keq? Me vendosmëri e kapi xhakëtën dhe doli prapë jashtë.

Hapësira mes pallateve të apartamenteve shtrihen si një mbrëmje shkretëtire, s'kishte asnjë njëri. Në fakt, ajo asnjëherë s'kishte dalë jashtë pasi kishte ardhur në shtëpi nga puna: i tillë ishte ai lloj vendi. Sheshi para stacionit ishte po ashtu i zbrazët. Ajo hyri brenda. Ishte një djalë i ri te makina e biletave, përndryshe askush. Ajo kishte nevojë të shfaqte mirënjohjen për dikë, por ai e shikoi me dyshim. Në shesh, ajo thërriti një herë, vetëm një hello të ngulfatur nga vendi i shkretët. Dhe asnjë përgjigje s'u dëgjua. Ajo eci ngadalë rrugës për në shtëpi në një muzg të çuditshëm. Nesër, mund ta falënderonte atë. Dhe ajo do ta bënte.

Por mëngjesin tjetër, ai s'ishte aty. Në bankën te qoshja ishin ulur dy burra tjerë duke pirë birra. Me ngurrim iu afrua dhe i pyeti: ku ishte ai? A e kishin parë ata? Ata e ftuan për një birra. - Zakonisht ai ulej këtu, tha ajo dhe u mundua ta përshkruante. Ata qeshen më të, duke u zbavitur me dialektin e saj. Ata e njihnin shumë mirë. - Përse po të vyen? A mund të vyejmë njëri prej nesh?

Treni i saj erdhi në peron dhe ajo u dorëzua, iu desh të kthehej.

Ishte korriku. U ul në tren dhe duke kaluar shihte rrahjet e pemëve me gjeteth kaltra në të bltë, të zëvendësuar nga shtëpitë dhe bulevardet të panjohura me trafik të dendur. Me padurim kishte dalë

nga shtëpia, të fillonte jetën e saj, të vinte në qytet dhe të jetonte. Ky dëshirim e kishte mbushur tërë vitin e fundit të gjimnazit.

Kur hyri në zyrë, një buqetë me lule ishte vendosur në tavolinën e saj. Ishte një befasi e plotë, por prapë ishte e goditur nga një shok i gëzimit, sikur ta kishe pritur. Një buqetë e përzier me shumë lloje të luleve, i kontrollloi deri sa e vari xhakëtën në vend. S'kishte letër, as përshëndetje. - Nga kush mund të jenë këto? - i pyeti të tjerët në zyrë. - Ndoshta një klient i kënaqur? Nëse është ashtu, atëherë do të ishte një befasi, i pari në gjykatën e përmbarimit. Lulet u studiuan me një prekje xhelozie. Askush s'e dinte se nga ku kishin ardhur. - Një admirues. A ke të dashur?

Në vitin e dytë të gjimnazit kishte pasur një të dashur. Ai ishte tri vjet më i vjetër, por papritmas e kishte lenë për dikë tjetër. Më vonë zbuloi se ai kishte dalë njëkohësisht me disa vajza. Ajo me naivitet e kishte menduar atë si shpirtin binjak. Zhgënjimi ishte akoma i pranishëm, vërejtja ajo. Ajo ndjente një ndjenjë zbrazëtie që kishte lidhje nëntokësore me hezitimin. Në mesin e punës u bllokua dhe i lejoi mendimet të fluturonin. Kjo ishte pjesa e saj kur me se paku u kujdes. Ambicia e saj ishte të jetë e pavënë re dhe e qëndrueshme, të përshtatej dhe të jetë secili tjetër. Pas pak, Danielson erdhi poshtë me një çështje të re. Diçka rreth zbatimit penal. Kur ai u ul me letra në tavolinën e saj, gjunjët e tij i preken të sajat. - Vetëm për ty, tha ai. Ai e shikoi buqetën, por s'komentoi asgjë për të.

Pasdite, ajo ishte disa minuta e vetme në zyrë. E rrëmbeu telefonin dhe thirri në shtëpi. Babai i saj u përgjigj.

-A më dërgove ti lule mua? pyeti ajo.

-Lule? Jo, pse a është dashur?

Ai tingëlloi i çuditur, sikur ta kishte zgjuar. Oh! Ajo mund të shihte të gjithin para saj! Ajo mund ta shihte siç ishte, kafen, lullën, dritën e shkrehur në librari.

-Kam një varrim në ora katër, tha ai.

-Dhe si je ti? - e pyeti ajo, si një e rritur.

-Po, tha ai, ndjekur me një heshtje, sikurse pyetja e saj të kërkonte përgjigje të gjatë.

-Ka ra shi tërë ditën, tha ai më në fund.

Pastaj telefoni motrën e saj. Ato folën dhe bënë shaka në fshehtësi. Përveç kësaj i tregoi për buqetën, duke e bërë të dukej pak ekzotike.

Nga kush në këtë botë mund të jetë? -Dëshiroj që të jesh këtu, shtoi ajo me spontanitet. A s'mund të vish tek unë? Natyrisht ajo s'mund tani.

Të tjerët, u ulen prapë në vendet e tyre në zyrë. Ajo u përkul në çështjen që kishte përpara, dosjen e re në tavolinë, e cila kishte të bënte me një burrë të dënuar



me një gjobë sepse kundërshtoi të shkonte në gjykatë. Ai kishte udhëhequr një dyqan të vogël të rrobave. Kur ishte mbyllur, ai kishte dhuruar aksionet e mbetura nga veshjet jashtë modës për bamirësi. Doganat e kishin dënuar të paguante taksë shitjeje me çmimin origjinal të tregut, edhe pse vlera e aksioneve ndërkohë ishte hequr. Ishte shqetësuese. Ajo kishte lexuar për ketë çështje në gazeta, dhe tani pikërisht ajo i kishte ardhur në tavolinën e saj. Kundër dëshirës së saj, kishte përgatitur thirrjen në gjyq. Për arsye të këtij veprimi burri rrezikonte borxhe të patundshme, përndryshe, ekonomia e tij ishte mjaft e pasur. Simpatia e saj ishte në anën e tij, por s'ishte rubrikë ku ajo mund të shkruante simpatinë e saj. Tani për tani, ajo s'mundi t' i kompletonte thirrjen për gjyq; thjesht s'mundi ta shihte emrin e vet aty. Për një moment lejoi mendimet të fluturonin. Buqeta qëndronte rrezatuese dhe atë e mbushi plot imagjinatë. Atëherë e kujtoi Lejlekun, a mund të jetë nga ai? - tha. Turpi i saj u përfshi nga një fuqi përzier gëzimi për lulet. Si ka mundur të trajtonte aq keq? Ajo i shtyu të gjitha anash dhe u fokusua prapë në lëndën që kishte në dorë.

Kur përfundoi puna, mbështolli buqetën me një gazetë që ta merrte me veti. Uji rrodhi në tavolinë dhe papritmas u ndie keq t' i merrte me veti. U pendua: lulet duhet të mbesin në zyre. Mund të jetë bërë ndonjë gabim. Ndoshta ato s'ishin fare për të. Dhe pastaj i çmbështolli dhe i kthej sërish në vazo.

E vetme, u largua nga rrugët verore të mbushura me njerëz.

Ishte e premte, s'kishte dëshirë të kthehej në periferi. Një fundjavë e vetmuar e priste atë. Hyri në një kafëne, porositi një kafe, u ul dhe e shikoi një gazetë. Njerëz të lumtur kalonin pranë saj. Turistët duke shëtitur dhe qytetarët vendas duke nxituar drejt shtëpive të tyre pas një dite me punë. Ajo vetë, vërtet s'u përshtat aty.

Në mbrëmje, u shtri në krevat dhe shikoi televizion: luftëra, aksidente, një vetëvrasje. Pastaj e zuri gjumi me rroba veshur. Fjeti një orë, ndoshta dy, dhe u zgjua me një ndjenjë të keqe sikur të kishte bërë diçka të tmerrshme. Sikur të kishte përjetuar një tragjedi pa e ditur fare. U ngrit, pastroi dhëmbët dhe shikoi fytyrën e saj në pasqyrë. Okej, mendoi, kjo je ti, kështu dukesh ti. S' ishte as e bukur dhe as e shëmtuar, por vetëm e zbehur. Një sirenë ambulance u dëgjua duke kaluar në distancë. Ajo u shtri e zgjuar dhe dëgjoi tingujt e pakuptueshëm të natës. Ajo mendoi për dosjen që pati në tavolinë.

Gjithë atë të shtune qëndroi e shtrirë në krevat. Më në fund, pasdite vonë u ngrit dhe shikoi poshtë në parking para bllokut të pallatit. Një grumbull grash me sari lloj-lloj ngjyrash ecnin në drejtim të një makine, duke folur me padurim me njëra - tjetrën. Asnjërin s'e njohu. Të dielën shkoi në kishë. Famullitari ishte një nga shokët e klasës së babait dhe e kishte vizituar një herë para disa viteve kur ishte një adoleshente e re. Teksti ishte nga Mateu: "Ai bën të lindë dielli i tij mbi të këqijtë e mbi të mirët e të bjerë shi për të drejtët dhe të padrejtët." Ajo këndoi himnet me gjithë sinqeritet. E mori kungimin. Pastaj zbuloi se ishte njëra nga të fundit që u largua. Famullitari rrinte te dera duke përshëndetur me duar, dhe ajo e prezantoi veten. E tha emrin e saj me një pritshmëri absurde, që ai do ta njihnte menjëherë. - E diel e mbarë, tha ai. Ashtu siç iu tha edhe të tjerëve. Kështu që, ajo qëndroi në shesh në një të diel boshe e të shpërndarë në të gjitha anët. Kjo është diçka që ju ndodh të gjithëve, tha me vete. Më vonë, atë pasdite shkoi të merrte karamelë në stacion. Qëndroi jashtë kioskës një kohë të shkurtër duke kërkuar Lejlekun, por ai s' ishte aty, banka ishte e zbrazur nën dritën e diellit. Një çift i ri duke mbajtur fëmijën e tyre në duar kaluan pranë saj. Ajo iu buzëqeshi, por

ata s'e panë. Ajo qëndroi me buzëqeshje të papërshtatshme.

Në mëngjesin e të hënës kur arriti në zyre, ajo largoi buqetën të pragu i dritares, thjesht, s'u ndie e rehatshme me ato lule. Pastaj, mori dosjen dhe shkoi lart te Danielsen. Ai ishte ulur në tavolinën pedante, duke lexuar disa gazeta.

-Po, vajza ime? tha ai.

-Kjo s'është e drejt, tha ajo. Çfarë ka bërë gabim ky burrë në të vërtetë?

-Kjo është diçka për çka ne s' kemi nevojë të spekulojmë, tha Danielsen. Është krejtësisht legale dhe kjo mjafton për ne, vetëm duhet të mbledhim para.

-S'është e mjaftueshme për mua, tha ajo. Ai ia hodhi asaj vështrimin juridik të mbushur me skepticizëm dhe ironi.

-Ti je një jutlandere shumë kokëforte, tha ai.

-Ka diçka që quhet drejtësi, tha ajo.

Ai u ngrit në këmbë dhe dytë u përballen me fytyrë me njëri - tjetrin.

- Akoma po vjen aromë e këndshme në zyrën tënde? pyeti ai. Papritur i vendosi duart në krahët e saj të zbuluar; ajo s'mund të lëvizte, dhe ndiente dridhje të ftohti te shpina e saj. Ai futi dorën nën bluzën e saj dhe ia preku gjinjtë, dora e tij e ftohtë ia lëmoi lëkuren e saj. Ajo e shtyu nga vetja. Zemra e saj u godit, e gjitha u dridh, ndaj iu desh të mbahej në tavolinë. Ishte shumë e çuditshme. Danielesen rrinte dhe shfletonte nëpërmjet një dosje sikur asgjë të mos kishte ndodhur.

-Drejtësia është një gjë qesharake, tha ai.

-S'është edhe aq qesharake, tha ajo. Ai qeshi. - Është vështir të jesh i shenjtë në qytet, tha ai - a s' mendon kështu? Ajo hapi derën dhe kaloi në korridor, ku dy njerëz nga një tjetër departament ishin duke folur te kopjuesi, dhe asnjërin prej tyre s'e njohu. Ajo kaloi pranë tyre dhe vrapoi shkallëve poshtë sikur të mos ishte mjaftueshëm shpejt. Poshtë, në vendin e saj mori buqetën nga pragu i dritares, e çoi jashtë dhe e hodhi me vazo dhe çdo gjë ne të, në koshin e plehrave.

Nën katin e sipërm të stacionit rrinte Lejleku. Binte shi dhe ai këndonte. Një gëzim i madh e mbushi. Ajo ishte jashtëzakonisht e lumtur, vrapoi dhe e përqafoi. Sikur të ishte një i afërm i saj.

-Zonjushë e re, tha ai, ti mund të hysh brenda dhe të na sjellësh një birrë. Ajo nxitoi në kioskë. -Kam nevojë për birrë - një gjysmë pakete, tha ajo. Ata qëndruan dhe pinin dhe shikonin përtej shiut, se si njerëzit vraponin te biçikletat ose te autobusët.

Rrufeja e largët gjëmoi dhe retë e mëdha e errësuan qiellin.

-Nëse vazhdon të kryesh nevojën në shtratin tënd, një ditë do të mbytesh nga muti yt, tha Lejleku.

Ajo qeshi.

-Është vështir të bëhesh i shenjt në qytet, tha ajo.

Shiu ndaloi. Pika të rënda e përplasen asfaltin para stacionit, uji u spërkat në këpucët e tyre. Një rreze drite kërciti drejt në qiell. Ajo s'kishte parë asgjë më të mrekullueshme. Papritmas një bubullimë u dëgjua nga lart. Ishte sikur çdo gjë të ishte tronditur nga një grusht i madh, dhe toka u dridh nën këmbët e tyre. Për një sekondë bota mbajti frymën. Shiu pushoi. Pastaj stuhia shpërtheu me zell, bubullima kaloi në seri përsëritjesh; çdo gjë u bë e zezë. Drita frushkulloi nëpërmjet ajrit dhe grisi në re në një britmë të patundshme. Dritaret e kupës qiellore u hapën, uji u derdh nga qielli dhe e përfshiu sheshin e stacionit. Njerëzit u grumbulluan bashkë nga shkallët, në podium e stacionit. Lejleku hodhi xhaketën dhe e nxori bluzën mbi kokën e tij. Trupi i tij ishte i dobët dhe muskolor dhe lëkura e tij shkëlqente bardh në dritën e egër. Ai kërcu jashtë në shi. Uji i kullonte nëpër këpucët e tij të shqyera. Ai ngriti duart e tij si një valltar dhe këndoi me gjithë fuqinë e tij. Ajo e vuri shishen poshtë dhe i zbatih këpucët. Pastaj, shkoi jashtë në shi, tek ai.

Një vepër kapitale

FJALORI SERBISHT-SHQIP

Autor i kësaj vepre monumentale është shkrimtari e publicist i njohur, Rexhep Zllatku, ndërkaq e botoi Logos A, Shkup

nga Avni HALIMI

Kohë më parë doli nga shtypi Fjalori Serbisht-Shqip, vepër kapitale kjo e Rexhep Zllatkut, me një fond prej rreth 80 000 fjalësh!

Rexhep Zllatku është doajen i gazetarisë shqiptare në Maqedoninë e Veriut, një prej penave më produktive në letrat shqipe. Kjo vepër e fundit e tij do të ngëlë monumentale për faktin se është produkt personal i dalë nga një punë shumëvjeçare, i cili, në fakt, do të duhej të ishte produkt i institucioneve nacionale, akademike.

Rexhep Zllatku në aktivitetin e vet krijues gjithnjë është shquar si një lëruar e posaçëm, me një përkushtim e profesionalizëm të pasqor, duke sjellë vepra shumë të rëndësishme në publicistikë, në letërsi dhe, së fundmi, edhe në gjuhësi.

Fjalori, si një inventar i fjalëve të një gjuhe në njërin anë dhe, në anën tjetër, përkthimi i tyre në një gjuhë të caktuar, me shpjegime të hollësishme leksikografike, gramatikore, sintaksore etj., është një vepër, zakonisht e një ekipi akademikësh, një punë jashtëzakonisht voluminoze, e gjatë, që kërkon përkushtim profesional, përgatitje dhe një kulturë të theksuar gjuhësore.

Fjalori Serbisht-Shqip i Rexhep Zllatkut shumë shpejt do të bëhet si një prej fjalorëve më të kërkuar dhe më të përdorur. Si pasojë e politikave fashioide të një periudhe të caktuar që ka kultivuar Serbia në raport me shqiptarët e rajonit, ka ardhur edhe deri te shkëputja e kontakteve dhe mosnjohja e ndërsjellë e gjuhëve respektive, sidomos nga gjeneratat e reja. Nga ana tjetër, kërkesat që shtrohet nga tregjet e reja, tërësisht të lira, nevojat për bashkëpunim ndërfqinjësor, ndër-rajonal e më gjerë, njohja e ndërsjellë me këto dy gjuhë do të jetë nevojë imediate. Prandaj, Fjalori i Rexhep Zllatkut na vjen si një rezultat i një pune profetike në momentin dhe kohën e duhur.

Së këndejmi, edhe vendimi i Shtëpisë Botuese LOGOS A për ta botuar këtë vepër të Rexhep Zllatkut, është një prej vendimeve më të rëndësishme që mund të dalë vetëm nga institucionet nacionale serioze, që me përkushtim profesional jepen pas botimit të veprave kapitale. Ky botim do të jetë një prej investimeve më domethënëse të LOGOS A, që bën që kjo Shtëpi të rangohet ndër pozitivat më të larta të produksioneve letrare kombëtare.



Kur Bernard Habacia doli në pension të parakohshëm dhe u kthye në vendlindjen e tij, duke deklaruar se do të bëhej rezident aty, banorët shfaqën habi. Vërtet, Bregasi nuk ishte më fshati që kishte lënë dikur, tashmë i ngjante një qyteti të vogël. Por, megjithatë, gjithë ai burrë me karrierë në zyrat e Ministrisë së Brendshme do të mundej, vallë, ta hidhte pas shpine jetën e kryeqytetit?! Aq më tepër që ishte kthyer me të shoqen, Anita Bokaninin, amerikanen me të cilën ishin dashuruar me vështrim të parë. Dhe nuk ishin pak ata që ende e mbanin mend aventurën e tyre. Anita Bokanini kishte ardhur me vëllain nga Nebraska, të ftuar në dasmën e një kushëriri nga trangu i gjakut. Aty u njoh me Bernardin. Ajo fliste anglisht dhe pak shqip, kavalieri shqip dhe ca anglisht. Kaq mirëkuptim krijuan ndërsa danconin, sa në mëngjes, kur krushqit erdhën për të marrë nusen, këta partnerët mungonin. Ai e kishte ftuar të bënin shëtitje me makinë në kryeqytet, të drekonin së bashku dhe pastaj le të vendosnin vetë për fatin e tyre. Se çfarë vendosën u mor vesh shpejt. Vëllai u kthye në Nebraska pa motrën dhe kur e pyetën ku është Anita, u përgjigj gjithë mllef: “Ma rrëmbyen!” Nga mëria që nxori, dukej sikur, më tepër se së motrës, atij rrëmbyesit nuk do t’ia falte në jetë të jetëve!

Por ç’përgjigje i dhanë habisë së bregasve bashkëshortët?

Mbasi u vendosën në shtëpinë dhe tokën e trashëguar, si njerëz të drejtpërdrejtë, nuk i fshehën qëllimet e tyre. Anita Bokanini tha se atje, në bregun e lumit Mizuri, e mësuar të merrej me derrat në fermën e të atit, do t’i dukej lule të merrej me viçat në fermën e saj. Ndërsa zoti Habacia u deklarua haptazi se do të bënte hetime private për të dielën tragjike. Sapo përmendej ajo e diel korriku, ndonëse kishin kaluar vite, të gjithëve u ngjetej trupi, duke kujtuar gjëmën e madhe të Gropës Thithëse. Nuk kishte ndodhur ndonjëherë që Bregasi të përcillte nëntë arkemorte në një ditë. Dhe nëntë të vdekurit nën moshën tridhjetë vjeç.

Ndeshja e futbollit si miqësore kishte nisur edhe atëherë. Por përfundoi, pas ndërprerjeve të shpeshta, me dy kartonë të kuq dhe rezultatin e ngushtë 6:5. Luanin bregasit kundër bregasve, ekipet amatore të dy lagjeve kufitare. Fusha ishte pa rrethim dhe pa dhoma të zhveshjes. Afërmendsh, të djersitur siç ishin, disa futbollistë u nisën drejt lumit. Ata që shkuan, nuk u kthyen më. Autopsia e pati të lehtë të përcaktonte shkakun, mbyjtja dukej qartazi nga mushkëritë. Por hetime të hollësishme nuk u bënë, sepse, duke u trajtuar si ngjarje aksidentale, dosja u mbyll shpejt.

Bernard Habacisë i mbeti pengu qysh atëherë. Ai i tha së shoqes:


“Gropa Thithëse vërtet është e njohur për humbjet e mëparshme. Por si është e mundur që nëntë meshkuj të fuqishëm të mbyten njëherësh aksidentalisht?”

“Edhe derra të kishin qenë, - ia ktheu Anita Bokanini, - të paktën njëri do të kishte dalë nga gjeratoret e ujit”.

Në logjikën e hetimeve të tij, duke pranuar shkakun e vdekjes, Habacia përjashtoi shkakun e mëparshëm të mbyjtjes. Mbyjtjet nuk mund të ishin të rastësishme. Po përse kishin ndodhur

GROPA THITHËSE

tregim nga Zija Çela



në atë pjesë të lumit, së cilës të gjithë banorët i shmangeshin?! Sipas tij, këtu po, ndoshta këtu mund të kishte luajtur rol rastësia. Teksa kalonin mbi bregun e lartë, për të zbritur pastaj në pjesën e rrafshët të plazhit, dikujt i kishte rrëshqitur këmba dhe kishte rënë papritur në Gropën me shpella, çarje të tabanit dhe flluska të nënujshme. “Kuptohet vetiu, - thoshin të bindur bregasit në ditët e mortit, - tetë të tjerët u flijuan për ta shpëtuar”.

Hetimet e Bernard Habacisë morën kohë. Por edhe hapën plagë të vjetra. Ai bëri kërkime në terren dhe mbledhi dëshmi, duke vizituar familjet e të ndjerëve, duke takuar bashkëmoshatarë të tyre, pastaj futbollistë që kishin luajtur në atë ndeshje, deri edhe arbitrin që s’i kishte shpëtuar dhunimit fizik. Por lexoi gjithashtu gjithë sa kishte mbetur e shkruar për Bregasin e atij viti, pavarësisht në kishte apo s’kishte lidhje me ngjarjen. Habacia synonte të njohte sa më mirë marrëdhëniet që kishin pasur viktimat me njëri-tjetrin. Teksa po mbyllte kërkimet, i dha zgjidhje edhe pyetjes që e mundonte: Cili ishte ai që i kishte rrëshqitur këmba, duke u bërë hallka e parë e zinxhirit pasues?

Mbasi analizoi dosjen e tij

voluminoze, Bernard Habacia formësoi katër versione për ngjarjen. Por përkohësisht, pasi në përfundim të analizës mbajti vetëm njërin. Atë që i përmbushte më bindshëm rrethanat dhe motivet. Ky është versioni i lidhjeve shkak-pasojë, me të cilin hidhte dritë në kronologjinë e ngjarjes.

Ai që i kishte rrëshqitur këmba ishte njëri nga vëllezërit Shasili. Me gjasë më i ri. (Mos ia kishte dhënë dikush të shtyrën si pa dashje?) Në atë kohë, ata kishin konflikt të egër mes tyre. I ati donte ta ndante pasurinë dhe djemtë t’i nxirrte shtëpi më vete, ndërsa vëllezërit grindeshin për pjesën që lakmonin të merrnin.

Si pa që Norisi po vonohej për të dalë në sipërfaqe, Gramozi murmuriti: “Një rast si ky nuk më vjen herë tjetër! Nëse ai vdes ende pa u martuar, e gjithë trashëgimia më mbetet mua.” Kur u hodh në ujë, në krahasim me të vëllanë, kishte epërsi rreth një minutë për mbajtjen e frymës në thellësi. Aq sa i mjaftonte për ta mbërthyer deri në vdekje tjetrin.

Afërsisht një minutë priti në stomin e lartë edhe Armandi. “Qelbanik, - shfreu me vete për Gramozin, - jo vetëm penalltinë ma more me hilë, por u

ndëshkova edhe me karton të kuq. Për fajin tënd u përmbysën bastet dhe unë humba makinën”. Pastaj, duke mbyllur gojën dhe duke zënë hundën me pëllëmbë, u lëshua vrikthi më këmbë.

Tashmë Kocani i Bërrylit (me këtë nofkë njihej) nuk po ia ndante sytë ujit. Ai tha me zë: “Po bëjnë shaka ata poshtë, apo si është puna?” Por nën zë foli ndryshe për Armandin: “Pa më thuaj tani, këlyshi i kurvës, çfarë doje parmbremë në diskotekë?! Nuk të kënaq lagjja jote për marijuanën, por dashke edhe territoret e mia të kokainës?!”

Nuk u shpëtoi etheve të hakmarrjes as Tushi i Nurkës, gruas më të bukur të Bregasit. Në festën lokale, me tryezat ngjitur e ngjitur, herë pas here Kocani ia kishte ngacmuar të shoqen. Madje guxoi t’i thoshte ballazi: “S’je burrë për atë grua ti!” Dhe kur Tushi deshi të mbante qëndrim, tjetri i kishte hedhur një vështrim si mes gishtash, por aq përbuzës, sa të pranishmit ia ndien zemërimin përvëlues. “M’u duk sikur do të ngrihej nga vendi, do të ta këpuste veshin me dhëmbë, pastaj do ta hidhte në pilafin që po haje”, - i tha Nurka të shoqit më vonë. Andaj, përpara se të hidhej në ujë, Tushi iu drejtua me mend Kocanit të Bërrylit: “Kanibal, më prit tani, se të erdhi ora!” Ai ishte vonuar kastile për të pasur më tepër se një minutë epërsi në oksigjen.

Po si mund t’ia falte Tushit konkurrencën e pandershme Luzi Fortuzi?! Duke shfrytëzuar tërheqjen që krijonte Nurka (“Kurvica, po i tërbon hamshorët me cica!”), Tushi kishte hapur një kafene ngjitur me lokalin e Luzit dhe e kishte falimentuar mizorisht, pa dashur t’ia dinte aspak për hallet e tjetrit. Për të ngritur atë biznes, Luzi Fortuzi kishte marrë kredi bankare, duke lënë si garanci garazhin e tij dhe apartamentin e prindërve. Në rrugë të madhe t’i hidhte pleqtë tani?! Në çastin që vendosi të hidhej në ujë, duke u sprapsur pak për të marrë hov, Luzi i falimentuar u mbush mirë me frymë dhe...

Dhe mbas të gjashtit e pësuan tre të tjerët. Por, siç pohonte kronologjia, gjithnjë me një motiv paraprak: I dyshuar për pjesëmarrje në rrëmbim personi. Dëshmitar i rremë në një gjyq për trafikim të mishit të bardhë. Shëmër në dashurinë për Eva Zakon dhe tritol i telekomanduar nën shasinë e makinës.

Ky version i analizës hetimore mbyllet me arsyetimin: “Duket sikur për mbyjtjen ata zgjodhën parimin: Të gjithë si një dhe një si të gjithë. Ndërsa, kur panë vdekjen me sy, ndoshta kaluan në situatën: Secili për vete dhe Zoti për të gjithë. Mirëpo, për shkak të përlëshjeve të gjata, tashmë s’u kishte mbetur pikë fuqie për shpëtimin.”

Megjithatë, Bernard Habacia nuk nxitoi për ta paraqitur dokumentin në prokurori. Ishte e pritshme që atje do ta pyesnin: keni ndonjë provë se zinxhiri mund të funksionojë në këtë mënyrë? Për të krijuar bindje, ai la të shoqen, Anita Bokaninin, të merrej me administrimin e fermës, kurse vetë u nis për në Nebraska, ku ndodhej Laboratori Natyror i Gropave Thithëse. Kanë kaluar pesë muaj qysh atëherë dhe ai nuk është kthyer. Në Bregas kanë filluar të thonë që, nëse mbyjtjen e ka testuar me kunatin, mund të mos kthehet kurrë.

Tiranë, korrik 2020

TEH

Rrëshqasin
gjysmëshkallëve
gjysmëfytyra
të gjysmëndriçuara
nga gjysmëhëna
e këtij gjysmëmuaji
drejt një tehu humnere
që mbetet në teh!

HELENA E TROJËS

Helena më tha duke lotuar;
"U mërzi,ta,
së qeni e bukur,
së tradhëtuar burrin
dhe së braktisuri Spartën.
Kaq shekuj u lodha
së mbajturi në sy
Trojën e djegur
dhe hirin,
që ju zë sytë helenëve triumfues
tek ikin nga Troja.
U bënë kaq shekuj
që Akili e vret Hektorin
dhe Hektori që s'di të vdesë.
Mos i besoni bukurisë time,-
Homeri i vërbër qe!"

PIK'JETË

... Aty nisi,
Kur rrezja e parë hyri mes grykës
Dhe krisi,-
Lëkur'e daulles çahet nga forc'e pykës.
Lëshohen
Këngë e fjalë, lot'e mall, gëzim' e dhimbje
Dhe dëgjohen
Të pathënat e dergjura që në lindje!
Trazoje, trazoje
Me at' rrezepykë shtratin hyjnor ku jeta nis,
Shikoje, mësoje
Si farën e parë të hedhësh për të mbjellë filiz!
O fuqi,
Që më vjen nga fund'i barkut si magji,
Dhe rini,
Që sot më mbushe plot me jetë dhe freski!
Pik'jeta
Nis me at' pikë gjaku që nxjerr lëkur'e
daulles,
Dhe vdekja
Vjen kur shteg' i vjetër i zë daljen udhës!..

-Triptik-

Rin lumi si im bir

Në të dyja anët,
Lundrojnë brigje,
shelgje, gjethe, deg'e pemë...
Male, kondra, lëndina e pllaja bukuroshe,
Sillen rreth'e rrotull - pak më tutje.
Kështjellat dhe qytetet mesjetare,
Kapur dorë për dorë me këmbët në ujë,
Me sytë e dritareve vocrrake,
Shohin mbi ty dhe gati rrëzohen nga
marramendja...

Kapilarëve të rrugëve dhe në urat përmbi
Jeta vërshon pa ndalur,
Duke pirë në ty.

Mijëra zogj dhe shpend gjithfarësh,
Bashkë me shqiponjat krah-bardha
E mbajnë qiellin me sqep që të mos bjerë!
Retë puplore me forma aliene,
Kalërojnë erën tej' e tej
Dhe dora dorës përcjellin drejt perëndimit,
diellin e pasditës
lagur rrezesh në ujin e kurmit tënd.

Nga një guvë zemrash buroi,
Currili yt,
Ushqyer me qumësht dhe mbushur me gjak,
Legjendë mijëvjeçare që lëshohesh teposhtë
si ortek lumi



PIK'JETË

Cikël me poezi nga Arben Çejku

Duke marrë me vete copa mali,
Copa jete dhe tinguj fjale,
Në hapat vërshues merr përpara,
Ditën që shkoi dhe ditën që vjen,
Këngën e pakënduar dhe meloditë e zanave,
Tymin e prushit dhe zjarrin e pandezur,
Borën e ardhshme dheulet e paçelura...

Jetës i shkon mes për mes si lumi,
Si emri dhe biri që je,
Duke lënë pas alpet dhe shtigjet e ngushta,
Shkëmbinjt majemprehtë dhe honet e
pabesa,
Pllajat cicëmëdha që të mbushën shtatin,
Pyjet dhe borën që mbështjell plagët,
Shpellat magjistare që tymojnë mister,
Jehonat e këngëve dhe vajet e bilbilave,
Jetët e dikurshme dhe ato që do vijnë,
Tutje ikën ti,
Si lumi,
Si emri,
Dhe biri që je,
Rin...

Mes për mes si biri,
Si emri dhe lumi
Që je,-
Jetës i shkon pa ndalur,
Pa sosur..
Një mal me ujë që ikën tutje,
Mes për mes ditës
Mes për mes natës,
Mes për mes shtigjeve,
Mes për mes tokës,
Mes për mes jetës
Duke vërshuar dhe gurgulluar
Si fjalë homerike që s'ka të ndaluar.

Qëndroj pranë teje,
Të sodis nga agimi në mbrëmje-
E nga mbrëmja gjer në agim,
Pa gjumë në sy e pa ëndërr nën jastëk;-
Ta shoh profilin,
Brigjet t'i shoh,
Dhe jetën tek rrjedh aty në ty - me ty;-
Herë si qetësi dhe përmasi,
Herë si rrëmbim e si stuhë,
Herë si rrebesh e si duhi,
Herë si pui dhe qetësi,
Herë si fjalë mjalti veshur flori,
Herë si pickim akrepi ngjeshur në sy,
Herë si ngrohje zjarri me prushin aty,
Herë si kallkan zomre që nxi e vetëm nxi,
Herë si këngë zogu me verën në sqep,
Herë si vaj bylbyli me ditën në xhep,
Herë si thirrje mali që tund shkëmb' e shkep,
Herë si fjalë e tretur që s'ka kush ta jep,
Herë si vetëtimë që tremb edhe djeg,
Herë si pllajë lulesh që të bëhet djep,
Herë si pikë uji që të ngjall nga varri,

Herë si suferinë që të hedh nga mali,
Herë si dashuri që t'i fal tre jetë,
Herë si gjuhënëpërkë që flet e të shkret,
Herë si shteg parajse mbushur plot me dritë,
Herë si derë e mbyllur përplasur tek sytë,
Herë si vatër zjarri ku mblidhen fëmijët,
Herë si rrëpirë shpati ku të thyhen brinjët,
Herë si gjeth pranvere me aromën e jetës,
Herë si rrasë varri me peshën e vdekjes...

Lumi dhe emri dhe Rini,
Na lënë e dashur,
Këtu në majmalin e mallit,
Ku pikloti shpon gurin,
Dhe ikin tutje larg në horizont,
Që shikimi ynë të mos verbohet
Që syri ynë,
Të ketë çfarë të shohë,
Që dashuria për birin,
Të ketë ku të rrojë...

Jon deti si im bir...

Puhiz' e lehtë mëngjesore,
Perden e natës largoi ngadalë,
Dhe drejt Udhës Qumështore
Ikën engjëjt krahëbardhë ...

Në të agur, në të zbardhur,
Seç u ça e qiellit cipë
Dhe një yll këmbëzbathur,
Midis nesh na solli dritë..

Midis jetës edhe vdekjes,
Përmes natës edhe ditës,
Dor'e nënës kërkon gjirin,
Si burim të qumeshtdritës..

...E nis ditën vet'i tretë,
Si askurrë në këtë jetë,
Bëj një hap e m'duken dhjetë;
Ec me këmbë a shkoj me fletë?

Ditët ikën dhe ti u rrite,
Det'i kaltër plot me valë,
Nëpër stin' e nëpër vite,
Vjen si fjal' e shkon si mall.

Jon si bir' e det si jetë,
Iliadë këngësh në Mesdhe,
Biri ynë, engjëll me fletë,
Je ti Jon, kudo që je!

Kënga labe ta freskon ballin,
Breg'më breg'e guv' më guvë,
Sa dhe dallgët'e ndalin hapin,
Melodisë t'i hapin udhë
Iso-këngët djaloshare,

Ca me fyell, ca me dyjare,
Në mëngjes malet i tundin,
Dhe në muzg ty të përkundin...

Ikën - vjen batic' zbatice,
Siç bën qengji kur pi sisë,
Vjen të puthësh këng'e brigje,
O deti me një mijë shtigje...

Det mes detesh si asnjë tjetër,
Dikton vallen e gjith' ujsisë,
Ulur mbret në fron me skeptër,
Jon shqiptar' i pellazgjisë!

Det në jet' e bir në shpirtë-
Joni që vishesh plot me dritë!
Rrotull stinët kur ven'e vijnë,
Veç ta shtojnë bukurinë!

Sa këngë e lot'e fjalë,
Derdhur mbi ty si valë,
Nga të huaj e shqiptarë,
Herë tok'e herë ndarë!

Thellë nën ujë,aty në gji
Plot sekrete i mban fshehur.
E fus kokën kur do ti,
Dhe sekretet shoh pa tretur.

Janë Odisea dhe Itaka,
Bashkë me kurthet e Çezarit,
Dhe shqiptarët që zuri nata,
Në Otranto, në mes kanalit...

Dhe anije, dhe qytete,
Dhe vullkane, dhe tërmete,
Dhe ca male majemprehta
Dhe ca shtigje majëshigjeta.

Sykaltër, sydritë, sybukur,
Në ballin e jetës qëndron,
Dhe hëna që sillet si flutur,
Fshehur diellit në ty hepon...

Pa ty fushat, malet, kodrat,
As lumenjt dhe as lëndinat,
Nuk rrinë dot pa të takuar,
Në sytë e tu - shkruar!

Të gjithë nisen drejt teje,
Përrrenj'e pllaja, pyll' e stane,
Bashkë me tufat plot me dele,
Dhe këngët e nuses çobane.

Kur të lëndojnë dhe të trazojnë,
Kur nga tërbimi dallgë ngrihesh,
Zbres si shkëmb aty në breg,
Që të biesh e të mos vritesh...

Gjoks'e zemer ku ngroh valët,
Le të mbetem unë për ty,
Gjersa toka do të ndalet,
Edhe dielli aty përmbi...

Jon & Rin

Njëri lum'e tjetri det,
Mbathur me tokë
Veshur me qiell,
Herë dritë me hënë
Herë flakë me diell,
Hyni te njëri -tjetri,
Me kra' ylberësh
Kërcime ketri
Vrapim drerësh,
Malet'e brigjet
Mbani lidhur,
Guvat dhe shtigjet,
Ngjizur..
Njëren dorë
E fus në lumë,
Tjetren dorë
e zgjas mbi det,
Që ta kap
një hënë në gjumë,
E të zë
një diell t'argjendte..

Fillesat ky album, apo më mirë të themi udhëtimi i Maurizio Bosio, i ka në muajt e parë të 1993 kur mbas njohjes së një rasti klinik në një spital në Itali vendosi të ndihmojë duke ardhur në Shqipëri.

Maurizion e solli në Shqipëri "Betimi i Hipokratit", por do ta bëjë akoma më të njohur ky album fotosh bardh e zi që risjell një Shqipëri që ngadalë po e harrojmë. Ai fiksoi përmes aparatit të tij, metamorfozën që sapo kishte filluar duke na bërë sot të vëmendshëm për dokumentimin e ndryshimit që pësuan njerëzit dhe vendi.

Udhëtimi në Shqipëri i jep mundësinë për një "ditar" fotografik pothuaj profesional. Midis momenteve të "shplodhjes" nga puna si mjek, ai fotografon. Fotografon subjektet, objektet, ngjarjet e këtij vendi dhe vëmendja e tij mbi to bën të mundur të realizojë imazhe që nuk mbeten pas nga puna e fotografëve profesionistë. Fotografia dokumentuese që ai krijon, fikson përgjithmonë situatat sociale të kohës që Shqipëria dhe njerëzit e këtij vendi po kalojnë.

Nga 1993 deri në 2017 udhëtoi në të gjithë Shqipërinë, duke i qëndruar pranë njerëzve në nevojë, duke njohur, mësuar, eksploruar e sigurisht duke fotografuar. Nuk pretendon të jetë një fotograf gazetar apo artist e aq më pak një antropolog. Thjesht fotografon ato që sheh e që për syrin e tij janë të reja, të çuditshme, të rralla, hera herës të papranueshme dhe imazh pas imazhi fillon të krijojë një panoramë të Shqipërisë, një panoramë të pasur me peizazhe, me vise jo fort të shkelura, objekte kulturi, me vende historike, portrete njerëzish, ngjarje, por mbi të gjitha mbush fotot e tij me shpirtin e këtij vendi.

Që nga koha që fotografi austriak Josef Székely, i cili thuhet se ka krijuar memorien vizuale më të hershme të viseve shqiptare, nëpërmjet fotografive të tij gjatë vjeshtës së 1863 e deri në fillim të vitit 1990, fare pak fotografë kanë mundur të hyjnë në Shqipëri për të dokumentuar. Me ndryshimin e sistemit këtë boshllëk "nxituan" ta mbushin plot fotografë të shtyrë nga kureshtja e tyre apo mediave që ata përfaqësonin. Gjithashtu çdo i huaj që patjetër kujdesej të kishte një aparat në udhëtimin e tij në Shqipëri, mbushi diçka nga ky boshllëk. Me një "sy të pa vrarë" nga ajo çka ndodhte këtu, ata panë më qartë se sa fotografët vendas, të cilët ishin mësuar me përditshmërinë dhe monotoninë vizuale. Por sado profesionist

Bardhë e zi në albumin ALBANIA të Maurizio Bosio

Nga Prof. Asc. Albes Fusha



të jesh, të dokumentosh ndryshimin, të dokumentosh kohën, të fotografosh shpirtin e njerëzve të një vendi, të duhet më shumë se sa një udhëtim. E në këtë aspekt Maurizio ka epërsi. Ai vjen me një "sy të pa vrarë" dhe jeton e fotografon gjatë këtu.

Me ndryshime kaq të mëdha në një kohë relativisht të shkurtër jo gjithçka ka shkuar mirë. Historia e dhimbshme

e para vitit 1990, nxitimi dhe trazirat e periudhës së tranzicionit, transmetuan papërgjegjshmërinë dhe në një farë mënyre ndikuan në shkatërrimin e konsiderueshëm të kulturës materiale po ashtu edhe në mjegullimin e kujtesës kolektive. Një nga elementet që është cënuar nga ky "nxitim" është fakti që trashëgimia historike kulturore nuk ka patur vëmendjen e duhur për tu ruajtur apo servitur si pjesë e vlerave tona. Maurizio me kuriozitetin, pasionin,

interesin për historinë e këtij vendi dhe me aparatit e tij modest, e ngacmon këtë çështje duke e dokumentuar dhe duke na bërë të jemi të vëmendshëm sepse po pësojmë humbje të pakthyeshme. Fotografon afreske të dëmtuara nga periudha ateiste, fotografon objekte kulturi, fotografon plazhe që po pushtohen nga ndërtime, fotografon qytete që po mbulohen nga absurdi i zgjerimeve, fotografon për të krijuar memorie, shpreh keqardhje për diçka të pakthyeshme.

Fotografitë e këtij albumi na tregojnë se është njohës i teknikës fotografike, i shfrytëzimit në maksimum të mundësive deri në limit të aparatit apo elementeve të kompozimit, njohës i mirë i dritës, por përtej kësaj është edhe njohës i situatës emocionale, i atij çastit magjik të quajtur "momenti decisiv" ku elementet fizikë dhe emocionalë bashkohen për të transmetuar dhe thënë më shumë.

Libri i Maurizio është një ftesë që të shikosh e të ndjesh përtej asaj që ju ofrohet turistëve, është një ftesë për një udhëtim më të thellë në kohë, në ndryshime, në vende, në shpirtin e shqiptarëve. Në një farë mënyre Maurizio më sjell në mendje fotografët e "National Geographic" që kanë të njëjtin synim.

Vite pune e përkushtimi si mjek, si udhëtar dhe si fotograf më kujton gjithashtu përpjekjen madhore të fotografeve të FSA¹ në Amerikë që me përkushtim dokumentuan jetën e popullit amerikan gjatë viteve të vështira të 1935-'43, një përpjekje që u konkretizua në projektin më të madh dokumentues në historinë e fotografisë.

Nuk mund të rri pa përmendur fotografin kanadez **Ted Grant** i cili thotë:

Kur fotografoni me ngjyra ju fotografoni sipërfaqen, rrobat, kur fotografoni bardh e zi ju fotografoni shpirtin.

Nga biseda me Maurizion më pëlqeu fakti se është pikërisht elementi bardh e zi që e drejton vëmendjen e shikuesit për të parë përtej sipërfaqes, për të parë pikërisht shpirtin e Shqipërisë dhe shqiptarëve të këtyre viteve.

Faleminderit Maurizio!

1 Agjenci e themeluar nga Presidenti Franklin Roosevelt: (FSA). Administrata e Sigurisë së Fermës. Midis 1935 dhe 1943 fotografët e FSA-së prodhuan rreth tetëdhjetë mijë fotografi nga jeta në Amerikën e epokës së depresionit.



Në tregimet, *Shkrimi i zotit*, *Lotaria e Babilonit* dhe *Rrënojat qarkore* mund të bëjmë një përshkallëzim prej hapjes së zotit, konceptit të zotit, si tërësi e konceptueshme në një shkrim, pastaj në *Lotarinë e Babilonit* totalja e qëniesimit kalon në lojë, në të vërtetë dhuna kalon në lojë dhe kjo kalon në lotari, dhe në këtë rastësia brenda kësaj totaleje bëhet burim i shpjegimit qoftë të omnipotencës e qoftë të krimit më të zakonshëm. Kështu duke arritur tek tregimi Rrënojat qarkore, ku e tëra ndodh në një segment ëndëror, në një ëndërr e cila është e lindur nga ëndrra paraprake.

Shkrimi i zotit është një kah i pambarimtë; *Lotaria e Babilonit* është vetë totalja e kaosit mbi të cilin thuret besimi dhe shndërrohet vetë kaosi; dhe në *Rrënojat qarkore* njeriu sikur bie në ndërmjetësinë e ëndërores përkrah zjarrit, ky si zot e shkatërrim.

Në të vërtetë këto janë tri strata Borgesiane, fillohet me atë të pambarimësisë, e kjo me njeriun e shtjelluar brenda këtij trupi, strata e shoqërores si lotari, e kjo si totale e pazotërueshme, dhe strata e ndërmjetësisë ku e tëra lind si ëndërr, duke pas qenë e shkatërruar një herë, dhe e tëra shkatërrrohet po ashtu duke qenë ëndërr.

Tri stratat Borgesiane të zgjedhura këtu hapin atë që është në konceptet e këtyre fenomeneve, dhe i tejshkujnë deri në zanafillën e lindjes së tyre: pambarimësisë së zotit; rastësisë së dhunës dhe me këtë pashpjegueshmërinë e saj; dhe rëniën e njeriut në ndërmjetësinë e shkatërrimit që është në duart e tij. Por kjo e fundit në të vërtetë, krijon imazhin e pafundësisë së ëndrës pikërisht si ëndërr për tjetrin duke qenë vetë i ëndërruar.

Shkrimi i zotit

Në tregimin *Shkrimi i zotit* ka konstruksione krejtësisht të pabesueshme dhe në të njëjtën kohë të pakapshme nga zakonshmëria e jetës. Në këtë tregim njeriu është i izoluar në një burg të cilin e ndanë me një jaguar. Njeriu "i shtyer nga fataliteti për të bërë diçka" jepet të rikujtoj tërë atë që di. Sipas traditës mbi zotin, ai rikujton zotin i cili ka parashikuar që në fund të kohëve do të ketë dëshpërim dhe shkatërrim, dhe se pikërisht për këtë zoti në ditën e parë të krijimit ka shkruar fjalinë magjike me fuqinë e saj për të shthurur këto ligësi. Dhe se zoti e kishte shkruar fjalinë që të arrinte gjeneratat më të largëta dhe që të mos mbetet çështje e rastësisë. Por problemi është se çdonjëri prej simboleve në tokë mund të jetë vetë fjalja.

Ky vërshim në të cilin Borges/njeriu/personazhi kërkon zotin fillon kështu:

1. "Një natë ëndërrova se aty ishte një kokërr zalli në dyshtemënë e qelisë ... ato vazhduan dhe u shumuan derisa e mbushën burgun dhe pata mbetur duke vdekur përfund kësaj hemisfere të zallit. Kuptova se isha duke ëndërruar: me një përpjekje të rëndë e ngrita veten dhe u zgjova. Dikush më tha: ti nuk je zgjuar në zgjim; por në një ëndërr paraprake. Kjo ëndërr është e mbyllur brenda një tjetre, dhe kështu me radhë në pambarim, që është vetë numri i kokrave të zallit. Shtegu që duhesh rigjetur është i pandërprerë dhe ti do të vdesësh para se të zgjohesh në të vërtetë."

Pastaj i njëjti vërshim përhapet në gjuhën e njeriut:


2. "Morra në konsiderim se edhe në gjuhët e njeriut nuk ka një të dhënë që nuk e përfshinë tërë universin; të thuash tigër është të thuash tigr që e ka lindur, kaprojtë dhe breshkat që i ka ngrënë, bari ku janë ushqyer kaprojtë, toka që ishte nëna e barit, hyjnia që i ka dhënë jetë tokës."

Më tutje ky vërshim kalon në një mekanizëm

3. "Pashë një rrotë skajshmërisht të lartë, ajo ishte e pafundme. Gjëra të

MBI TRI TREGIME TË BORGES-IT

Nga Ballsor Hoxha



pambarim ishin të ndërlidhura, gjëra që ishin, janë dhe do të jenë."

Gjë që përfundon si një shprehje, e papërpunuar dhe e pakapshme:

4. "Është formulë prejkatërmëdhjetë fjalëve ... por unë e di se kurrë nuk do t'i shprehi ato fjalë, sepse më nuk e mbaj mend Tzinacan-in (paraardhësin)."

Secili vizion në këtë tregim është sikur një vërshim i valëzuar. Është një kokërr zall që përmban të gjitha të tjerat, apo të gjitha së bashku, por të pandara. Nga kjo mund të përkufizojmë se Borges e dekripton Shkrimin e zotit si një shpirt, një valë, një zinxhirë i pandashëm. Por në të vërtetë këtu pyetja është nëse Borges tenton të bëjë këtë, të përkufizoj një dije për zotin, apo të bëjë të kundërtën, pra të jep një fund, një qark, një pamundësi ikjeje (pikërisht arsyeja pse personazhi gjendet në burg), apo të përmbyllë qarkun e paikshëm të kësaj bote.

Në këtë qark nuk ka një distancë, apo binarë, paralel të cilët mundësojnë vëzhgimin apo edhe përballjen e reflektimit e tokës ndaras prej saj. Aq më shumë njeriu është një "fije përkundër fijos së armikut të tij". Gjë që na a kujton jaguarin në anën tjetër të qelisë, ndarje e cila shtynë kah bashkimi në fund të fundit. Apo, jaguari është model i (pa)mundësisë së ndarjes së jo vetëm simboleve por edhe shprehjeve në dhe të tokës.

Pra ka dy vëzhgime në këtë, ai i pambaruëshmërisë së shprehjes së zotit; dhe ai i pandashmërisë së shprehjes së zotit.

Në pambaruëshmërinë e shprehjes njeriu "do të vdes para se të zgjohet", duke qenë se e tëra është një trup, një nënë tokë, apo një rrokullimë e cila përmbledh në vete tërë atë që lind dhe është në të dhe prej saj. Qoftë edhe nëse burgu dhe qelia ku gjendet njeriu është pika e fundimit të kësaj shprehjeje të zotit, ajo tërheqë brenda saj tërë vërshimin dhe nëpër të parakalon tërë ajo që është, apo thënë më saktë ajo që rrokulliset. Gjë që e bën shprehjen e zotit një fluks në të cilin edhe shpërfaqen të gjitha por edhe zhvillohen në të njëjtën kohë. Dhe nga këtu e bën të pamundshme qoftë distancën dhe qoftë ndalimin për të – lexuar – shprehjen e zotit.

Pandashmëria, apo fjalja prej katërmëdhjetë fjalëve është vetë rastësia që tenton kah zberthimi dhe në të njëjtën kohë është pjesë e po këtij vërshimi. Borges në këtë e zgjedh një formulë fiktive: fjali prej

katërmëdhjetë fjalëve për të krijuar edhe të magjishmen në të cilën njeriu shpreson, por edhe për të krijuar një segment brenda – përkujtimin -, e kjo si krisje nëpër vërshimin e hapjes, depresionit të këtij vërshimi duke e bërë të mundshme një karakteristikë njerëzore në këtë vërshim, i cili megjithatë është i pamundshëm.

E pambarimta dhe e pandashmja këtu qoftë e emëruar si skripta e zotit, qoftë si fjalja katërmëdhjetë fjalëshe janë hapja e rruzullimit si pakthyeshmëri, kah, drejt përtej vetes së saj, dhe zinxhir që lind njëra tjetrën. Në fund, fjalja "ti do të vdesësh para se të zgjohesh" është pamundësia e kalimit, gjithmonë një ëndërr prapa, gjithmonë një fjalë prapa, gjithmonë një botë paraprake. Bota është pikërisht skriptë ku çdokund mund të lexosh të zotshmen, dhe ëndërr ku nuk arrihet asnjëherë mbizotërimi i pikërisht asaj që e lexon.

Lotaria e babilonit

Ajo që ndodh në këtë tregim të Borges është shpërfaqja e lindjes së dhunës, dhe aq më shumë ndëshkimit, dhe më tutje kalimi i saj në lotari.

Ka shumë ironi në këtë tregim, apo thënë saktë zbulesë të historisë, si lind e krijohet ajo. Derisa lind lotaria ajo është marrëveshje e zbulimit të karakterit dhe të ritmit të rastësisë. Mirëpo, më vonë, dhe më tutje në hapjen e saj të varfërit, paradoksalisht, arrijnë të kryengriten për t'u përfshirë brenda kësaj dhune e ndëshkimit. Aq më shumë që Lotaria të përfshijë tërë Babiloninë (njerëzimin).

Gjithnjë besimi në këtë lotari i dorëzohet të ashtuquajturës Kompanisë, e cila nuk figuron në asnjë dokument se kush është, dhe aq më shumë nuk ka një fytyrë. Në të vërtetë, derisa e tëra fillon nga tepria dhe organizimi i lojërave, Kompania herë përhapet dhe herë shuhet pikërisht me përhapjen e lotarisë.

Në të vërtetë Kompania arrin përhapjen e saj deri në omnipotencë, omnipotencë të barabratë me zotin. Me ç'rast lind problemi i fatit dhe rastësisë, apo në të vërtetë lind vetë rastësia.

Është mënyra se si lind subjektivizimi i dhunës, jo vetëm asaj shtetërore, por edhe asaj popullore/shoqërore. Sa më shumë përhapet fjala e lotarisë, aq më shumë interpretimi i dhunës kalon në

emër të Kompanisë, e Kompania aq më e përhapur, aq më omnipotente, pikërisht në pamundësinë e shpjegimit të vetë lotarisë.

"Unë vij nga nja vend i turbulluar ku lotaria është baza e realitetit", tregon narratori. Gjë që do të thotë Lotaria ka përfshirë tërë masat e njerëzimit dhe në këtë ka ndodhur një lëkundje e njerëzimit, gjë që duke dashur t'i ikë dhunës, ajo në të vërtetë ka hyrë në një dhunë të merituar, me gjithë paradoksin.

Por këtu në fillimet e lotarisë përhapet bashkë me atë edhe çështja e moralit. Sepse rastësia nuk përputhet me shpërblimin, por me ndëshkimin. Shumë më vonë lotaria arrin kapitalin e rëndësisë së saj, kështu Lotaria duke kaluar në elemente jo monetare.

Por me këtë rrënohet balansi i shoqërores dhe kolektivi arrin në kaos ku vetëm Kompania ka një të drejtë, që është ndëshkimi i pjesëmarrësve në lotari, e lotaria është kudo dhe kurdo e përhapur në kolektiv.

Kështu Lotaria bëhet, apo shpjegohet si ndërthurje e rastësisë në rendin e botës dhe se pranimit i gabimit nuk bie në kundërshtim me rastësinë, gjë që në të vërtetë e përhumbarancën zyrtare të lotarisë.

"Kompania shmang çdo publicitet... Ëndërruesi i cili zgjohet rastësisht dhe e ngulfat gruan që flenë në krevatin e tij, a nuk e ekzekuton, ndoshta, një vendim sekret të Kompanisë..., këto janë disa nga shpjegimet. Omnipotencia e Kompanisë arrin deri në uzurpimin e cicërimës së zogut, dhe në hijen e ndryshkut e të pluhurit, dhe në ëndrrat e agimit. Por në të vërtetë Lotaria e Babilonit është asgjë tjetër përpos një lojë e pafundme e rastësisë.

Në këtë mrekulli të Borges në të vërtetë, si në të shumtën e tregimeve të tij jemi në botën e cila lind vetveten, nga pushteti i Kompanisë, arrihet në manipulimin e dhunës, dhuna lind rastësinë (paradoksalisht edhe rastësia bëhet dhunë) dhe në fund çdo gjë harrohet dhe mbetet vetëm kolektivi nën transin e kaosit të shkakuar nga dhuna.

Rrënojat qarkore

Në këtë tregim Borges krijon një segment, ndërmjetësi të qëniesimit. Njeriu është përkundër zjarrit, në të vërtetë zotit zjarr, apo njeriu është ndanë zjarrit. Por nuk ekziston, as realiteti dhe as qenia si e njohim. Ka vetëm debris, rrënojë të njerëzimit, i cili ëndërr pas ëndrre, jo që nuk jeton, por krijon tjetrin duke ëndërruar, pra përmes ëndrës.

Njeriu është në ikje të vazhdueshme. Është në lëvizje konstante. Është i pahistori dhe i paardhmëri. Njeriu ëndërron njeriun, dhe e tëra është një zinxhirë ëndrrash që lindin njëra tjetrën.

Njeriu është vazhdimisht njeriu i fundit. Sikur e tëra është rrënuar dhe ëndrra e njeriut për njeriun tejshkon këto rrënoja.

Por pse, kjo ëndërr, ky ëndërrim, kjo ikje, dhe ahistori. Në zjarrin e gërmadhëve e tempujve dhe qyteteve, ka mbetur një gjurmë zjari dhe një rrënojë e flakëruar. Dhe është pikërisht këtu ku lind ëndrra, ëndrra për tjetrin, aq më shumë ëndrra e atij që ëndërrohet. Sigurisht ky është dëshpërimi i kalimit të njerëzores nga qenia në ëndërrën e saj.

Por në të vërtetë zjari në shkatërrimin e tij tërheqë ëndërrën, si reflektim i flakadanëve, shkatërrimit, dezintegritimit. Ky njeri i kallur, i cili është në ikje konstante, dhe me këtë në zhbërje konstante, mu sikur ëndrra, është pikërisht xixa e zjarreve të tempujve të djegur.

Në të vërtetë është paradoks Borgesian, derisa zjari e lind ëndërrën/jetën dhe njeriun brenda, ai nuk e kallë atë. Dhe është pikërisht moskallja që e lë njeriun jashtë reales, në ëndërrorë, në pamundësinë e jetës.

Vendbanimi prehistorik i Kamnikut Jugperëndimore të Kolonjës. Vendin kryesor në këtë formacion gjeografik e zenë shpatet e kodrave në drejtim Lindje-Perëndim, 10 km gjatësi, të veshura me drurë halorë, dukshk e shkozë me kullota alpine. Në relievin e kësaj malësie spikatin pllajat karstike të Podës, Shalësit e Barmashit.

Burimet me ujë të bollshëm, që dalin përfund fshatit Podë, Barmash e Kamnik, së bashku me ujrën e përrenjve, që zbrasin nga shpatet e kodrave, formojnë luginën e sipërme të lumit Langaricë, që bashkohet me lumin Vjosë pranë fshatit Petran të Përmetit.

Kushtet klimaterike, pyjet e kullotat alpine, pllajat me toka të përshtashme për bujqësi e vreshtari, së bashku me luginat e përrenjve e lumin Langaricë dhe qafave lehtësisht të kalueshme, përgjatë rrugë-kalimeve lindje-perëndim e veri-jug, kanë favorizuar jetesën njerëzore që herët në epokën prehistorike (Fig. 1).

Brenda këtij terreni janë lokalizuar, në vitet 1965-1966 disa vendbanime të hapura e shpellore dhe të fortifikuara me mure, të kohëve të ndryshme. Vendin kryesor e përfaqëson Vendbanimi i Kamnikut, i cili ndodhet në një kodër shkëmbore, me lartësi 1200 m mbi nivelin e detit. Kodra ka drejtimin lindje-perëndim dhe përbëhet prej dy kreshtave, që lartësohen pranë fshatit Kamnik. Shpatet jugore zbrasin me pjerrësi të pakalueshme mbi përroin e Barmashit, kurse nga veriu ka disa shkallëzime terracore, të njohur nga vendasit "Livadhet e Qytesë".

Gjatë këtyre survejimeve, janë konstatuar linjat e mureve të një kalaje prehistorike ilire, që ruhen pjesërisht mbi sipërfaqe dhe shumë fragmente qeramike të Bronzit të vonë, epokës së Hekurit, e sidomos të periudhës Qytetare Ilire. Midis këtyre gjetjeve kemi veçuar një buzë pitosi, të stampuar me emrin e mirënjohur Amynt, që i përket një pronari punishte të shek. IV-III p.Kr.

Në shpatet jugore ndodhet gjithashtu, hyrja e një shpelle karstike, e njohur nga vendasit me emrin "Guvë", me përmasa 30 m gjatësi, 2-3 m gjerësi dhe 5-6 m lartësi. Gjatë kontrolleve tona në këtë shpellë, janë gjetur fragmente qeramike të Bronzit të vonë dhe Hekurit të hershëm. Në kreshtën më të lartë të kodrës "Shkëmbi i Kamnikut" ruhen rrënojat e një kulle të Antikitetit të vonë të shek. V-VI m.Kr (Fig. 2).

Gërmimet e para arkeologjike në këtë vendbanim prehistorik, u ndërmorën në vitin 1968 (Aliu, St. Hist.1, 1969, f. 159-163). Gjatë kësaj fushate u gërmuan katër kuadrate, me përmasa 5 x 5 m, që arritën deri në thellësinë 2.20 m nga sipërfaqja. Në shtresat kulturore të këtyre kuadrateve u zbuluan materiale të shumta qeramike, vegla pune prej stralli, guri, kocke e briri, të datuara kryesisht në epokën e Neolitit të vonë e më rrallë të epokës Eneolitike, të ngjashme me ato të zbuluara në vendbanimin Neo-Eneolitik të Maliqit (Prendi St. Alb.1966/1, Tab. 2) dhe vendbanimin shpellor të Trenit (Korkuti "Iliria"1, 1971, f. 31-47).

Në tabanin fillestar shkëmbor, në përfundim të kësaj fushate gërmimesh në Kamnik (1968), u zbulua një linjë me gurë, të vendosur grumbull njeri mbi tjetrin, me gjerësi 1.70 m në taban dhe 0.40 m lartësi, që paraqet konstruksionin më të hershëm prej gurësh, me karakter tarracimi (Fig. 3).

Në fushatën e dytë të gërmimeve në vitin 1969, u gërmuan 6 kuadrate me përmasa 5 x 5 m, por që u ndërpre punimet në thellësi të ndryshme, për të sqaruar katër

Furrat e qeramikës dhe objektet e kultit në vendbanimin prehistorik të Kamnikut në Kolonjë

Prof. emeritus Skënder Aliu

komplekse furrash, që përmbanin nga 4-5 enë qeramike për çdo furrë (Aliu; Jubani Bul. Ark. 1969, f. 1-13).

Gjatë gërmimeve përfundimtare të vitit 1970, u gërmuan tre kuadrate të rrinj me përmasa 5 x 5 m dhe përfunduan gërmimet e papërfunduara të vitit 1969 (Prendi; Aliu, "Iliria" 1, 1971, f. 13-30).

Në përfundim të gërmimeve tre vjeçare në vendbanimin prehistorik të Kamnikut, u zbuluan mijëra fragmente qeramike, si dhe rreth 60 enë të plota, që u gjetën të vendosura brenda furrave. Në nivele të ndryshme të shtresave kulturore neo-eneolitike të Kamnikut, u zbuluan me shumicë vegla pune prej stralli, guri, kocke e briri, mokra e kokra gruri të karbonizuara, etj.

Në vështrim të përgjithshëm, elementet më të rëndësishme të zbuluar në Kamnik të Kolonjës, me vlera të rralla unikale, të panjohura brenda vendit tonë e më gjerë, përfaqësohen nga pesë komplekse furrash, nga të cilat 16 prej tyre përmbanin 5-6 enë secila, që së bashku me objektet e kultit, përbëjnë objektin e kësaj kumtese.

FURRAT

Në vështrim të përgjithshëm ato janë ndërtuar, në nivelin më të hershëm kronologjik, të datuara pamëdyshje në Neolit të vonë, mijëvjeçari IV-III p.Kr. Fillimisht është ndërtuar një platformë me gurë të mëdhenj, mbi të cilën janë hedhur gurë të vegjël, për ta niveluar. Mbi këtë xokolaturë gurësh, është hedhur një shtresë dheu argjilor i pastër, i ngjeshur mirë, që nga pjekja është shndërruar në një shtresë kompakte e lustruar.

Kubetë e këtyre furrave, janë ndërtuar, prej një skeleti të thurur me thupra druri të hollë, ndryshe nga ato të vendbanimit të Maliqit, që ishin të thurura me kallama (Prendi St. Alb. 1, 1966, Tab. 2). Mbi skelletin e thurur me thupra dhe të mbushur brenda me kashtë gruri, është hedhur një shtresë argjili e pastër, e njomur dhe e përzier me byk, me qëllim që brumi të bëhej sa më rezistent. Në përfundim të këtij procesi, furra ndizej dhe në kontakt me zjarrin, lënda e drunjë digjej nga brenda. Gjurmët e thuprave duken qartësisht nga paretet e furrave, që ruhen pjesërisht me trashësi nga 6-12 cm. Në periferi të kubesë ruhen edhe gjurmët e hunjve (drurë të trashë), që kanë konsoliduar kubën me tabanin e furrës dhe kanë shërbyer njëkohësisht, si brima



për daljen e tymit.

Përmasat e furrave kanë qenë të ndryshme, në varësi të numrit dhe përmasave të enëve të vendosura për t'u pjekur. Kështu furra e zbuluar në fushatën e parë të gërmimeve (1968), me diametër 2 m, përmbante brenda 6 enë të plota.

Në fushatën e dytë të gërmimeve, u zbuluan katër komplekse me furra me përmasa: A. 3. 10 x 2. 60 m, me tre furra pranë njëra-tjetrës; B. 2. 90 x 2. 20 m, me tre furra; C. 2. 50 x 1. 50 m, me dy furra; D. 3 x 1. 20 m, me dy furra. Në njërin nga këto furra, u gjetën brenda pesë enë të plota (Fig. 4).

Furra me konstruksione ndërtimi dhe përmasa si këto të Kamnikut, janë konstatuar edhe në vendbanimin neo-eneolitik të Maliqit, me ndryshimin, që në Maliq në vend të thuprave prej druri, është përdorur kallami (Prendi St. Alb. 1, 1966, tab. 2).

Me shumë interes është një kompleks me pesë furra, që u zbulua në fushatën e tretë të gërmimeve në Kamnik 1970.

Në nivelin më të hershëm të kuadrateve: XXIII, XXIV, XXV, u zbuluan gjurmët e pesë furrave, të vendosura në dy rreshta paralele, me hyrje nga veriu. (Fig. 5). Dy nga këto furra kanë planimetri gjysmë vezake, me përmasa 1.50 x 1.10 m dhe 1.90 x 1.5 m. Tre furrat e tjera janë katërkëndëshe dhe kanë përmasa të barabarta 1 x 1 m. Të gjitha së bashku janë me mure ndarës të përbashkët, të rrethuar anash me një bordurë balte të pjekur, me lartësi 17 cm. Në mesin e dy rreshtave të këtyre furrave, gjendej një vatër me përmasa 1.28 x 0.60 m, që duhet të ketë shërbyer për grumbullimin e hirit në përfundim të zjarrit, ose për vendosjen e enëve prej qeramike para ose pas pjekjes.

Është me interes të theksojmë se ky

kompleks furrash, të vendosura në rreshta me mure të përbashkët ndarës, provon qartësisht se ato kanë funksionuar në të njëjtën kohë, por është vështirë të thuhet me saktësi.

Ajo që paraqet interes dhe meriton të provohet me gërmime në të ardhmen, ka të bëjë, nëse ato kanë funksionuar të gjitha në një kohë për pjekje, apo njëra prej furrave midis tyre, mund të ketë shërbyer për tharjen e enëve. Ky problem mbart vlera të rëndësishme, se ka të ngjarë të lidhet me "shtëpi punishte" për prodhimin e qeramikës në Kamnik.

Gjithsesi, ky mendim përforcohet, po të sjellim në vëmendje se brenda 16 furrave të zbuluara në Kamnik (1968-1970), u gjetën rreth 60 enë të plota. Ato shquhen për përsosmërinë në modelimin e larmishëm të formave dhe të zbulimit me motive gjeometrike e spirallike, me vlera të rralla e unikale, të realizuara nga poçarët artistë të vërtetë të Kamnikut. Sipas mendimit të shprehur që herët nga arkeologët shqiptarë e të huaj, këto dukuri presupozojnë ekzistencën e prodhimit "zejtari" të qeramikës. Sigurisht kjo përbën një dukuri të panjohur brenda vendit tonë e më gjerë, që kërkon të argumentohet me gërmime të tjera në të ardhmen (Prendi, Aliu, "Iliria" 1, 1971, f. 28).

OBJEKTET E KULTIT

Në vendbanimin prehistorik të Kamnikut, janë zbuluar një grup objektesh me karakter kulturi, religjioz botkuptimor. Ndonëse numerikisht të kufizuara, ato mbartin vlera të rëndësishme, për t'u njohur me botën shpirtërore të një bashkësie sociale, që në kuptimin historik, përkon me organizimin e shoqërisë matrikale dhe me rolin, që zinte gruaja në epokën Neo-eneolitike.

Këto kategori gjetesh të zbuluara në Kamnik, ndryshojnë nga njëra-tjetra, nga mënyra e modelimit, që lidhen ngushtë me atributet simbolike. Në këtë grup, bëjnë pjesë disa enë në trajtë buste grash, enë në trajtë vazo kambane, me dy sfera sipër, "altare", me forma krejt origjinale, e të panjohura nga kulturat bashkëkohore brenda vendit tonë e më gjerë. Në Kamnik janë zbuluar gjithashtu, disa figurina antropomorfe e zeomorfe, disa këmbë të larta enësh, me forma të papërcaktuara, si dhe disa stoli prej balte të pjekur, ose dhëmbë derri të egër dhe prej midhje, që kanë shërbyer si stoli me karakter kulturi.




1. **Enë antropomorfe**, e cila është e ruajtur plotësisht, paraqet torsin e një gruaje 16 cm lartësi; 10.5 cm gjerësi në shpatulla dhe 5 cm diametër i grykës (Tab. I, 1)

Ajo është e përgatitur prej argjili të pastër, me sipërfaqe të veshur me ajkë balte, me ngjyrë kremi dhe është zbuluar me motivin e telave me gjemba, me ngjyrë kafe në të gjithë sipërfaqen. Ajo paraqet torsin e një gruaje me krahë të cunguar, qafë të gjatë cilindrike, me kokë në formë çallme, me dy thimtha konikë të tejshpuar vertikalisht, që kanë shërbyer për t'u varur në fije, brenda ambjentit të një banese.

Mbi gjoksin e kësaj figurine, ka dy thimtha konikë, që paraqesin gjinjë e gruas. Mënyra e modelimit të përsosur e torsit, cilësia e brumit të qeramikës, si dhe motivet e zbulimit me ngjyrë kafe mbi sfondin okër të çelur, e prezantojnë këtë figurinë, si një vepër arti të vërtetë, të realizuar nga poçarët artistë të Kamnikut (është ekspozuar në Muzeun Kombëtar Tiranë, me Nr. inventari 1065).



Kamnik, Neoliti i vonë
Vazo e pikturuar me motive spirallike



2. Enë antropomorfe, është e përgatitur prej argjili të përzir me pak rërë të imët. Sipërfaqja është e lyster me ajkë balte, përgjithësisht e lëmuar, me ngjyrë të zezë me shkëlqim (Tab. I, 2). Kjo figurë paraqet bustin e një gruaje, me krahë të cunguar, qafë cilindrike 6.5 cm të gjatë, me gjerësi 10 cm në shpatulla, me dy thimtha konikë mbi gjoks, që simbolizojnë gjinj të egruas si dhe me kokën çallmë, por e dëmtuar pjesërisht. Figurina është zbuluar ndryshe nga e para, me pastë të bardhë, me shirita që ruhen pjesërisht mbi sipërfaqe (është ekspozuar në Muzeun Arkeologjik të Institutit Arkeologjik Tiranë).

Në grupin e enëve me karakter botkuptimor e religjioz, të zbuluar në vendbanimin e Kamnikut, bëjnë pjesë edhe dy enë në trajtë vazokambanë.

1. Ena e parë, që ruhet afërsisht e plotë, është e formës vazokambanë 33.3 cm lartësi, 30 cm diametri i grykës dhe 14 cm diametri i sipërm. Ena ka në pjesën e sipërme anash, përballë njëra-tjetrës dy sfera me diameter 9.7 dhe 9.2 cm (Tab. II, 1). Kjo enë e tipit altar kulti është përgatitur prej argjili të pastër. Sipërfaqja e saj është e veshur me një cipë ngjyrë okër, me shkëlqim dhe e zbuluar me tufa vijash të valëzuara me ngjyrë kafe të çelur, njësoj si të gjitha enët e grupit të pikturuar, të zbuluar në shtresimin e parë të furrave të zbuluara në Kamnik.

2. Ena e dytë e tipit vazokambanë, është 32 cm e lartë, 23 cm diametri i grykës dhe 14 cm diametri i sipërm (Tab. II, 2).

Në sipërfaqen e sheshtë lart, ruhen vetëm rrënjët e dy sferave që i mungojnë. E gjithë sipërfaqja është e veshur me një cipë me shkëlqim ngjyrë okër dhe është e zbuluar me shirita të mbushur me vija të valëzuara, që krijojnë motivin e shkronjës "S", në të njëjtën mënyrë me grupin e qeramikës së pikturuar. Të dy këto enë të tipit vazokambanë janë ekspozuar në Muzeun Kombëtar në Tiranë, me Nr inventari 1056 dhe 1066.

Figurina antropomorfe. Numri i tyre është i kufizuar dhe në të gjitha rastet ruhen pjesërisht. Vendin e parë e ze në këtë grup një bust gruaje me të dy duart të mbledhura grusht, të palosura mbi bark, me dy thimtha konike mbi gjoks. Ruhet pjesërisht qafa, i mungon koka dhe gjymtyrët e poshtme (Tab. III, 1).

Figurina e dytë është një tors i një gruaje, e cila ka të incizuar në pjesën e poshtme të barkut një trekëndësh (Tab. III, 2).

Këto figurina janë të punuara prej argjili të pastër, kanë sipërfaqe të lustruar me ngjyrë të murme dhe janë shumë të ngjashme me figurinat e Neolitit të vonë, të zbuluara në vendbanimin prehistorik të Maliqit, në pellgun e Korçës (Prendi St. Alb. I, 1966, Tab X a). Në grupin e figurinave antropomorfe të zbuluara në Kamnik bëjnë pjesë gjithashtu, disa këmbë vazosh kulti të papërcaktuara, një putër këmbë dhe një dorë të modeluara bukur, si dhe disa tavolina kulti të fragmentuara, një enë e tipit furrë, që ruhet e plotë, e cila është ekspozuar së bashku me enët e tjera të kultit, në të njëjtën vitrinë në Muzeun Kombëtar në Tiranë.

Figurina zeomorfe. Përfaqësohen nga dy copë gjithsej, prej të cilave ruhen vetëm kokat me sqep, që nuk mundësojnë, për të përcaktuar llojin e shpendëve që simbolizojnë (Tab. III 3, 4). Figurina kafshësh ose shpendësh, afërsisht si këto të Kamnikut, janë bërë të njohura nga zbulimet në vendbanimet neo-eneolitike të pellgut të Korçës, e më gjerë në vendin tonë.

Stoli me karakter kulti. Në nivele të ndryshme të shtresave kulturore në Kamnik, janë zbuluar disa stoli të ndryshme. Në këtë grup bëjnë pjesë: -Një rruazë balte sferike e tejshpuar (Tab. III, 5); Një midhje deti e tejshpuar (Tab III, 6). Në këtë grup janë përfaqësuar gjithashtu dhe tre copë dhembë derri të egër të tejshpuar (Tab. III, 7, 8, 9). Në të gjitha rastet këto lloj stoli të tejshpuara, kanë qenë të futura në fije dhe janë përdorur nga gratë si "amuleta" të varura në qafë, për t'i mbrojtur ato nga fatkeqësitë dhe për t'u sjellë fat e mirësi (Stipçeviq 2002, f. 360).

Nëpërmjet studimit të profileve të kuadrateve I, II, IX, X, të gërmuar në vitin 1968 (S. Aliu, St. Hist. Nr.1, 1969, f. 159) dhe kuadrateve XI, XII, XIII, XIV, XV e XVI, të gërmuar në vitin 1969 (Aliu, Jubani Bul. Ark. Nr 2, f. 1), së bashku me profilet e kuadrateve XIX, XX e XXXIV, të gërmuar në vitin 1970 (Prendi, Aliu, Iliria 1, 1971, f. 13), rezultoi se të pesë grupet e furrave të zbuluara në Kamnik, i përkasin tërësisht Neolitit të vonë, mijëvjeçarit të IV- III p.Kr. Të kësaj kohe janë dhe njëra nga enët antropomorfe, së bashku me dy enët vazokambanë të zbuluara me pikturim me motive tipike, të përdorura për pikturimin e enëve të plota, të zbuluara brenda 16 furrave në vendbanimin e Kamnikut. Në këtë kuptim, kemi parasysh horizontin e parë e të dytë të furrave, të cilat u zbuluan në shtresën e parë kulturore, në thellësinë 2.20 m nga sipërfaqja dhe deri në thellësinë 1.20 m, ku fillon shtresa e dytë e epokës Eneolitike, e cila arrin deri në 1 m trashësi. Duke pasur parasysh tërësinë e kategorive të ndryshme të kësaj shtrese kulturore, qeramikën, veglat e punës prej stralli, guri, kocke e briri, e sidomos komplekset e furrave të mbushura me enë, apo ato të prishura me përmbajtje hiri, thëngjilli, zgjyre dhe skarçitete, krijohet bindja e plotë, se në këtë qendër ka banuar një bashkësi sociale, e cila kishte në qendër të aktivitetit të saj, veprimtarinë prodhuese të qeramikës. Grupi i qeramikës së pikturuar të Kamnikut të zbuluar në këto furra, shquhet për modelimin e përsosur e të larmishëm të formave, për vizatimet e sakta dhe kompozimin e motiveve e të ngjyrave të admirueshme, njëra nga të cilat është dhe një enë e importuar nga Dimini klasik. (Tab. IV). Përgjithësisht qeramika e Kamnikut, i tejkalon kufijtë e prodhimit shtëpiak me dorë. Janë këto dukuri të marra së bashku të panjohura nga kulturat bashkëkohore, që na ndihmojnë për të shprehur mendimin, se këtu kemi të bëjmë me një prodhim zejtar, të realizuar në shtëpi punishte, nëpërmjet mjeteve të ndryshme teknike. Ky mendim përforcohet dhe me kontekstin e furrave të vendosura në rreshta, me mure të përbashkët ndarës, të cilat i përmendim më sipër. Ato duhet të kenë qënë në funksion të këtyre punishteve shtëpiake. Sigurisht që kjo kërkon domosdoshmërisht të provohet me gërmime të tjera në të ardhmen.

Në vështrim të përgjithshëm këto dukuri pasurojnë ndjeshëm, jo vetëm kulturën e Neolitit të vonë të vendbanimit shumë shtresor të Maliqit, të fazës ML Ia (Prendi Iliria VI, 1976, f. 35), por edhe ato të vendbanimeve bashkëkohore të zbuluara në Shqipëri (Korkuti 2010, f. 193-216).

Nga sa prezantuar më sipër rezultoi se në vendbanimin prehistorik të Kamnikut, kemi të bëjmë jo me një shtresë kulturore (Prendi 1972 St. Hist. 1972, f. 88), por me dy shtresa kulturore (Aliu-Jubani, Bul. Ark., 1969, f. 4-6).

Shtresa e parë kulturore në Kamnik

që fillon në tabanin fillestar të terrenit në thellësinë 2.20 m, arrin deri në nivelin e dytë të furrave, me trashësi 1.20 m. Në krahun verior të kuadrateve I, X, XI, të gërmuar gjatë viteve 1969, u zbulua një grumbull gurësh të vendosur njeri mbi tjetrin. Ky grumbullim gurësh, që vazhdon edhe në kuadratin XXIV, në formë harku, arrin deri në sipërfaqen e këtyre kuadrateve dhe duhet të ketë shërbyer si një ledh tarracimi, për të krijuar një platformë të sheshtë në këtë terren shumë të pjerrët drejt veriut. Në këtë shtresë kulturore janë zbuluar me shumicë enë të plota nëpër furra dhe shumë fragmente enësh. Grupin e parë e përfaqësojnë qeramika e pikturuar me motive të larmishme, me ngjyrë kafe ose kafe të çelur. Ky grup qeramike në të gjithë treguesit e saj, si për nga repertori i formave dhe teknika e zbulimit me pikturim, barazohet me qeramikën e pikturimit të Neolitit të vonë të Maliqit Ia, të Barçit II (Lera "Iliria" 1, 1987, f. 33); Burimi I (Korkuti Iliria 1, 1982, f. 253) të pellgut të Korçës.

Shtresa e dytë kulturore, fillon në thellësinë 1.20 m me nivelin e dytë të furrave dhe arrin deri në sipërfaqe, me 1 m trashësi. Kjo shtresë kulturore është e përfaqësuar nga qeramika e zezë e gri e zezë, zbuluar me incizim e thellim para pjekjes, me motive gjeometrike ose me pastë të bardhë e të kuqe, që ndeshet rrallë në shtresën e parë, kurse në shtresën e dytë të këtij vendbanimi, përfaqëson vendin kryesor. Në mjaft raste kupat e vogla e sidomos tasat grykëgjërë, me ngjyrë të errët drejt së zezës, janë të zbuluara me pastë të bardhë ose të kuqe, me motive brezash si brenda dhe jashtë pareteve të këtyre enëve.

Me vlera të veçantë në këtë shtresë të Kamnikut II; ndonëse rrallë, ndeshet dhe qeramika me pikturim gri, që së bashku me qeramikën me pastë është e njëjtë me qeramikën e Eneolitit të Maliqit II (Prendi 2018, f. 66), Burimasi II (Korkuti 2010, f. 223) dhe Treni II (Korkuti, Iliria 1, 1971, f. 31-48).

Prania e një dalte prej bakri e zbuluar në shtresën e dytë kulturore të Kamnikut, tipologjikisht e ngjashme me ato të zbuluara në Maliq, provojnë se kjo shtresë kulturore renditet në grupin e kulturave eneolitike të Shqipërisë Juglindore.

Disa nga format e enëve të pikturuara me ngjyrë kafe, që ndeshen rrallë, janë elemente që trashëgohen nga Neoliti i vonë, që provojnë njëkohësisht evolucionin dhe formimin autokton të kulturës së epokës së Bakrit në këtë qendër banimi. Këto dukuri janë konstatuar që herët edhe në shtresën e Maliqit I b të pellgut të Korçës. Gjithsesi duhet të theksojmë se gërmimet në vendbanimin e Kamnikut, ashtu si dhe ato në vendbanimin shumë shtresor të Maliqit, si një nga kryeqendrat e Arkeologjisë prehistorike të vendit tonë, janë kryer gjysmë shekulli më parë. Mundësitë për analizë laboratorike, ishin atë kohë të pamundura, ndaj duhet të ndërmerren gërmime e studime të reja shumë disiplinore në të ardhmen. Nisma të tilla, janë marrë kohët e fundit nga Doktoranti Gazmend Elezi, me udhëheqës J. Papadopoulos në Universitetin e Kalifornisë, Losangeles (UCLA), i cili po studion qeramikën e Neolitit të zbuluar në Vendbanimin e Kamnikut në rrethin e Kolonjës.

Nëpërmjet një akt-marrëveshje, të nënshkruar midis S. Aliu dhe G. Elezi në vitin 2018, në Korçë, me miratimin e Institutit Arkeologjik, doktoranti Elezi, ekzaminoi të gjitha materialet e qeramikës së Kamnikut, që ruhen në fondet e Institutit

Arkeologjik, së bashku me ato të vitrinave, të ekspozuara në Muzeun Arkeologjik, Muzeun Historik Kombëtar, Muzeun Arkeologjik të Korçës, si dhe në Muzeun e Rrethit Kolonjë. Në të njëjtën kohë ai ka marrë një numër të limituar fragmentesh qeramike të Kamnikut, që ruhen në fondet e Institutit Arkeologjik, për analiza të hollësishme mikroskopike dhe kimike për t'i ekzaminuar, përbërjen e baltës, kompozimin e pigmenteve, si dhe mbetjet organike, që shpresojmë të përfshihen në të ardhmen, në një monografi për publikim.

BIBLIOGRAFIA

Aliu, S., 1969
"Zbulime të reja të kulturës ilire në rrethin e Kolonjës", *Studime Historike*, Nr. 1, Tiranë, 1969, f. 159-163.

Aliu, S., 1969
"Zbulime të reja të Kulturës ilire në rrethin e Kolonjës" *Ilirët dhe Gjeneza e Shqiptarëve, Tiranë*, 1969, f. 85-89.

Aliu, S., Jubani, B., 1969
"Vendbanimi Prehistorik i Kamnikut-Kolonjë", *Buletin Arkeologjik*, Tiranë 1969, f. 1-26.

Aliu, S., = Karauskaj, Gj., 1984
"Vendbanime të fortifikuara në pllajën e Kolonjës, e në rrjedhën e sipërme të luginës së Osumit", *Monumentet*, 1. 1984, f. 81-101

Aliu, S., 2002
"Les rapports entre l'Albanie du Sud-est et l'Europe Centrale pendant la transition de l'âge du bronze à l'âge du fer à la Lumière des découvertes de Kolonjë. L'Albanie dans L'Europe Préhistorique," B C H" 2002, "Actes du Colloque de Lorient, 2002, 42: 217-229. Athènes, 2002.

Aliu, S., 2004
"Les traits principaux de la culture de la région de Kolonjë dans L'époque du Bronze recent et pendant L'époque du Fer," IX Congrès International D'Éudes Sud-Est Européennes", Tiranë 2004, f. 147-148 Resumes.

Aliu, S., 2006
"Recent prehistoric research in southeast Albania: A review, New Directions in Albania Archaeology", Tiranë 2006, f. 43-55.

Aliu, S., 2018
"Natural and Archaeological Volues of Treni Cave", *Vjetori shkencor 5/1 II FEE*. (Botim i veçantë i buletinit shkencor të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë), Korçë 2018, f. 363-377.

Bela, M., 2012
"Kërkime prehistorike në bashkimin e Drinit", Tiranë 2012, 246-279.

Bejko, L., 1993
"Mbi praninë e qeramikës mikene në Shqipërinë Jugore". Iliria 1993 1-2, f. 106.

Bodinaku, N., 1985
"Migrimet e periudhës së Bronzit të hershëm dhe roli i tyre në formimin e etnosit ilir". Iliria 1985, 2, f. 181-193.

Bunguri, A., 2010
"Prehistoria e Dibrës", Tiranë, 2010, f. 187-204.

Bodinaku, N., 1981
"Kërkime arkeologjike në rrethin e Përmetit". Iliria 1981, 2, f. 243-262

Ceka, N., 2014
"Ilirët deri të shqiptarët", Tiranë 2014

Gjonçaj, Sh., = Nikolet -Pierre, 1991
Le Monnayage D' Argent D'Egine et Le Tresor de Hollm (Albanie) 1991, Bulletin de Correspondance Hellenique 119, 1995, 1 Etudes "A. History of Macedonian", I, Oxford, 1972., f. 283-309.

Gjonçaj, Vangjeli, Sh., 2014
Thesare me monedha Antike të gjetura në Shqipëri. Shek. V-I p.Kr. Tiranë 2014

Korkuti, M., 1971
"Vendbanimi prehistorik i Trenit", *Iliria* 1971, 1, f. 31-48.

Korkuti, M., 1995
Neolithikum und Chalkalithikum i Alnanien, Mainz 1995

Korkuti, M., 2010
"Qytetërimi Neolitik dhe Eneolitik në Shqipëri", Tiranë, 2010, f. 203-211.

Lera, P., 1987
Vendbanimi i Neolitit të vonë në Barç, "Iliria" 1 1987 2 f. 25-59.

Lera, P., 1988
Vendbanimi i Neolitit të vonë në Dërsnik, "Iliria" 2 1988, f. 21-50.

Përzhita, L., 2018
Kukësi vështrim Arkeologjik, Tiranë 2018.

Prendi, F., 1966
"La civilization prehistorique de Maliq", SA 1966, 1, f. 255-280.

Prendi, F., = Aliu, S., 1971
"Vendbanimi neolitik në fshatin Kamnik të rrethit të Kolonjës", (Gërmime të vitit 1970), Iliria 1, 1971, f. 13-45.

Prendi, F., 1972
"Tipare të Neolitit të vonë në Shqipëri në dritën e zbulimeve të reja" (Kultura Maliq-Kamnik), St. Hist. Nr. 2, 1972, f. 83-102.

Prendi, F., 1976
"Neoliti dhe Eneoliti në Shqipëri", Iliria VI, 1976, f. 21-48.


Prendi, F., 1977-1978
"Epoka e Bronzit në Shqipëri", Iliria 1977-1978, VII-VII, f. 5-58.

Prendi, F., 2018
Vendbanimi Prehistorik i Maliqit, Tiranë, 2018.

Tsuntas, H., 1908
"Ai proistorikai Akropoleis Dimeniu kai Sesklu" Athenais, 1908, f. 322



Daltë bakri e zbuluar në Kamnik që datohet në vitet 2600-2100



Rubairat e Omar Kajamit, poetit të Rshqar persian të fundit të shekullit XI dhe fillimit të shekullit XII, janë një vlerë esteike, artistike dhe filozofike e çdo kohe, sepse mbajnë në vetvete shpirtin universal të të gjitha epokave, me frymën e tyre epikuriane që injekton eneregjinë optimiste te të gjithë brezat njerëzorë, përtej kohës dhe hapësirës. Omar Khajmi u bë i njohur për lexuesin shqiptar më tepër nga përkthimi i Fan S. Nolit dhe më pak nga përkthimi i Hafiz Ali Korçës.

Të përkthesh një vepër në gjuhën shqipe dhe ta shqipërosh atë, janë dy gjëra që në pamje të parë duken të njëjta por në thelb ndryshojnë. Përkthimi mund të bëhet dhe literal, duke i qëndruar besnik origjinalit, pa e ndryshuar atë, ndërsa shqipërimi është diçka e ngjashme me rikrijimin, sepse t'i sjellësh një vepër të huaj lexuesit shqiptar, duhet t'ja përshtatësh atë jo vetëm mënyrës të të konceptuarit dhe receptuarit të veprës prej këtij publiku, por ta përshtatësh dhe nga ana stilistike.

Për herë të parë rubairat në shqip i solli Noli, i cili botoi së pari katër prej tyre në gazetën "Dielli", në vitin 1924. Pas dy vjetësh ai shqipëroi mbi 100 të tilla dhe i botoi në vitin 1926, në Bruksel dhe një vit më vonë, pas pritjes entuziaste të tyre, nga publiku shqiptar, ai shqipëroi mbi 200 rubaira të tjera dhe i botoi në vitin 1927. Ai shkruan vetë në faqen e parë të librit: "I shqipëroj Rushit Bilbil Gramshi, edicje e dytë e ndrequr dhe e plotësuar", dhe i përktheu nga anglishtja prej Eduard Fitzgeraldit. Shqipërimet e Fan Nolit nuk ishin vetëm zgjedhje, por njëkohësisht një afrim shpirtëror dhe mendor i kulturave.

I dyti që përktheu rubairat ishte H.A.Korça, më 1930. Ai merr shkas për përkthimin e kësaj vepre nga Noli, të cilit i bën vërejtjen se është larguar nga origjinali. Pra, ai sheh si arsye të parë të botimit rregullimin dhe shtrëmbërimin, që sipas tij Noli u ka bërë vargjeve të Khajamit: "Nga ky shkak më shtrëngoj ndërgjegjja të gjej rubairat dhe t'i përkthej, që kësaj brezi i ri shqiptar të kuptojë burrin e famshëm Khajam, se cili është. Zoti Rushit mund të ketë zotësi të ligjërojë si bilbil e ca më bukur se bilbili, si në shqipet edhe në disa gjuhëra të tjera, porse në persisht nuk mundet të ligjërojë aspak". Duke zotëruar persishten, H.A.Korça e mbështet përkthimin te bindja se duhet të mbizotërojë autori. Ai gjen gabime tek Fan Noli në ndryshimin e disa koncepteve dhe mbron mendimin se do të ishte me interes njohja e lëvizjes fetare në Persi, në kohën e krijimit të rubairave, duke e ndërlidhur këtë më lëvizjet e mëdha kulturore dhe fetare në Evropë.

Ndërsa Noli i përktheu rubairat, sepse u mrekullua prej magjisë që ato përcillnin dhe sepse te këto kryevepra botërore ai gjeti vetveten, si njeri dhe si poet. Siç shprehet dhe në parathënien e veprës: "Rubairat persane nuk kanë shërbyer si bazë për këtë version se shqipëronjësi nuk e ka studiuar persishten, veç me një mënyrë pak a shumë të çalë, po di ta këndojë me ndihmën e leksikut për çdo fjalë pothuaj dhe kështu ka mundur t'a afronjë këtë përkthim më tepër pas tekstit, veçanërisht, me Rubairat, në të cilat përkthenjësit e ndryshme nuk janë të një mendje sa për kuptimin e tyre"

Studiuesit janë të mendimit se rubairat janë shqipërimi më i mirë i Nolit dhe se me to ai arrin cakun e rikrijimit të vërtetë, sepse nga aspekti i vargëzimit dhe stilit ato ngjasojnë më poezitë origjinale të tij. Për këtë arsye, albanologu Norbert Jokli i ka cilësuar rubairat si përkthimin më të arritur pas atij të Fitzheraldit, por dhe veprën më të dashur të Nolit. Noli gjeti te rubairat vokacionin e vet poetik, në muzikalitetin e vargut të tyre, në simbolet dhe metaforat. Ai studioi nocionet dhe pasi i zbertheu ato, i thuri mjeshtërisht

ExLibris - sponsor medial i konferencës shkencore ndërkombëtare,
"ÇËSHTJE TË GJUHËS, LETËRSISË
DHE PËRKTHIMIT LETRAR".

Fakulteti i Filologjisë i Universitetit "Fehmi Agani", Gjakovë

Dallime në vargëzim midis dy përkthimeve në shqip të rubairave, prej Fan S. Nolit dhe Hafiz Ali Korçës

Prof. as. dr. Jonela Spaho

fjalët për të dhënë mendimet e mistikut të madh.

Hafiz Ali Korça u përpoq të shqipërojë disa terma dhe emra dhe rubairat preferoi t'i quajë katrorë, ndërsa poetin e quajti Omer dhe jo Omar, si Noli. Megjithatë, fjalori i Nolit mbeti, sepse termi rubairë ekziston dhe sot te "Fjalori i gjuhës së sotme shqipe".

Studiuesi Nasho Jorgaqi thekson se Noli, si talent i fuqishëm krijues nuk ka mbetur rob i fjalës. Ai ka bërë perifraksim të rubairave dhe jo përkthim të tyre, ndërsa Korça ka bërë një përkthim teologjik të tyre. Noli i ka parë rubairat nga pozicioni i krijuesit dhe jo i teologut, prandaj rubairat e përkthyer prej tij janë më të bukurat, më poetiket, më humanet dhe më të përafërta me kulturën perëndimore, ndërsa rubairat e përkthyer nga Korça janë më të sakta, më afër variantit original, por që kanë humbur peshën poetike. Ndërsa studiuesi

i orientalistikës Ermal Bega, që ka bërë dhe botimin e rubairave të Korçës, beson se: "përkthimi i tij është i përpiktë si metro, mbi vargjet e vjetra persiane, duke iu afruar kuptimit filozofik dhe të virtytshëm të vargut".

E rëndësishme, për të kuptuar më qartë vargëzimin e rubairave, është dhe mënyra se si dy përkthyesit i kuptonin ato. Mënyra se si këta dy përkthyes i këndvështronë rubairat dhe krijuesin e tyre, do të përcaktojë dhe mënyrën e ndërtimit të vargjeve, sistemin figurativ, dhe sintaksën poetike.

Dy lajtmotivet e rubairave janë gëzimi epikurian dhe hedonist i jetës dhe qëndrimi stoik përballë vështirësive. Noli i jep përparësi, në shqipërimin e tij, qëndrimin stoik në jetë. Ai është i mendimit se për të realizuar qëllimet e tij, njeriu duhet ta gëzojë jetën, kënaqësitë që jep ajo, të përballojë vuajtjet, duke u ngritur

mbi fatin, për të arritur lirinë. Dhe gjithë sistemi ritmik dhe stilistik i tij janë vënë në shërbim të zberthimit të kësaj ideje. Në introduktën që shoqëron shqipërimin, ai i cilëson rubairat si strofa katër vargëshe, me trajtë lakonike si epigrame, që bartin e shprehin gjendje të ndryshme shpirtërore. Sipas Nolit, Khajami është "...vetë natyra njerzore në lëvizje që shfaqet në kohë e hapësira të ndryshme".

Ndërsa Korça mendon: "Rubajitë janë më të bukurat më terheqëset se te ato duhet të mblidhen shumë gjëra në ato katër strofa, prandaj që të shkruajë rubaira duhet që vjershëtori të jetë shumë i ditur dhe shumë mendimtar". Noli në përkthimin e tij, siç thamë, u mbështet te përkthimi anglisht i rubairave prej Fitzheraldit dhe e mësoi persishten, aq sa i nevojitej për të bërë një krahasim me origjinalin. Rubajitë janë vargje lakonike te të cilat, siç shprehet nje studiues: "fjala ndihet ngushtë, ndërsa mendimi i lire". Por, tek shqipërimi i Nolit vërejmë se fjala dhe mendimi shtrihen në një hapësirë të gjerë në harmoni me njëritjetrin.

Përkthimi i Korçës, kësajsoj, është vërtet i saktë, se ai e përktheu nga origjinali, fjalë për fjalë, por ai ka më shumë vlera filologjike se poetike, pasi ai nuk ishte poet. Ndërsa Noli, duke qënë poet, mundi t'u japë vlera origjinale, falë aftësive të tij krijuese. Ai bëri një përkthim i lirë dhe na dha një vepër që risjell dhe njëherë vlerat e tij të shquara si poet.


Nisur nga kjo, larmia e sistemit të vargëzimit dhe e krijimit të ritmit, apo muzikalitetit të vargut, në shqipërimin e Nolit do të përshtatet më gjerë në shqipërimin e tij, në krahasim me përkthimin e Korçës. Vargu me të cilin Noli ka shqipëruar rubairat është 11-rrrokëshi. Noli e preferoi atë, sepse është një varg që merr muzikalitet të larmishëm dhe ka theksa të ndryshëm ritmikë: 6, 10 dhe 4,8,10. Tek shqipërimi i Nolit vërejmë alternimin e dy theksave të ndryshëm ritmikë 6, 10: *Një derë ka që çelsin s'ia gjejmë, / Dhe ka një vel, me sy se kapërcejmë, ose Kur isha i ri kujtonja se e gjeta, / pallatin ku shkëlqente e vërteta,*, dhe 4,8,10: *Si lot pikon nga Qiell' i mrvrojtur shiu, ose mund të kemi gershetimin e theksave të ndryshëm brenda 2 vargjeve të së njëjtës strofë: Qëndroje dorën, mor poçar mizor, / që garbe bën më trupin njerëzor!*

Vargjet përgjithësisht përfundojnë me theksim trokaik, pra vargje paraoktonë dhe daktilë dhe rrallë përfundojnë me theksim jambik: *Natën kur flinja më tha shpirti Pi! / Në gjumë dhe në Varr s'ka lumëri.*

Po ashtu dhe organizimi i ritmit bëhet kryesisht me theksim trokaik dhe daktilë: *Në ëndërr, kur agimi zbardhëllonte, / Një zë nga taverna po gjëmonte.*

Vargu që ka përdorur Korça është 12 rrokëshi me theksim tek rrokja 2, 5, 8, 11: *Ca po vrasin mendjen për fe për doktrine, / Disa të habitur sakt'dyshim gjë s'dinë.* Ky varg përgjithësisht ka një cezurë në mes: *Hap sytë ngadalë // të shkelç përbi tokë, / Bebe syri vajzash // është pluhur; i thatë.*

Ajo që të bie në sy tek Noli, që në strofat e para të shqipërimin të tij, ashtu si dhe ne poezinë origjinale, është muzikaliteti i vargut. Me të drejtë Kuteli e ka cilësuar muzikalitetin e vargut si karakteristikë themelore të vargëzimit të Nolit, ndërsa Rexhep Qosja pohon se muzikalitetin e vargut Noli e ka bërë imanencë të tij. Strukturës muzikore të vargut, ashtu si në poezinë e tij ai ia ka nënshtruar të gjitha elementet poetike, si dhe leksikon poetik. Ritmi, rima, ngjyra e tingujve, përsëritjet, anaforat, aliteracionet, janë ato që ju japin një muzikalitet të jashtëzakonshëm rubairave të Nolit. Një nga mjetet me të cilat Noli procedon shpesh në shqipërimin e rubairave, për t'i dhënë vargut muzikalitet



është aliteracioni. Sasia e vargjeve të përkthyer dhe dëndësia e mendimit që duhet të shprehë në 4 vargjet e rubairave, i ka dhënë mundësinë atij të përdorë të gjitha nuancat tingëllore të fjalës: *Shiko Luadhe, lule bukur, / lumenj kristali, kronj e brohori*, ku tingulli *lu* që përsëritet, jep idenë e bukurisë dhe pastërtisë të natyrës.

Ti hiqma udhën, ti shpëtim rrëfëmë, / ti çelma derën zot dhe përdëlleme, ku përsëritet tingulli *m*, i shoqëruar me zanoret *a, i, ë*, që japin idenë e mëshirës, lutjes, ndihmës, ose: *Të shkuarat mos i kujto më kot, / dhe për të pritmet mos u lodh më kot, / sa kohë në luadhin je, kullot, / nga drapëri i vdekjes nuk shpëton dot*, tingulli *o* përsëritet në të katër vargjet.

Aliteracioni nuk është karakteristikë e vargëzimit të Korçës, por muzikaliteti i vargut dhe ritmi i tij krijohet dhe nga përsëritjet e fjalëve dhe veçanërisht nga anafora. Rastet e përdorimit të anaforës tek Noli janë të shumta: *Kur të gjesh Verë, pije pa mejtuar, / kur të gjesh Vajzë, puthe pa pushuar* ose: *Mbi dhe e nënë dhe, gjumë i paprerë, / Mi dhe e nënë dhe trupa të nderë*. Ose: *Mëshirë lyp, për shpirtin e burgosur, / mëshirë lyp, për gjoksin e brengosur*.

Anafora përveç muzikalitetit të vargut, vihet shpesh në funksion të idesë dhe lakonizmit të vargjeve, sidomos kur ajo është një togfjalësh, apo kur kombinohet me mjete të tjera të sintaksës poetike si elipsi apo pyetja retorike. Ndërkaq, përsëriten nëpër vargje fjalët; *pi, kupa, jeta, varri, çupa, poçe, poçari, zemër, ferr, parajsë, pluhur, çelës, qiell, dritë, det i jetës, fron i jetës, burbuqe, selvi* etj., foljet; *putha, dogja, pervëllova, dëfrej*, të cilat marrin gjatë përdorimit, në kontekste të ndryshme, vlerën e simbolit. Ndërsa në vargjet e Korçës, gjithashtu, e hasim përsëritjen e fjalëve dhe anaforën, por jo aq dendur sa tek Noli dhe jo me të njëjtat efekte muzikore si të tijat: *Për ne vent-dëfrimi kjo bimë është sot, / për ta vent-dëfrimi bima jonë mot?* ku përveç anaforës kemi dhe përsëritjen e fjalës *vent-dëfrimi dhe bimë*, e cila jep idenë e lindjes dhe përtëritjes së jetës. Në vend të fjalës *vel*, Korça përdor fjalën *perde*: *Kur të ngrihen perdet do të kuptohet, / prapa perdes folmë, çfolmë unë e ti*, ndërsa Noli: *Dhe ka një vel, me sy s'e kapërcejmë*.

Korça përsërit, gjithashtu, fjalën: *verë, bimë, baltë, poçar, ditë, natë, pluhur, doktrinë, fe*, të cilat, gjithashtu, marrin vlerën e simbolit. Fjalët *verë* dhe *dashuri* përdoren dendur te të dy përkthyesit, sepse Khajami tek këto rubai i përkushtohet gëzimit dhe bukurisë së jetës, të cilat i gjen të simbolizuara te dashuria dhe vera.

Muzikalitetin në vargjet e Nolit e krijojnë dhe alternimi i asinetit me polisindetin. Asineti sugjeron në vargjet e Nolit shpejtësinë e ritmit: *Dritën ma nxive Zot, zemrën ma theve, / gazin ma çore shpresën, ma rëmbëve*. Por, polisindetit do takohet me shpesh në rubaitë e Nolit dhe jep idenë e rimit të qetë dhe rrëfyes: *Fito një zemër puthe dhe rëmbëje, / dhe adhuroje si Altar prej feje*, ose: *Dhe Qiellit rrotullonjës i thërrita, / Dhe e pyeta: "Cila është Drita?"*

Përdorimi i shpeshtë i polisindetit, vjen si rrjedhojë e stilit biblik. Në të kundërt, në vargjet e Korçës e hasim vetëm në ndonjë rast të rrallë polisindetin, ndërsa, përgjithësisht, në vargje ai operon me mungesën e lidhëzave, gjë që i jep ritmit të vargut shpejtësi: *Para meje teje, kishte dit'nat, / Për punëshhtë sjellë rrot e qiellit gjatë*, ose: *Nga ardhja nga ikja jonë ç'dobi vallë, / Ndënë rreth të rrotës sa shpirtra të pastër, / digjen bëhen pluhur tymi ku të dalë*.

Është për t'u theksuar fakti se Korça përpigjet të ruajë gjatësinë konstante të vargut me asinetin dhe me përdorimin e lirive poetike, kryesisht rrëzimin e rrokjes fundore të fjalës dhe zëvendësimin e saj me apostrof: *Ndër shqelmë një copë baltë*

kishte marrë, Nga kjo Nat'e errët s'duallën në rrugë, etj., ndërsa përdorimi i kësaj lirive poetike mund të themi se ka, pothuajse, dëndësinë më të shpeshtë

Karakteristikë e vargut të Nolit është përdorimi i apostrofit: *O ëngjëll faqedritë, ja u gdhi, / O ti mbi dhe më e zgjedhura Selvi, Mos qaj or mik mos u mërzit me kot, O zot, barrën e jetës lehtësoma*, etj., të cilat vendosen kryesisht në fillim të strofës dhe i japin dinamizëm vargut. Apostrofi nuk është karakteristikë e vargjeve të Korçës. Ajo që është e përbashkët për dy përkthyesit, është përdorimi i dendur i pyetjeve retorike dhe inversionit.

Korça: *Kush e gatoi kupën dhe e pat përzierë?*, ose: *Prej majit të shpresës ç'ish indi sa gjallë?*

Noli: *A e di këndesi po këndon, mesnatë dhe nga gjumi po të zgjon?, Hardhinë pse ma thurri me ndalim? / Kush e ka vënatje këtë mallkim / Kur dije q'e merr prapë, ç'ma dhurove? / Përse më ngjalle, kur pastaj më vret?*, etj.

Lidhur me pyetjen retorike vlen të përmendet një lloj i veçantë i saj, që në poezinë orientale quhet redif dhe përsëritet pas rimës, por në shumicën e rasteve në formë pyetjeje.

Korça: *Zëre se e kreve jetën pasdëshirës, fundi çë? / zëre se i shkove pas të mirës, fundi çë? / Zëre se e kape qindin si pas qefit, fundi çë? / dhe një qint të tjera ta zëmë pashirë, fundi çë?*

Noli: *Sa, sot gas paske dhe shëndet: pastaj? / sa mot të patshim si sivjet: pastaj? / Sa qofsh i lumtur njëqint vjet: Pastaj? / Sa për çudi dyqint si mbret pastaj?*

Redifi mund të jetë shpesh dhe një fjali urdhërore: *U bëra prapë djal'i ri: sill verë! / Kërcenj me flag'e lumturi: sill verë!*,

ose mund të jetë një togfjalësh: *fjalë lumi, ëndrra gjumi, flluska brumi* etj. Redifi ka larmi përdorimi në vargjet e Nolit duke marrë forma nga më të ndryshmet Dëndësia e shpeshtë e redifit, e polisindetit dhe pyetjeve retorike te Korça dhe Noli, të lë të mendosh, që këto janë pjesë e pandarë e stilit të Khajamit.

Vlen të përmendim, gjithashtu, përdorimin e dendur të metaforave dhe tropeve të tjera, si te Korça ashtu dhe te Noli, i cili në poezinë e vet, sipas Rexhep Qoses, mungesën e shprehjes metaforike e ka zvendësuar me dridhjet ritmike dhe muzikore, çka përsëri hedh dritë mbi vetë stilin e rubairave origjinale, ku shprehja metaforike është përhershme e tyre.

Noli: *Shpesh shpirti sulet nga kafazi t'ikë, ose faqja ju nxi, ia mori namin era, dëfrimet qe kam dashur me verbuan, dërgova shpirtin lart mbi qiell, mbi retë*, etj.

Korça: *Shkoj reja dhe bimën rish e lau me lot, në këmbët e vdekjes nje nga një u shkelën, kot më kot ca njerëz kapnë madhëstinië*, etj.

Një element i rëndësishëm i vargëzimit të dy përkthyesve është dhe rima. Rubaitë thamë qe janë strofa katërshe, ku e para e dyta dhe e katërta rimojnë më njëra-tjetrën. Këto rima mbarojnë me të njëjtën shkronjë dhe zanoret që janë para, tyre janë të njëjta. Ky është një rregull i rubairave, që është zbatuar përgjithësisht në mënyrë strikte në të dy përkthimet:

Noli: *Me vrer për ditë fati po na ndes, / Sjep gas që s'na e vjedh me interes; / ta dinte i palinduri s'na lintte, / i linduri më mirë bën kur vdes*.

Korça: *Ca po vrasin mëndjen, për fe, për doktrinë, / Disa të habitur sakt'dyshim gjë s'dinë, / Njëherë tellalli del nga ushtja thotë,*

/ s'është o të pa ditçëm ç'thot aju dhe tinë.

Përdërisa rubaitë e kanë të përcaktuar përdorimin e rimës, nuk mund të bëhet fjalë për larmi të përdorimit të saj, por kjo mënyrë e organizimit të rimës te to, organizon dhe ruan ritmin. Përsa i përket theksit të rimës mund të themi që në të dyja përkthimet, përgjithësisht, kemi rimë paroksitone, me theks në rrokjen e dytë, por në ndonjë rast kemi dhe rimë oksitone, ku theksi bie në rrokjen e fundit.

Noli: *Ka vetëm për të marrët lumëri, / Për t'urtët s'ka veç vrer e qesëndi*.

Korça: *Si -rezet e ezelit un'e ti s'i di, / Kur të ngrihet perdia me habi!*

Përsa i përket fjalorit poetik, vërejmë tek Noli prirjen për të krijuar neologjizma, në përputhje me stilin e rubairave dhe përmbajtjen e tyre si: *faqepjeshke, faqedritë, shpirttrëmbenjësë, flakaves, zemraflutur*, si dhe disa neologjizma me baze oksimorin; *vremjaltë, qiellhapanë*, etj. Edhe Korça ka krijuar neologjizma përsëri në përputhje me stilin e rubairave: *fytyrë, parajsë, shpirtdejgës, dergjishtë, falishtë, pasngjelje, gërmadhohet, koçkorë*, etj.

Kur dikush i pat thënë Korçës se i kishte shkruar bukur rubaira, por gjuhën nuk e kishte fabrikuar, ai u përgjigj: "Unë gjuhën engjëllorë nuk mund ta përziej me gjemba, as nuk mund të shkel manushaqe dhe në vend të tyre të mbjell ferra". Dhe më pas u drejtohet lexuesve: "Të më falni se unë nuk munda të shkruaj shkronja të tepërta, as fjalë të huaja, po gjuhë popullore më dialekt të ngjashëm e të lehtë".

Tek të dy përkthimet vihen re përdorime të shumta të trajtave dialektore kryesisht të toskërishtes.

Noli: *nëmëron, loç, vjetë, ay, çpall, dyke, mun, lark, nofta, balsam, kaqë, çkallmë*, etj.


Korça: *shkelç, tine, tokët, lulishtë, mbleron, gocash, kërhëni, trekt, kupëtohet, vleftë kuxon, gjallja, marrçlark, folmë, duallën, ndejmë, ikmë*, etj.

Ndërkohë për qëllime stilistike vërehet dhe përdorimi i pakët i barbarizmave, sidomos te Noli, që në poezinë e vet i ka përdorur gjerësisht si: *dava, muhabet, trobolitnja, duman*, etj., ose te Korça: *ezel, sefte, tellall, volt*, etj.

Nga ky krahasim i sistemit të vargëzimit, sintaksës dhe fjalorit poetik, u munduam të evidentokmë disa përafri dhe ndryshimi tek të dy përkthimet, duke arritur në përfundimin se Noli ka bërë një shqipërim në kufijtë e rikrijimit, me vlerë të pakrahasueshme artistike, ndërsa përkthimi i Korçës, mbetet një përkthim literal, i saktë, serioz dhe filologjik, por nuk arrin dot peshën artistike të vargut, apo strofës të shqipëruar nga Noli. Noli, siç pohon dhe Rexhep Qosja: "është më tepër stilist në përkthimet e Khajamit, Shekspirit, Servantesit, sesa në shkrimet origjinale. Stili i tij është në radhë të parë, stili i mendimeve dhe imagjinatës së krijuesve të mëdhenj, ai është në radhë të parë stilist përkthyes e pastaj stilist original". Gjithsesi, nga të dyja përkthimet lexuesit mund të pasurojnë përvojat estetike, filozofike dhe artistike, të rubairave, si perla të krijimit njerëzor.

Bibliografia:

Noli, Vepra I, Tiranë, 1988.
 Hafiz Ali Korça, "Rubajati Umer Khajamit", Tiranë, 2006.
 Nasho Jorgaqi "Fan Noli për rilindjen persiane dhe Omar Khajami", Revista "Perla", Tiranë, 2007, Nr.1
 Xhemal Balla "Vlera të çmuara për kulturën tonë", Revista "Urtësia", Nr 64, Tiranë, 2008.
 Rexhep Qosja "Shkrimtarë dhe periudha", Tiranë, 2005.
 Mitrush Kuteli, Vepra letrare 5, Tiranë, 1987.
 Robert Elsi "Historia e letërsisë shqiptare", Tiranë-Pejë, 2007.
 Gjergj Zheji, Natasha Xhafka "Fjalor enciklopedik letrar", Tiranë, 2001.



MIRA
MEKSI

Puthja e
Amazonës

OnufriRoman

